

Komentet e organizatës Pishtarët për Draft Rregulloren për Bashkësitë e Energjisë së Ripërtëritshme (BEBR)

OJQ Pishtarët përkrah zhvillimin e Bashkësive të Energjisë së Ripërtëritshme si një mundësi për përfshirje më të madhe të qytetarëve në tranzicionin energjetik të Kosovës.

Bazuar në përvojën tonë në përcjelljen e zbatimit të legjislacionit për energji dhe mjedis, kemi parë se është e rëndësishme që rregullat të jenë të qarta dhe të kenë mekanizma që sigurojnë zbatimin e tyre në praktikë.

Komentet tona kanë për qëllim forcimin e Rregullores në mënyrë që kushtet e përcaktuara të jenë të qarta, të verifikueshme dhe të respektohen gjatë gjithë periudhës së funksionimit.

1. Respektimi i kërkesave mjedisore dhe ligjore

Projektet e energjisë së ripërtëritshme mund të kenë ndikime të ndryshme në mjedis, varësisht nga teknologjia, madhësia dhe vendndodhja e projektit. Disa projekte mund të kenë ndikim të vogël, ndërsa disa të tjera kërkojnë respektim të vazhdueshëm të kërkesave mjedisore, ujore dhe ligjeve tjera në fuqi.

Rregullorja duhet të qartësojë se autorizimi si BEBR nuk zëvendëson dhe nuk zvogëlon asnjë obligim tjetër ligjor që kërkohet për funksionimin e një projekti të energjisë së ripërtëritshme.

Në rastet kur për funksionim kërkohen leje apo miratime të tjera, përmbushja e këtyre kërkesave duhet të verifikohet para fillimit të operimit. Duke qenë se disa leje kanë afat të kufizuar, Rregullorja duhet gjithashtu të sigurojë që përmbushja e kushteve të verifikohet kur këto leje skadojnë, ripërtërihen apo ndryshohen, në mënyrë që kushtet e nevojshme për operim të vazhdojnë të plotësohen gjatë gjithë kohës së funksionimit të projektit.

2. Sigurimi që BEBR-të mbeten iniciativa të mirëfillta të komunitetit

Qëllimi i BEBR-ve është të rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të krijojnë përfitime për komunitetin.

Kur tregjet krijojnë mundësi ekonomike, është e rëndësishme që rregullat të kenë mekanizma mbrojtës për të siguruar që këto mundësi përdoren për qëllimin për të cilin janë krijuar.

Rregullorja duhet të sigurojë që të verifikohet se kush realisht ka kontroll mbi një BEBR, jo vetëm kush figuron formalisht si anëtar. Kjo përfshin transparencë për pronësinë përfituese dhe mënyrën se si merren vendimet.

Kjo do të ndihmonte që BEBR-të të mbeten iniciativa të komunitetit dhe të shmangen situatat ku kushtet plotësohen vetëm në letër, ndërsa kontrolli real është i përqendruar diku tjetër.

3. Monitorimi, transparencja dhe llogaridhënia

Rregullorja përcakton kushtet që duhet të plotësohen për t'u autorizuar si BEBR. Megjithatë, është po aq e rëndësishme që këto kushte të vazhdojnë të plotësohen edhe pas autorizimit.

Rregullorja duhet të përcaktojë mekanizma të qartë për verifikimin e vazhdueshëm të këtyre kushteve, sidomos kur ka ndryshime të rëndësishme në anëtarësi, pronësi, kontroll apo kushte tjera mbi bazën e të cilave është dhënë autorizimi.

Gjithashtu duhet të qartësohet se çfarë veprime ndërmerren në rastet kur një BEBR nuk i plotëson më kushtet e kërkuara.

Monitorimi i qartë, qasja në informata dhe mekanizmat e llogaridhënies do të ndihmojnë në rritjen e besimit publik dhe zbatimin e suksesshëm të Bashkësive të Energjisë së Ripërtëritshme në Kosovë.

Pishtarët përkrah zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme dhe përfshirjen e qytetarëve në këtë proces. Këto rekomandime kanë për qëllim që Rregullorja të jetë më e qartë, më transparente dhe të sigurojë që BEBR-të të funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar.

Faleminderit!

OJQ Pishtaret



Ndërtesa e Elektrokovës
Bulevardi Bill Clinton nr.5
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtina 10000
Republic of Kosovo*



Komentet e KEDS në Draft Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë

Korrik, 2026



Ndërtesa e Elektrokovës
Bulevardi Bill Clinton nr.5
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtina 10000
Republic of Kosovo*



Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji ka publikuar dhe ka vënë në konsultim publik Draft Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë, me qëllim të krijimit të kornizës rregullative për themelimin, organizimin dhe funksionimin e bashkësive të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Në kuadër të procesit të shqyrtimit të Draft Rregullës, KEDS ka përgatitur komente dhe vërejtje që ndërlidhen me dispozitat e draft-dokumentit të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Ky dokument paraqet komentet dhe sugjerimet e KEDS, me qëllim të kontribuojë në hartimin e një kornize rregullative të qartë, të zbatueshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke marrë në konsideratë aspektet teknike, operacionale dhe rregullative që lidhen me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe integrimin e Bashkësive të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.

Duke qenë se aktualisht ndodhemi në periudhën e konsultimit publik, në vijim paraqiten komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) lidhur me Draft Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë.



1. Komentet e OSSH-së në nenet përkatëse

Në vijim të këtij dokumenti janë paraqitur nenet e Draft Rregullës për të cilat OSSH ka vërejtje, komente ose propozime konkrete. Për secilën dispozitë përkatëse, komenti i OSSH-së është integruar menjëherë pas tekstit të nenit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, në mënyrë që secili propozim të shqyrtohet në kontekstin e dispozitës përkatëse.

Neni 17 paragrafi 2: Operimi në regjim ishullor lejohet vetëm në përputhje me kërkesat teknike dhe me pëlqim paraprak të operatorit të rrjetit.

Komenti i OSSH-së: Ky paragraf duhet të qartësohet, pasi nuk mund të zbatohet në rastet kur objekti ose konsumatori nuk është i kyçur në sistemin elektroenergetik (rrjetin e shpërndarjes ose të transmetimit). Në raste të tilla, operimi në regjim ishullor nuk ndikon në funksionimin e rrjetit dhe, rrjedhimisht, nuk duhet të kushtëzohet me pëlqimin paraprak të operatorit të rrjetit.

Neni 21 paragrafi 1: BEBR dhe anëtarët ose aksionarët e saj pajisen me sisteme matëse të certifikuar dhe të lexueshme në distancë, në përputhje me Kodin e Matjes, Kodet e Rrjetit dhe legjislacionin në fuqi.

Komenti i OSSH-së: Propozojmë që formulimi “*të lexueshme në distancë*” të zëvendësohet me formulimin “*me lexim në distancë*”, pasi ky term është më i përshtatshëm dhe më i qartë në kuptimin teknik të sistemeve matëse.

Propozimi i OSSH-së:

BEBR dhe anëtarët ose aksionarët e saj pajisen me sisteme matëse të certifikuar me lexim në distancë, në përputhje me Kodin e Matjes, Kodet e Rrjetit dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 21 paragrafi 2.1: Sistemet matëse duhet të mundësojnë matjen e saktë dhe të verifikueshme të:
2.1. energjisë elektrike të prodhuar;

Komenti i OSSH-së: Propozojmë që në këtë pikë të përdoret termi “*energjia elektrike e injektuar*” në vend të “*energjia elektrike e prodhuar*”

Propozimi:

2.1. energjisë elektrike të injektuar;

Neni 21 paragrafi 2.4:

Sistemet matëse duhet të mundësojnë matjen e saktë dhe të verifikueshme të:
2.4 energjisë elektrike të ndarë ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së.

Komenti i OSSH-së: Propozojmë që pika 2.4 të hiqet, pasi ndarja e energjisë ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së realizohet në bazë të kalkulimit dhe marrëveshjes së brendshme të BEBR-së, dhe nuk përbën një madhësi që matet drejtpërdrejt nga sistemi matës.



Neni 21, paragrafi 3 :

Pajisjet matëse dhe sistemet shoqëruese duhet të përfshijnë:

- 3.1. njehsorë inteligjentë;
- 3.2. sisteme të leximit në distancë;
- 3.3. pajisje për regjistrimin e parametrave teknikë të sistemit elektroenergjetik;
- 3.4. pajisje të nevojshme komunikimi dhe integrimi me sistemet e operatorit të rrjetit.

Komenti i OSSH-së: Propozojmë që paragrafi 3, së bashku me nën-pikat 3.1–3.4, të largohet, pasi kërkesat për pajisjet matëse dhe sistemet shoqëruese tashmë janë të përcaktuara në Kodin e Matjes dhe Kodet e Rrjetit, të cilat janë referuar në paragrafin 1 të Nenit 21.

Neni 21, paragrafi 6: Çdo ndryshim në konfigurimin e sistemeve matëse, pikave të matjes ose parametrave që ndikojnë në matjen e energjisë duhet të njoftohet dhe, kur kërkohet sipas procedurave të operatorit të rrjetit, të miratohet sipas procedurave të operatorit përkatës të rrjetit.

Komenti i OSSH-së:

Propozojmë që paragrafi 6 të riformulohet si në vijim:

Çdo kërkesë për ndryshim në konfigurimin e sistemeve matëse, pikave matëse ose parametrave që ndikojnë në matjen e energjisë, duhet t'i drejtohet operatorit të sistemit, në përputhje me procedurat përkatëse.

Neni 22, paragrafi 1: BEBR njofton operatorin përkatës të rrjetit për çdo ndryshim teknik që ndikon në kapacitetin e instaluar, konfigurimin e sistemit, pikën e kyçjes, sistemet e ruajtjes së energjisë, infrastrukturën për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike ose parametrat e tjerë teknikë relevantë për operimin e sigurt të rrjetit, brenda afatit të përcaktuar nga operatori përkatës i rrjetit.

Komenti i OSSH-së: .

Propozojmë që paragrafi 1 të riformulohet si në vijim:

BEBR duhet të kërkojë nga operatori përkatës i rrjetit çdo ndryshim teknik që ndikon në kapacitetin e instaluar, konfigurimin e sistemit, pikën e kyçjes, sistemet e ruajtjes së energjisë, infrastrukturën për mbushjen e automjeteve elektrike ose parametrat e tjerë teknikë relevantë për operimin e sigurt të rrjetit, sipas procedurave përkatëse të operatorit të rrjetit.



Neni 36 paragrafi 1.6. Operatorët e rrjetit duhet t'ua vënë në dispozicion leximet e matësve si furnizuesve edhe BEBR sa më shpejt të jetë e mundur, dhe brenda afateve të përcaktuara në kornizën e matjes dhe rregullat e tregut. Të dhënat duhet të vihen në dispozicion nëpërmjet sistemeve elektronike, platformave digjitale ose portaleve të dedikuara për përdoruesit dhe falas me masa të përshtatshme sigurie.

Komenti i OSSH-së:

Propozojmë që në këtë paragraf fjala "**duhet**" të zëvendësohet me "**mund**", në mënyrë që dispozita të reflektojë mundësinë e vënies në dispozicion të të dhënave sipas sistemeve dhe procedurave të operatorit të rrjetit.

Koment i përgjithshëm i OSSH-së: Në Draft Rregull janë përfshirë dispozita që i referohen sistemeve për ruajtjen e energjisë dhe mbushësve të automjeteve elektrike. Duke qenë se këto çështje nuk janë të rregulluara në mënyrë të plotë me legjislacionin në fuqi, propozojmë që të qartësohet trajtimi i tyre në kuadër të kësaj Rregulle.

Komentet e përgjithshme të IT-së :

Përfshirja e shkëmbimit të të dhënave dhe sigurisë kibernetike në draft është pozitive; megjithatë, formulimi aktual nuk është mjaftueshëm i qartë për zbatim praktik. Detyrimet sipas neneve 25, 46, 47 dhe 50 krijojnë rreziqe të drejtpërdrejta teknike dhe operacionale për sistemet e operatorit, të dhënat e konsumatorëve, faturimin dhe integritet me palët e treta.

Komentet e Shkurtra dhe Veprimet e Kërkuara

Referenca	Gjetja e shkurtër	Rreziku	Veprimi i kërkuar
Neni 25	Parashihet qasje në të dhënat e matjes për BEBR-të, furnizuesit, agregatorët dhe palët tjera të autorizuar.	Nëse qasja në të dhëna është e pakontrolluar ose interpretohet ndryshe, mund të ekspozohen profilet e konsumit dhe të dhënat komerciale të konsumatorëve.	Të përcaktohen grupet e të dhënave, rolet e qasjes, pëlqimi i konsumatorit, revokimi i autorizimit, siguria e Ndërfaqeve për Programimin e Aplikacioneve (Application Programming Interface - API), regjistrimi i qasjeve dhe periudhat e ruajtjes në një aneks teknik.
Neni 25	Operatori pozicionohet si burim zyrtar i të dhënave të matjes dhe i të dhënave për ndarjen e energjisë.	Ky rol krijon barrë shtesë për zhvillim, validim, mbështetje, siguri dhe kosto në sistemet Infrastruktura e Avancuar e Matjes (Advanced Metering Infrastructure - AMI), Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të Matjes (Meter Data Management - MDM), Billing dhe Platforma Qendrore për Menaxhimin/Shkëmbimin e të Dhënave (Data Hub).	Të përcaktohet sistemi zyrtar burimor, Marrëveshja për Nivelin e Shërbimit (Service Level Agreement - SLA) për vonesën e të dhënave, afati final i mbylljes së të dhënave, rregullat e korrigjimit dhe përgjegjësia për kostot.
Neni 46	Parimet e sigurisë kibernetike janë përfshirë, por kontrollet minimale të detyrueshme nuk janë mjaftueshëm të qarta.	Secila palë mund ta interpretojë ndryshe parimin e proporcionalitetit. Kjo krijon rrezik për integritet të dobëta dhe jo të standardizuara.	Autentifikimi me Shumë Faktorë (Multi-Factor Authentication - MFA), Kontrolli i Qasjes Bazuar në Role (Role-Based Access Control - RBAC), autentifikimi i Ndërfaqeve për Programimin e Aplikacioneve (Application Programming Interface - API), enkriptimi, regjistrimi i aktiviteteve (Logging), integrimi me Menaxhimin e Informacionit dhe Ngjarjeve të Sigurisë (Security Information and Event Management - SIEM), skanimet e cenueshmërisë, testimi i depërtimit në sistem (Penetration



Referenca	Gjetja e shkurtër	Rreziku	Veprimi i kërkuar
			Testing), kopjeruajtja dhe rikuperimi nga fatkeqësitë (Backup and Disaster Recovery - Backup/DR) dhe menaxhimi i përditësimeve të sigurisë (Patch Management) të bëhen kërkesa minimale.
Neni 46	Drafti lejon obligime më të lehta për BEBR-të mikro/të vogla.	Siguria e dobët edhe të një BEBR i vogël mund të krijojë rrezik për ndërfaqet e operatorit dhe infrastrukturën kritike të energjisë.	Të ndahen obligimet e brendshme të BEBR-ve nga kushtet e sigurisë për lidhje me sistemet e operatorit. I njëjti nivel minimal sigurie duhet të vlejë për çdo palë të lidhur me operatorin.
Neni 47	Incidentet kibernetike duhet të raportohen te institucionet përkatëse, operatori dhe ZRRE.	Nëse klasat e incidenteve, kanalet e raportimit dhe palët përgjegjëse nuk janë të qarta, mund të ketë vonesa dhe konteste përgjegjësie gjatë krizave.	Të publikohen definimet për incidente kritike/të larta/mesatare, formatet e raportimit, kanalet e komunikimit, afatet për raport paraprak/final dhe zinxhiri i përgjegjësisë.
Neni 47	Priten plane të reagimit ndaj incidenteve, plane të rikuperimit të shërbimeve, testime dhe ushtrime.	Gatishmëria e bazuar vetëm në deklaratime nuk është e mjaftueshme për integritet me infrastrukturë kritike.	Palët e jashtme që lidhen me operatorin të dëshmojnë kontakt 24/7, aftësi për gjenerim të log-eve, testime të fundit të sigurisë, testime kopjeruajtje/rikuperim (Backup/Restore) dhe pjesëmarrje në ushtrime të përbashkëta.
Neni 50	Janë përcaktuar qeverisja e të dhënave dhe përgjegjësitë e palëve.	Të dhënat e pasakta, të mangëta ose të vonuara mund të shkaktojnë gabime në faturim, çështje të barazimit perfundimtar ankesa të konsumatorëve dhe ndikim financiar.	Të përcaktohen validimi i të dhënave, metoda për të dhënat që mungojnë, kriteret e cilësisë, versionimi, mbyllja e periudhave, pranimi final i të dhënave, trajtimi i kontesteve dhe korrigjimet retroaktive.
Neni 50	Parashihet transferimi i të dhënave të energjisë të palët e autorizuar në format standard dhe të lexueshëm elektronikisht.	Pa standard të qartë, secila palë mund të kërkojë integritet të ndryshme, duke krijuar kompleksitet teknik të paqëndrueshëm.	Të publikohen paraprakisht struktura e strukturën e endpoint-eve të (Application Programming Interface - API), modeli i të dhënave, intervalet kohore, njësitë matëse, kufizimet e numrit të kërkesave (Rate Limits), kodet e gabimeve, versionimi, mjedisi testues (Sandbox) dhe procesi i certifikimit.

Hapat e Detyrueshëm para Implementimit

- Të publikohet standardi teknik për shkëmbimin e të dhënave dhe Ndërfaqet për Programimin e Aplikacioneve (Application Programming Interface - API).
- Të përcaktohen qasja e palëve të treta, pëlqimi i konsumatorit, revokimi i autorizimit dhe modeli i auditimit.
- Të bëhet e detyrueshme lista minimale e kontrolleve të sigurisë kibernetike për çdo palë që lidhet me sistemet e operatorit.
- Të përcaktohet procedura e raportimit të incidenteve, klasat e incidenteve, formati i raportit dhe zinxhiri i përgjegjësisë.
- Të sqarohen proceset e validimit, korrigjimit, trajtimit të kontesteve dhe shlyerjes financiare të energjisë (Settlement) final të të dhënave.
- Të aplikohet vlerësimi i gatishmërisë / procesi i certifikimit para qasjes në mjedisin operativ.
- Të realizohet fazë pilot para implementimit të përgjithshëm dhe zbatimi gradual të lejohet vetëm pas testimeve të suksesshme.
- Të krijohet një plan realist tranzicioni dhe model i kostove/burimeve për sistemet e operatorit.

Këto dispozita nuk duhet të zbatohen në mjedisin operativ pa u finalizuar paraprakisht anekset teknike, standardet minimale të sigurisë, matrica e përgjegjësisë, faza pilot dhe plani i zbatimit gradual. Në të kundërtën, paraqitet rrezik i lartë operacional për sigurinë e të dhënave, saktësinë e faturimit, integritet me palët e treta dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike.

Kontribut ndaj procesit të konsultimit publik për Draft Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR)

Emri i organizatës që jep komente: Instituti Riinvest

Informatat e kontaktit të organizatës (adresa):

Rr. Andrea Gropa nr. 98, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Komentet

Instituti Riinvest e vlerëson përgatitjen e Draft Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR), e cila krijon bazën e nevojshme ligjore për zhvillimin e komuniteteve të energjisë në Kosovë dhe përafrimin e kornizës rregullative me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Drafti përcakton në mënyrë të qartë statusin juridik të BEBR-ve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe procedurat për autorizim, regjistrim dhe operim.

Megjithatë, konsiderojmë se rregullimi mund të përmirësohet më tej për të nxitur investimet private dhe për ta bërë modelin e Bashkësive të Energjisë më të zbatueshëm në praktikë. Përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian tregon se suksesi i komuniteteve të energjisë nuk varet vetëm nga ekzistenca e një baze ligjore, por edhe nga krijimi i kushteve që mundësojnë mobilizimin e kapitalit privat, uljen e kostove administrative dhe sigurimin e një mjedisi të parashikueshëm për investitorët dhe qytetarët.

Në këtë drejtim, propozojmë këto komente:

1. Të qartësohet roli i investitorëve privatë dhe modeleve të financimit

Rekomandojmë që Rregulla të specifikojë në mënyrë eksplicite se BEBR-të mund të lidhin marrëveshje afatgjata financimi, investimi, leasingu, operimi, mirëmbajtjeje ose të shërbimeve energjetike (ESCO) me kompani private për zhvillimin dhe operimin e projekteve të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Ky sqarim është i rëndësishëm për të mundësuar modele inovative të biznesit, ku sektori privat financon dhe realizon investimin, ndërsa qytetarët ose komunitetet përfitojnë nga energjia e prodhuar pa qenë të detyruar të mbulojnë kostot fillestare të investimit. Një shembull praktik do të ishte instalimi i paneleve fotovoltaike në kulmet e ndërtesave kolektive, ku kompania private investon në projekt, ndërsa banorët përfitojnë energji për ndriçimin e hapësirave të përbashkëta, ujë të ngrohtë ose ulje të kostove të energjisë.

Po ashtu, rekomandojmë që të qartësohet se lidhja e marrëveshjeve të tilla nuk konsiderohet cenim i parimit të "kontrollit efektiv" të BEBR-së, për aq kohë sa vendimmarrja strategjike dhe qeverisja e Bashkësisë mbeten në kompetencën e anëtarëve të saj. Një sqarim i tillë do të rriste sigurinë juridike dhe do të lehtësonte financimin e projekteve nga institucionet financiare dhe investitorët privatë.

2. Të rishikohet kufizimi prej 10% për pjesëmarrjen e NMVM-ve

Draft Rregulla kufizon pjesëmarrjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në maksimum 10% të pjesëmarrjes në një BEBR. Konsiderojmë se ky kufizim mund të jetë tepër restriktiv dhe të dekurajojë investimet, veçanërisht në rastet kur komunitetet krijohen në zona industriale, parqe biznesi, objekte komerciale apo komplekse të përziera rezidenciale dhe afariste.

Në vend të një kufiri sasior, rekomandojmë që fokusi të jetë në ruajtjen e kontrollit efektiv të komunitetit, duke lejuar një pjesëmarrje më të madhe të sektorit privat për aq kohë sa nuk cenohet karakteri komunitar i BEBR-së. Një qasje e tillë do të krijonte më shumë fleksibilitet, do të mobilizonte kapital privat dhe do të rriste numrin e projekteve të realizueshme, pa devijuar nga objektivat e përcaktuara në legjislacion.

3. Të krijohet një mekanizëm "One-Stop-Shop"

Themelimi i një BEBR-je kërkon ndërveprim me disa institucione, duke përfshirë ZRRE-në, operatorin e rrjetit, autoritetet komunale dhe institucione të tjera përgjegjëse. Kjo mund të krijojë procedura të gjata dhe kosto administrative që dekurajojnë qytetarët dhe bizneset.


Rekomandojmë krijimin e një mekanizmi të integruar "One-Stop-Shop", përmes të cilit aplikuesit do të mund të dorëzojnë dokumentacionin, të ndjekin statusin e aplikimeve dhe të koordinojnë procedurat përmes një platforme të vetme digjitale. Një mekanizëm i tillë do të rriste efikasitetin institucional, transparencën dhe parashikueshmërinë e procedurave, duke ulur kostot administrative dhe kohën e nevojshme për zhvillimin e projekteve.

4. Të publikohen modele standarde të dokumentacionit

Një nga pengesat kryesore për krijimin e komuniteteve të energjisë është mungesa e përvojës praktike dhe kostot relativisht të larta të përgatitjes së dokumentacionit ligjor dhe teknik.

Prandaj, rekomandojmë që ZRRE, krahas miratimit të Rregullës, të hartojë dhe publikojë modele standarde të statutit të BEBR-ve, marrëveshjeve ndërmjet anëtarëve, marrëveshjeve ESCO dhe marrëveshjeve për ndarjen e energjisë. Këto dokumente do të shërbenin si udhëzues praktik për qytetarët, komunat dhe bizneset, duke ulur kostot ligjore dhe administrative, rritur sigurinë juridike dhe përshpejtuar krijimin e komuniteteve të para të energjisë në Kosovë.

Në tërësi, konsiderojmë se këto plotësime nuk ndryshojnë filozofinë e Draft Rregullës, por e bëjnë atë më të favorshme për investime, më të zbatueshme në praktikë dhe më efektive në arritjen e objektivit të saj kryesor: zhvillimin e Bashkësive të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme si një mekanizëm për përshpejtimin e tranzicionit energjetik, rritjen e investimeve në energjinë e ripërtërishme dhe fuqizimin e qytetarëve dhe komuniteteve lokale.



GREEN ENERGY
— K O S O V A —

BASHKËSITË E ENERGJISË NË KOSOVË

Dokument konsultimi publik

Korrik 2026



www.greenenergykosova.org



info@greenenergykosova.org



Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

POZICIONI I GEK-ut	5
Hyrje.....	5
Përmbledhje për vendimmarrësit	6
Dhjetë vendimet që kërkohen nga ZRRE	6
Çfarë mund të fillojë, çfarë duhet të pilotohet dhe çfarë duhet të presë.....	7
KUPTIMI I BASHKËSIVE TË ENERGJISË	8
Çfarë janë BEBR-të dhe çfarë nuk janë	8
Konceptet që duhen dalluar	8
Çfarë nënkupton realisht “ndarja e energjisë”	9
Pse BEBR-të kanë rëndësi për Kosovën.....	10
KONTEKSTI LIGJOR DHE RREGULLATIV	11
Korniza juridike e Kosovës.....	11
Çfarë rregullon secili instrument.....	11
Acquis i Komunitetit të Energjisë dhe konteksti evropian	12
DRAFT-RREGULLA SI SISTEM.....	13
Çfarë bën mirë Draft-Rregulla.....	13
Ku nevojitet përmirësim.....	14
Autorizimi kundrejt regjistrimit.....	14
Afërsia dhe veprimtaria në disa lokacione	14
Matja dhe alokimi	14
Tarifat	14
Faturimi dhe furnizuesit.....	15
Tepricat dhe balancimi.....	15
Përfshirja sociale.....	15
Të dhënat dhe siguria	15
Tranzicioni.....	16
TESTI I REALITETIT NË KOSOVË	17
Gatishmëria aktuale e sistemit.....	17
Pse nevojiten kriteret e gatishmërisë për aktivizim.....	17
OPSIONET DHE MODELI I REKOMANDUAR	19
Modele alternative për Kosovën	19
Modeli i dy niveleve për BEBR-të	19
SI FUNKSIONON MODELI NË PRAKTIKË	21
Qeverisja, pronësia dhe kontrolli lokal.....	21

Vendimet që duhet të mbeten te anëtarët	21
Matja, alokimi dhe barazimi	21
15. Faturimi, tarifat, tepricat dhe balancimi	22
Pamja minimale e faturës së anëtarit.....	23
Komunat, financimi dhe përfshirja sociale	23
Të dhënat, privatësia dhe siguria kibernetike.....	23
Skenarët e stres-testimit.....	24
Çfarë do të thotë modeli për sistemin elektroenergjetik.....	26
SISTEMI I ZBATIMIT	27
Instrumentet dytësore të nevojshme.....	27
Rolet institucionale dhe llogaridhënia.....	28
Udhërrëfyesi 2026-2031	28
Monitorimi, mësimi dhe rishikimi.....	29
POZICIONI FORMAL DHE NDRYSHIMET	30
Kërkesat formale të GEK-së për ZRRE.....	30
Matrica nen-për-nen.....	30
Teksti i konsoliduar i ndryshimeve prioritare	32
Neni 9 - Autorizimi për Ndërtim dhe Regjistrimi	32
Neni i ri 13A - Afërsia dhe perimetri teknik i ndarjes.....	32
Neni 24 - Aktivizimi tarifor.....	32
Neni 27 - Ndarja dinamike dhe hibride.....	32
Neni 39 - Përfshirja sociale.....	33
Neni 56 - Tranzicioni.....	33
Korrigjimet redaktuese, terminologjike dhe të referencave.....	33
PËRFUNDIM.....	34
SHTOJCAT	35
Shtojca 1. Regjistri i burimeve dhe statusi juridik.....	35
Shtojca 2. Metodologjia dhe kufizimet e evidencës.....	36
Shtojca 3. Fjalori i termave	36
Shtojca 4. Lista e kontrollit për verifikimin e perimetrit teknik të ndarjes së energjisë	37
Shtojca 5. Modeli i Planit për Përfshirje Sociale dhe Ndarje të Përfitimeve.....	37
Shtojca 6. Koncepti i Pilotit Demonstrues në Obiliq	38
Shtojca 7. Matrica e plotë e ndryshimeve prioritare	38

Shkurtesa	Kuptimi
BEBR	Bashkësi e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme
BRE	Burime të Ripërtërishme të Energjisë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
KOSTT	KOSTT Sh.A. – Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
PPB	Palë Përgjegjëse për Balancim
NMVM	Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme
PV	Fotovoltaikë
EE	Eficiencë energjetike
EV	Automjete elektrike
ECRB	Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (<i>Energy Community Regulatory Board</i>)
CEC	Komunitet Qytetar i Energjisë (<i>Citizens Energy Community</i>)
IT	Teknologji të informacionit
A	Përgjegjës përfundimtar (<i>Accountable</i>)
R	Përgjegjës për zbatim (<i>Responsible</i>)
C	Palë e konsultuar (<i>Consulted</i>)
A/R	Institucion që mban njëkohësisht përgjegjësinë përfundimtare dhe atë të zbatimit
kWh	Kilovat-orë

POZICIONI I GEK-ut

Green Energy Kosova (GEK) është organizatë e pavarur jofitimprurëse që zhvillon analiza të bazuara në evidencë, propozon zgjidhje të zbatueshme dhe mbështet bashkëpunimin institucional për një sistem energjetik më të pastër, më të sigurt dhe më të përballueshëm në Kosovë.

Hyrje

ZRRE ka publikuar për konsultim Draft-Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEER). Dokumenti i draftit krijon një kornizë të gjerë: përcakton statusin juridik, qeverisjen, autorizimin dhe regjistrimin, kyçjen, matjen, tarifat, ndarjen e energjisë, faturimin, balancimin, tepricat, rolet e operatorëve dhe furnizuesve, përfshirjen sociale, të dhënat, sigurinë kibernetike, inovacionin dhe dispozitat kalimtare. [S1]

Kjo e bën Draft-Rregullën një hap të rëndësishëm. Megjithatë, një rregull që përmend të gjitha këto tema nuk e zgjidh vetvetiu çështjen e zbatimit. Një BEER funksionale nuk krijohet vetëm me regjistrim: ajo kërkon marrëdhënie të qarta mes komunitetit, projektit të BRE-së, pikave matëse, operatorit të rrjetit, furnizuesit, tarifave të rrjetit, mekanizmave të faturimit dhe rrugës së tepricës në treg.

Ky dokument shërben për të bërë të dukshme këtë lidhje. Ai fillon duke shpjeguar se çfarë është një BEER, çfarë nuk është, pse ka rëndësi dhe çfarë kërkohet që një komunitet të kalojë nga ideja në operim. Pastaj lexon Draft-Rregullën si një sistem: cilat pjesë tashmë janë të forta, cilat pjesë kërkojnë sqarim dhe cilat funksione duhet të aktivizohen vetëm pasi të ekzistojnë kushtet teknike, tarifore dhe institucionale.

KONTRIBUTI I GEK-ut



GEK nuk propozon zëvendësimin e arkitekturës së Draft-Rregullës. Propozimi është që kjo arkitekturë të pajiset me qartësi juridike, specifikime teknike, procedura të faturimit dhe kriteret e gatishmërisë për aktivizim që e bëjnë të zbatueshme në kushtet reale të Kosovës.

Përmbledhje për vendimmarrësit

BEBR-të mund të krijojnë një rrugë të re për pjesëmarrjen e qytetarëve, komunave, familjeve në nevojë dhe ndërmarrjeve të vogla në tranzicionin energjetik. Ato mund të mbështesin investime të përbashkëta në energji diellore, ruajtje, eficiencë energjetike dhe shërbime lokale. Por për të qenë të qëndrueshme, ato nuk mund të mbështeten në premisa të paqarta si “energji falas”, “virtual net metering (kompensim virtual i energjisë)” pa rregulla, ose përjashtim automatik nga tarifat e rrjetit.

Ligji Nr. 08/L-258 i jep BEBR-ve të drejtën të prodhojnë, konsumojnë, ruajnë, shesin dhe ndajnë energji të prodhuar nga asetet e tyre, sipas marrëveshjes së alokimit; ai kërkon gjithashtu që ZRRE të rregullojë autorizimin, regjistrimin, kyçjen, matjen, balancimin, faturimin dhe kompensimin. **[S2, nenet 33-36]** Kjo do të thotë se Draft-Rregulla ka bazë të qartë ligjore, por gjithashtu se zbatimi duhet të ndërtohet përmes akteve dhe procedurave të ndërlidhura.

Dhjetë vendimet që kërkohen nga ZRRE

Vendimi	Çfarë duhet të bëhet
1. Qartësimi i katër procedurave	Të ndahen formimi juridik, regjistrimi i BEBR-së, autorizimi për ndërtim dhe detyrimet për licencim ose treg, të cilat aktivizohen vetëm kur BEBR kryen veprimtarinë përkatëse.
2. Afërsia kundrejt perimetrit teknik	Afërsia të shërbejë për kontroll lokal dhe përfitim komunitar; ndarja e energjisë ndërmjet pikave të ndryshme matëse të lejohet vetëm brenda një perimetri teknik të ndarjes së energjisë, të verifikuar nga operatori përkatës i rrjetit.
3. Verifikimi i perimetrit teknik të ndarjes së energjisë	Të përcaktohet dhe verifikohet perimetri teknik i ndarjes së energjisë, duke përfshirë pikat matëse, burimin e të dhënave, trajtimin tarifor, faturimin dhe kërkesat e sigurisë së rrjetit.
4. Fillim me ndarje statike	Ndarja statike të pilotohet para aktivizimit të ndarjes dinamike ose hibride.
5. Vendim tarifor paraprak	ZRRE të miratojë metodologji ose vendim tarifor para zbatimit të përgjithshëm të ndarjes ndërmjet disa pikave matëse.
6. Protokoll OSSH-furnizues	Të përcaktohen burimi zyrtar i të dhënave, formatet, afatet, korrigjimet dhe pasqyrimi në faturë.
7. Specifikim teknik i alokimit	Intervali, koeficientët, humbjet, tepricat, ruajtja, korrigjimet dhe ndryshimet e anëtarëve të mos lihen pa rregulla operative.
8. Përfshirje sociale e zbatueshme	BEBR-të që përdorin asete ose mbështetje publike të miratojnë Plan për Përfshirje Sociale dhe Ndarje të Përfitimeve.
9. Proporcionalitet në të dhëna dhe siguri	BEBR-të e vogla të mos trajtohen si operatorë kritikë të sistemit; detyrimet të lidhen me rrezikun dhe funksionin.
10. Tranzicion me dëshmi të gatishmërisë për aktivizim	Zbatimi të lidhet me prova të matjes, faturimit, tarifave dhe tregut; jo vetëm me afate kalendarike.

Çfarë mund të fillojë, çfarë duhet të pilotohet dhe çfarë duhet të presë

Mund të fillojë tani	Vetëm pilot i kontrolluar	Fazë e ardhshme
Formimi i BEBR-së bazë; qeverisja; zhvillimi i projektit; fondi i përfitimit komunitar; vetë-konsumimi individual ose i përbashkët ku lejohet.	Ndarja statike ndërmjet pikave të validuara; projekte komunale me një aset kryesor të projektit; test i faturimit me furnizues; perimetri i parë teknik i ndarjes së energjisë.	Ndarja dinamike ose hibride; agregimi; fleksibiliteti; ruajtja e integruar për alokim; EV si fleksibilitet; ndarja e gjerë komunale.

	MODEL I REKOMANDUAR
→	Modeli i dy niveleve i BEBR-së kombinon qeverisje dhe përfitim më të gjerë lokal me disiplinë teknike: komuniteti mund të ketë një statut, fond solidariteti dhe plan investimi, ndërsa alokimi i energjisë zbatohet vetëm brenda perimetrit teknik të ndarjes së energjisë vetëm brenda perimetrit teknik të ndarjes së energjisë. Ky është propozim i GEK-së për zbatim, jo një kërkesë që ekziston tashmë në ligj.

KUPTIMI I BASHKËSIVE TË ENERGJISË

Para se të ndryshohet një rregull, duhet të jetë e qartë se çfarë nënkupton mekanizmi, cilat janë kufijtë e tij dhe cilat role nuk duhet të ngatërrohen.

Çfarë janë BEBR-të dhe çfarë nuk janë

Një Bashkësi e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme është një subjekt juridik autonom që zhvillon, investon ose zbaton projekte të energjisë së ripërtërishme dhe eficiencës energjetike, i kontrolluar në mënyrë efektive nga anëtarët ose aksionarët pranë projekteve të saj dhe i orientuar drejt përfitimeve mjedisore, ekonomike ose sociale për anëtarët dhe komunitetin lokal. [S2, nenet 32-34] Ky përkufizim ka disa pasoja praktike: BEBR-ja nuk është vetëm një grup konsumatorësh, as vetëm një projekt fotovoltai, as një furnizues i maskuar.

Autonomia juridike do të thotë se BEBR-ja mund të lidhë kontrata, të zotërojë asete, të marrë përgjegjësi dhe të mbajë llogari të ndara nga anëtarët e saj. **Pjesëmarrja e hapur dhe vullnetare** do të thotë se anëtarësia nuk duhet të përdoret si mekanizëm për të mbyllur aksesin pa arsye objektive. **Kontrolli efektiv lokal** do të thotë se një zhvillues, investitor i jashtëm ose komunë nuk duhet të përdorë vetëm emrin e komunitetit për të kontrolluar projektin. **Përfitimi komunitar** do të thotë se kthimi financiar mund të ekzistojë, por nuk është arsyeja e vetme ose kryesore e strukturës. [S6, fq. 3-7]

Konceptet që duhen dalluar

Koncepti	Qëllimi kryesor	Bazë / kontekst	Çfarë nuk është
Vetë-konsumator individual	Konsumatori fundor prodhon energji për përdorimin e vet në objektin ose hapësirën e tij.	Rregulla për Vetë-Konsumatorët, Nr. 03/2023.	Nuk është domosdoshmërisht komunitet dhe nuk kërkon qeverisje kolektive.
Vetë-konsumatorë të përbashkët	Dy ose më shumë konsumatorë në të njëjtin objekt ose bllok banesor ndajnë një konfigurim të përbashkët.	Korniza e vetë-konsumit; [S6, fq. 4].	Nuk është një BEBR e gjerë me aset, fond solidariteti dhe strukturë lokale të pavarur.
BEBR	Subjekt juridik autonom me kontroll lokal dhe përfitim komunitar.	Ligji Nr. 08/L-258, Kapitulli V.	Nuk është automatikisht furnizues, agregator ose PPB.
Konsumator aktiv	Konsumator që prodhon, konsumon, ruan, shet ose merr pjesë në mekanizma të caktuar të tregut.	Acquis i energjisë elektrike; [S7].	Është status funksional; mund të ekzistojë edhe jashtë BEBR-së.

Koncepti	Qëllimi kryesor	Bazë / kontekst	Çfarë nuk është
Agregator	Palë që grupon fleksibilitet, prodhim ose ngarkesë për pjesëmarrje në treg.	Rregullat e tregut dhe korniza e balancimit.	Nuk është vetë BEBR, edhe kur BEBR përdor shërbimet e tij.
Furnizues	Palë që ka marrëdhënie furnizimi dhe lëshon faturë për konsumatorin.	Ligji/rregullat e energjisë elektrike.	BEBR nuk zëvendëson automatikisht furnizuesin e anëtarit.
Bashkësi qytetare e energjisë (Citizens Energy Community – CEC)	Komunitet qytetar energjie, nëse parashihet me ligj të ardhshëm.	Përputhshmëri e mundshme në të ardhmen, jo bazë aktuale.	Nuk duhet të përzihet me BEBR-të ekzistuese.

Çfarë nënkupton realisht “ndarja e energjisë”

Ndarja e energjisë shpesh kuptohet gabimisht si dërgim fizik i energjisë nga një panel solar i caktuar te një banesë e caktuar. Kjo nuk është mënyra si funksionon rrjeti publik. Elektronet ndjekin ligjet fizike të rrjetit; operatori i rrjetit mban përgjegjësinë për sigurinë, tensionin dhe vazhdimësinë e furnizimit. Ajo që BEBR-ja mund të realizojë është një **alokim i verifikuar, për qëllime të faturimit dhe barazimit**, i bazuar në gjenerimin e matur, konsumin e matur dhe rregullat e miratuara për ndarje. [S6, fq. 22-24]

Nga energjia e prodhuar te fatura e anëtarit

Ndarja është një alokim kontabël i bazuar në matje zyrtare dhe i pasqyruar në faturë - jo transport fizik i elektroneve tuara.



Përfundim: furnizuesi vazhdon të faturojë konsumatorin. BEBR-ja nuk e zëvendëson automatikisht furnizuesin.

Figura 1. Katër shtresat nga gjenerimi te fatura e anëtarit. Burimi: Kornizë konceptuale e GEK-së, e ndërtuar mbi [S1, nenet 25-28] dhe [S6, fq. 22-24].

Ky dallim është vendimtar sepse përcakton kush mban përgjegjësi për çfarë. OSSH ose OST mund të jenë burimi zyrtar i të dhënave; një mekanizëm i miratuar e llogarit alokimin; furnizuesi reflekton rezultatin në faturën e anëtarit; ndërsa BEBR-ja administron marrëveshjen e anëtarëve dhe asetet e saj. Nëse këto funksione përzihen, rrezikohen faturimi, përgjegjësia për balancim dhe besimi i konsumatorit.

Pse BEBR-të kanë rëndësi për Kosovën

Energjia komunitare krijon një hapësirë ndërmjet modelit të pastër individual dhe modelit të pastër korporativ. Në vend që një familje, komunë ose biznes i vogël të duhet të veprojë vetëm, BEBR-ja mund të krijojë strukturë për investim të përbashkët, ndarje të rrezikut, përdorim të kulmeve publike, krijim të fondit solidar dhe përfshirje të familjeve që nuk kanë kapital të mjaftueshëm për instalim individual.

Për Kosovën, kjo mund të ketë vlerë në disa drejtime: **pjesëmarrja e qytetarëve** në projektet e BRE-së; **përdorimi i aseteve publike** si kulmet e shkollave dhe objekteve komunale; **mundësia rurale** ku ngarkesa bujqësore dhe gjenerimi diellor mund të lidhen më mirë; **përfshirja sociale** përmes aksioneve solidare dhe masave të eficiencës; dhe **tranzicioni i drejtë** në zona që kërkojnë të kthejnë asetet dhe aftësitë lokale në vlerë të re energjetike.

Megjithatë, BEBR-të nuk e zëvendësojnë nevojën për investime në rrjet. Ato nuk krijojnë energji pa kosto, nuk e heqin nevojën për furnizues, nuk e justifikojnë automatikisht uljen e tarifave dhe nuk garantojnë kursime për secilin anëtar. Vlera e tyre varet nga modeli financiar, profili i konsumit, çmimet, kushtet e kyçjes, tarifa, marrëveshjet dhe aftësia për të menaxhuar projektin në afat të gjatë.



KUFIRI I PREMTIMIT

Një BEBR e projektuar mirë nuk premtton “energji falas”. Ajo shpjegon qartë çfarë prodhon aseti, çfarë ndahet, çfarë vazhdon të faturohet nga furnizuesi, cilat tarifa mbeten dhe cilat rreziqe mbahen nga anëtarët.

KONTEKSTI LIGJOR DHE RREGULLATIV

Korniza juridike e Kosovës

Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë krijon bazën kryesore për BEBR-të. Ai njeh anëtarë ose aksionarë që mund të jenë persona fizikë, NMVM, komuna dhe konsumatorë, përfshirë familjet me të ardhura të ulëta ose në nevojë. Ai e përshkruan BEBR-në si subjekt juridik autonom, të kontrolluar efektivisht nga anëtarët ose aksionarët pranë projekteve që zotëron dhe zhvillon. [S2, nenet 32-33]

Ligji u jep BEBR-ve të drejtën të prodhojnë, konsumojnë, ruajnë, shesin dhe ndajnë energji të prodhuar nga njësitë e tyre, mbi bazën e marrëveshjes së alokimit. Në të njëjtën kohë, ai kërkon që ZRRE të nxjerrë akte nënligjore për autorizim, operim, regjistrim dhe regjistër, si dhe për rolet e operatorëve, furnizuesve dhe palëve të tjera në kyçje, ndarje, matje, balancim, faturim dhe kompensim. [S2, nenet 33-34]

Kjo ndarje e kompetencave është e rëndësishme. Ligji përcakton të drejtën dhe mandatin; rregullat e ZRRE-së duhet të përcaktojnë mënyrën e zbatimit; ndërsa procedurat teknike, metodologjitë tarifore dhe protokollat e të dhënave duhet të operacionalizojnë aktivitetin. Nëse këto nivele përzihen, rrezikohet që rregulli të kërkojë më shumë sesa mund të zbatohet përmes akteve ekzistuese ose sistemeve të operatorëve.

Çfarë rregullon secili instrument

Instrumenti	Çfarë mbulon	Pse ka rëndësi për BEBR
Ligji Nr. 08/L-258	Baza për BEBR-të, të drejtat, kontrolli lokal, ndarja, roli i ZRRE-së dhe operatorëve.	Përcakton çfarë mund të jetë BEBR-ja dhe çfarë duhet të rregullohet më tej.
Rregulla Nr. 03/2022 për autorizim	Procedura për autorizimin e ndërtimit të projekteve të energjisë.	Duhet të zbatohet kur projekti kërkon autorizim; nuk duhet të kthehet në leje të përgjithshme për çdo subjekt BEBR.
Rregulla Nr. 03/2023 për vetë-konsumatorë	Korniza për vetë-konsum nga BRE dhe konfigurime të përbashkëta sipas kushteve të saj.	Krijon rrugë ekzistuese për raste të thjeshta, sidomos në ndërtesa.
Rregulla Nr. 01/2024 për tarifat e shpërndarjes	Parimet për tarifat e shfrytëzimit të sistemit dhe taksat e kyçjes.	Përbën bazë për trajtim tarifor; rregulla BEBR nuk duhet të krijojë tarifë paralele.
Rregullat e Tregut	Marrëdhënie tregu, palë tregtare, llogari, balancim dhe obligime relevante.	Përcaktojnë kushtet kur BEBR kalon nga alokimi i brendshëm te pjesëmarrja në treg.
Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Subjektet e të dhënave, kontrolluesit, përpunuesit, bazat ligjore dhe shkeljet.	Kërkon ndarje të qartë të roleve në regjistër, matje, faturim dhe platforma.

Acquis i Komunitetit të Energjisë dhe konteksti evropian

Neni 22 i Direktivës së Përshtatur për Energjinë e Ripërtërishme kërkon një kornizë mundësuese për komunitetet e energjisë nga burimet e ripërtërishme. Kjo përfshin heqjen e barrierave të pajustificuara, procedura proporcionale, bashkëpunim të operatorëve të rrjetit, trajtim jodiskriminues, tarifa që pasqyrojnë kostot dhe përfitimet e rrjetit, lehtësim të aksesit për familjet e cënueshme dhe mbështetje për autoritetet publike. [S6, fq. 14-18]

Kjo nuk do të thotë se çdo funksion i avancuar duhet të jetë aktiv menjëherë. Përkundrazi, udhëzimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë theksojnë se ndarja e energjisë duhet të përputhet me afatet e sakta për balancim, matje dhe barazim; gjithashtu, anëtarët mund të mbajnë marrëdhënien e tyre me furnizuesin për energjinë që komuniteti nuk e mbulon. [S6, fq. 16, 22-24]

Praktikat evropiane janë të dobishme si mësim, por jo si modele që kopjohen pa përshtatje. Portugalia tregon nevojën për koordinator dhe marrëdhënie të qarta me operatorin; Luksemburgu tregon vlerën e formularëve të standardizuar dhe menaxhimit të ndryshimeve; Austria tregon se trajtimi tarifar kërkon analizë të kostove dhe përfitimeve; Çekia tregon se ndarja e gjerë kërkon platformë të fuqishme qendrore të të dhënave. Këto janë mësimet krahasuese, jo burim ligjor për Kosovën.

DRAFT-RREGULLA SI SISTEM

Çfarë bën mirë Draft-Rregulla

Draft-Rregulla shkon përtej një rregulli të thjeshtë për PV. Ajo përpiqet të ndërtojë një ekosistem: status juridik dhe qeverisje, autorizim dhe regjistrë, struktura me disa lokacione, kyçje, njehsorë, tarifa, ndarje statike, dinamike ose hibride, faturim, teprica, furnizues, konsumatorë të cënueshëm, të dhëna dhe dispozita kalimtare. Kjo shtrirje është vlerë e rëndësishme dhe duhet të ruhet. [S1]

Fusha	Çfarë parasheh Draft-Rregulla	Pse është e vlefshme
Statusi juridik dhe qeverisja	Nenet 3-8 parashohin formë juridike, qëllim, vendimmarrje, autonomi, delegim dhe konflikt interesi.	Krijon bazë për të parandaluar që BEBR-ja të jetë vetëm një mjet i zhvilluesit ose investitorit.
Autorizimi dhe regjistrimi	Nenet 9-11 bëjnë dallim formal ndërmjet procedurave dhe krijojnë regjistrë.	Siguron gjurmueshmëri dhe lidhje me kërkesat e ndërtimit.
Veprimtaria në disa lokacione dhe afërsia	Nenet 12-13 pranojnë se BEBR mund të ketë disa asete, pika dhe komuna, me kriter afërsie.	Hap mundësi për projekte më të larmishme dhe përfshirje komunale.
Ndarja, matja dhe faturimi	Nenet 24-28 njohin tarifat, të dhënat zyrtare, të drejtën për ndarje dhe faturimin nga furnizuesi.	Vendos drejtimin e duhur: energjia e ndarë duhet të jetë e matshme dhe e faturueshme.
Balancimi dhe tepricat	Nenet 30-32 dallojnë alokimin e brendshëm nga pjesëmarrja në treg dhe parashohin opsione për tepricën.	Eviton që çdo BEBR të trajtohet automatikisht si palë tregtare.
Përfshirja sociale	Nenet 39-41 njohin të drejtat e konsumatorëve të cënueshëm dhe dimensionin gjinor e edukues.	Vendos drejtim të rëndësishëm për akses më të gjerë.
Të dhënat dhe siguria	Nenet 44-50 trajtojnë qasjen, rolet e përpunimit dhe mekanizmat digjitalë.	E pranon se BEBR-të nuk mund të funksionojnë pa qeverisje të të dhënave.
Tranzicioni	Neni 56 parashikon përgatitje të operatorëve dhe lidh fazën e avancuar me akte të tjera.	Pranon se disa funksione kërkojnë maturim institucional.

Ku nevojitet përmirësim

Draft-Rregulla vendos parime të rëndësishme për zhvillimin e Bashkësive të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, por në disa raste supozon ekzistencën e mekanizmave teknikë dhe institucionalë që ende nuk janë të përcaktuar ose funksionalë në praktikë. Përmirësimet duhet të fokusohen në operacionalizimin gradual të këtyre elementeve, duke përcaktuar qartë mënyrën e zbatimit të sistemit të alokimit të energjisë, ndërveprueshmërisë së sistemeve të matjes dhe faturimit, trajtimit tarifar, procedurave të korrigjimit, si dhe roleve dhe përgjegjësisë të pjesëmarrësve në treg..

Autorizimi kundrejt regjistrimit

Neni 9 thotë se BEBR-të duhet të autorizohen dhe regjistrohen për të ushtruar veprimtarinë. Kjo është e dobishme sepse njeh dy procese, por mund të lexohet sikur çdo BEBR - edhe ajo që ende nuk ndërton aset - duhet të kalojë autorizim për ndërtim. [S1]

PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR



Të sqarohen katër shtigje: formimi juridik; regjistrimi BEBR; autorizimi i projektit kur kërkohet; licencimi/tregu vetëm kur aktiviteti e kërkon.

Afërsia dhe veprimtaria në disa lokacione

Nenet 12-13 e pranojnë veprimtarinë në disa lokacione dhe lidhin afërsinë me komunën ose komunat kufitare. Kjo është qasje e hapur, por afërsia sociale/juridike nuk e provon automatikisht realizueshmërinë e ndarjes së energjisë. [S1]

PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR



Të shtohet koncepti i “perimetrit teknik të ndarjes” për matje, tarifa, humbje, faturim dhe siguri të rrjetit.

Matja dhe alokimi

Nenet 25-27 e vendosin operatorin si burim zyrtar dhe parashohin modelet statike, dinamike dhe hibride. Mirëpo, nuk përshkruajnë hierarkinë, intervalin, humbjet, ruajtjen, korrigjimet ose hyrjet/daljet. [S1]

PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR



Parimet në Rregull; algoritmi dhe procesi në Specifikim Teknik të ZRRE-së.

Tarifat

Neni 24 vendos parimin e përdorimit real të rrjetit dhe mosngarkimit të dyfishtë. Por nuk ka instrument që e përkthen atë parim në trajtim të zbatueshëm për konfigurime të ndryshme. [S1]



PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR

Metodologji ose vendim tarifor para zbatimit të përgjithshëm të ndarjes shumë-pikëshe.

Faturimi dhe furnizuesit

Neni 28 mbron furnizuesin dhe të drejtën e ndërrimit. Por nuk specifikon formatin e faturës, afatin për korrigjim, ndryshimin e furnizuesit në mes të ciklit dhe ndërveprueshmërinë. [S1]



PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR

Protokoll OSSH-furnizues dhe faturë model për BEBR.

Tepricat dhe balancimi

Nenet 31-32 nuk e bëjnë alokimin e brendshëm PPB automatik. Mirëpo, pronësia e tepricës dhe lidhja me kontratën e furnizuesit/trajtuesit kërkon qartësi. [S1]



PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR

Rregull për rrugën e tepricës, palën kontraktuese dhe përgjegjësinë për balancim.

Përfshirja sociale

Neni 39 njeh konsumatorët e cenueshëm, por më shumë se drejtim i përgjithshëm kërkohet kur përdoren kulme publike, grantet ose garancitë publike. [S1]



PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR

Plan i detyrueshëm për Përfshirje Sociale dhe Ndarje të Përfitimeve në projektet e mbështetura publikisht.

Të dhënat dhe siguria

Kapitujt digjitalë janë të dobishëm, por disa formulime mund të ngarkojnë një BEBR të vogël me kërkesa të ngjashme me operatorët kritikë. [S1]



PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR

Model me tre nivele rreziku dhe rrugë raportimi sipas ligjit për të dhënat dhe sigurinë kibernetike.

Tranzicioni

Neni 56 parashikon afat gjashtëmuor për operatorët, por zbatimi varet edhe nga furnizuesit, ZRRE, tregu dhe qeverisja e të dhënave. [S1]



PËRMIRËSIMI I PROPOZUAR

Kriteret e gatishmërisë për aktivizim dhe raport vjetor publik mbi zbatimin.

TESTI I REALITETIT NË KOSOVË

Gatishmëria aktuale e sistemit

Kosova mund të fillojë tani me BEBR-të si subjekte juridike, qeverisje komunitare, zhvillim asetesh, marrëveshje për kulme publike, fonde përfitimi komunitar dhe projekte të eficiencës. Korniza për vetë-konsumatorët tashmë jep një rrugë për raste më të thjeshta të vetë-konsumit individual ose të përbashkët. [S4]

Ndërkohë, zbatimi i ndarjes së energjisë ndërmjet shumë pikave matëse kërkon më shumë se sa një nen në rregull. Raportet e ECRB-së e vendosin Kosovën në një fazë të hershme për disa funksione të konsumatorëve aktivë dhe fleksibilitetit; ato theksojnë rëndësinë e matjes inteligjente, ndërveprueshmërisë së të dhënave dhe mekanizmave të tregut. [S7]; [S8] Kjo nuk përjashton pilotet, por kërkon që pilotet të jenë të kontrolluara dhe të verifikojnë funksionimin e vërtetë të zinxhirit të të dhënave dhe faturimit.

Aktiviteti	Statusi aktual	Pse	Çfarë kërkohet
Formimi i BEBR-së	Mund të fillojë tani	Ligji dhe Draft-Rregulla ofrojnë bazë për subjekt juridik, qeverisje dhe regjistër.	Statut model, proces regjistrimi, informim publik.
Vetë-konsum individual / i përbashkët	Rrugë ekzistuese	Korniza e vetë-konsumatorëve ekziston.	Zbatim sipas rregullës së vetë-konsumatorëve dhe kushteve të kyçjes.
Ndarje statike shumë-pikëshe	Pilot i kontrolluar	Kërkon njehsorë të kualifikuar, format të të dhënave, validim dhe test faturimi.	Vendim pilot, protokoll OSSH-furnizues, trajtim tarifor pilot.
Ndarje dinamike / hibrid	Fazë e ardhshme	Kërkon të dhëna të matjes sipas intervaleve kohore (interval data), sistem për llogaritjen e alokimit, korrigjime dhe ndërveprueshmëri.	Specifikim teknik, test i plotë dhe dëshmi të gatishmërisë për aktivizim.
Agregim / fleksibilitet	Fazë e ardhshme	Kërkon produkte tregu, rregulla balancimi, kualifikim dhe kontrata.	Akte tregu dhe balancimi të zbatueshme.
Ndarje e gjerë komunale	Nuk rekomandohet fillimisht	Kërkon zgjidhje për zona të ndryshme rrjeti, tarifa dhe të dhëna.	Platformë dhe metodologji e pjekur pas përvojës së pilotëve.

Pse nevojiten kriteret e gatishmërisë për aktivizim

Një afat kalendarik mund të nxisë institucionet të veprojnë, por nuk provon se një sistem funksionon. Për shembull, ndarja dinamike mund të shkruhet në një rregull, por ajo nuk mund të prodhojë faturë të saktë nëse nuk dihet intervali, nëse njehsori nuk dërgon të dhëna të validuara, nëse furnizuesi nuk mund të pranojë skedarin e alokimit ose nëse rregulli nuk përcakton çfarë ndodh kur të dhënat janë të gabuara.

Kriteret e gatishmërisë për aktivizim shërbejnë si kontroll institucional: një funksion aktivizohet vetëm kur institucioni përgjegjës demonstroi se kushtet e tij ekzistojnë. Kjo nuk është vonesë e panevojshme. Është mënyrë për të mos e bërë anëtarin e parë të BEBR-së testues të paqartësive të faturimit, tarifimit ose të dhënave.

Udhërrëfyti i gatishmërisë: nga themelimi te pjesëmarrja e avancuar

Aktivizimi i çdo funksioni varet nga prova e gatishmërisë, jo vetëm nga kalimi i kohës.



Nuk ka “aktivizim automatik” të ndarjes dinamike, agregimit ose fleksibilitetit pa provë të matjes, të dhënave, faturimit dhe rregullave.

Figura 2. Udhërrëfyti i gatishmërisë për funksionet e BEBR-ve. Burimi: Kornizë e propozuar nga GEK, e bazuar në [S1, neni 56] dhe [S6, fq. 22-24].

OPSIONET DHE MODELI I REKOMANDUAR

Modele alternative për Kosovën

Opsioni i parë është **ndarja e gjerë komunale**: një BEBR do të mund të alokonte energji në të gjithë komunën ose komunat kufitare. Ky opsion ka forcë politike dhe sociale, sepse lejon lidhjen e kulmeve publike me qytetarët. Por kufiri administrativ nuk tregon domosdoshmërisht se konsumatorët përdorin të njëjtin nivel rrjeti, të njëjtën nënstacion ose të njëjtën logjikë tarifore. Pa zgjidhje të pjekur të të dhënave dhe tarifave, ai rrezikon të bëhet virtual net metering (kompensim virtual i energjisë) pa bazë të mjaftueshme.

Opsioni i dytë është **perimetër teknik i kufizuar i ndarjes së energjisë**: ndarja lejohet vetëm në një zonë të përcaktuar teknikisht, si një ndërtesë, një transformator ose zonë e verifikuar nga OSSH. Ky opsion është më i lehtë për matje dhe tarifa, por mund të jetë tepër i ngushtë për projekte komunale ose të tranzicionit të drejtë; gjithashtu, kufijtë teknikë mund të ndryshojnë me përforcimet e rrjetit.

Opsioni i tretë është **modeli i dy niveleve për BEBR-të**: një komunitet juridik mund të ketë anëtarësi, qeverisje, fond solidariteti dhe program investimi në një zonë më të gjerë lokale, ndërsa alokimi faktik i energjisë bëhet vetëm brenda perimetrit teknik të ndarjes së energjisë të validuar. Kjo ruan përfitimin komunitar pa premtuar energji e alokuar ose përfitim nga energjia e alokuar aty ku sistemi nuk e ka verifikuar ende realizueshmërinë.

Modeli	Forca	Kufizimi kryesor	Vlerësimi i GEK
Ndarje e gjerë komunale	Përfshirje e gjerë dhe komunikim i thjeshtë publik.	Kërkon sisteme të pjekura të të dhënave, faturimit dhe tarifave; rrezik i kostove të zhvendosura.	Jo për fazën fillestare.
Perimetër teknik i kufizuar i ndarjes së energjisë	Disiplinë e fortë për rrjet, matje dhe tarifa.	Mund të kufizojë dimensionin komunitar dhe social.	E përshtatshme për alokim fillestar, por jo si model i vetëm.
Modeli i dy niveleve	Qeverisje dhe përfitim lokal më i gjerë, ndërsa alokimi ruan disiplinë teknike.	Kërkon regjistër, marrëveshje dhe administrim më të strukturuar.	Model i rekomanduar për Kosovën.

Modeli i dy niveleve për BEBR-të

Modeli i dy niveleve për BEBR-të ndan funksionet që kanë natyrë të ndryshme. Në nivelin e parë, BEBR-ja organizon anëtarësinë, qeverisjen, investimin, fondin solidar dhe përfitimet komunitare në një zonë më të gjerë lokale. Në nivelin e dytë, ndarja faktike e energjisë realizohet vetëm brenda perimetrit teknik të ndarjes së energjisë, të verifikuar nga operatori përkatës i rrjetit. Ky model ruan përfitimin komunitar dhe kontrollin lokal,

pa krijuar pritje të pasakta se çdo anëtar i BEBR-së mund të marrë automatikisht energji të alokuar nga çdo aset i komunitetit.

Pesë shtresat e modelit të propozuar për BEBR-të

Kornizë konceptuale e GEK-së: qeverisja e komunitetit ndahet nga perimetri teknik i ndarjes drejtes së energjisë.



Figura 3. Pesë shtresat e modelit të propozuar për BEBR-të. Burimi: Kornizë konceptuale e GEK-së.

Në rast se një BEBR e vetme nuk mund të dëshmojë kontroll efektiv lokal mbi disa projekte të ndara, alternativa është **grupim i BEBR-ve**: disa BEBR të regjistruara veçmas mund të përdorin shërbime të përbashkëta, programe trajnimi, mbështetje komunale ose fond zhvillimor, por nuk pretendojnë ndarje automatike të energjisë ndërmjet tyre. Kjo zgjidhje mbron parimin e kontrollit lokal pa bllokuar bashkëpunimin.

SI FUNKSIONON MODELI NË PRAKTIKË

Qeverisja, pronësia dhe kontrolli lokal

Një BEBR nuk mund të matet vetëm me numrin e anëtarëve. Pyetja thelbësore është kush merr vendimet për asetet, kontratat, përfitimet dhe rrezikun. Një strukturë mund të ketë shumë anëtarë formalë, por të kontrollohet faktikisht nga një zhvillues përmes kontratave të delegimit, kapitalit, të drejtave të vetos ose marrëveshjeve të lidhura. Kjo do të cenonte qëllimin e kontrollit efektiv lokal. [S2, neni 33; S6, fq. 3-7]

Për këtë arsye, katër elemente duhet të mbahen të ndara: **e drejta e votës**, e cila garanton pjesëmarrjen demokratike në çështje strategjike; **kontributi kapital**, i cili mund të ndryshojë; **alokimi i energjisë**, i cili lidhet me modelin teknik dhe konsumin e validuar; dhe **kthimi ekonomik**, i cili mund të lidhet me marrëveshje transparente, por nuk duhet të shndërrojë BEBR-në në mjet për maksimizim të fitimit të palëve të jashtme.

Vendimet që duhet të mbeten te anëtarët

Vendimi	Pse duhet të ruhet te anëtarët	Masa mbrojtëse
Shitja ose transferimi i asetit	Ndryshon bazën ekonomike dhe komunitare të projektit.	Miratim i kualifikuar; njoftim paraprak; dokumentim i interesit publik.
Modeli i alokimit	Përcakton përfitimin e anëtarëve dhe mund të krijojë padrejtësi.	Rregulla të qarta; hyrje në fuqi për periudhën pasuese; transparencë.
Kontratat me palë të lidhura	Mund të krijojnë kontroll të fshehur ose çmime jo konkurruese.	Regjistër konflikti; përjashtim nga votimi; miratim i veçantë.
Përdorimi i fondit komunitar	Ndikon në familjet në nevojë dhe projektet e eficientës.	Plan vjetor; raportim publik i agreguar; procedurë ankese.
Hyrja e investitorit të jashtëm	Mund të ndryshojë kontrollin efektiv dhe qëllimin.	Kufij votimi/kontrolli; verifikim i statutit; miratim nga anëtarët.

Matja, alokimi dhe barazimi

Në një konfigurim statik, BEBR-ja përcakton koeficientë të miratuar paraprakisht. Këta koeficientë mund të qëndrojnë të pandryshuar për një muaj ose tremujor, por energjia e alokuar duhet të bazohet në periudhën e ndarjes që sistemi është në gjendje ta verifikojë. “Statik” nuk do të thotë domosdoshmërisht që prodhimi i mesditës mund të përdoret për të zbritur në mënyrë të pakufizuar konsumin e natës; kjo varet nga rregullat e barazimit dhe trajtimit tarifar që duhet të përcaktohen.

Një formulë ilustrative për specifikimin teknik mund të jetë:

$$E_{i,t}(\text{ndarë}) = \min (C_{i,t} , \alpha_{i,t} \times G_t(\text{pranueshme}))$$

Këtu, $E_{i,t}$ ('ndarë') është energjia që i alokohet anëtarit *i* në intervalin *t*; $C_{i,t}$ është konsumi i tij i matur dhe i validuar; $\alpha_{i,t}$ është koeficienti i miratuar; dhe G_t ('pranueshme') është gjenerimi i BEBR-së që pranohet për ndarje pas rregullave për kufizime teknike, humbje, ruajtje ose barazim. Formula nuk duhet të futet domosdoshmërisht në tekstin e Rregullës. Ajo tregon pse një Specifikim Teknik është i domosdoshëm.

Dy kufij mbrojtës duhet të ekzistojnë: një anëtar nuk mund të marrë më shumë energji të alokuar se konsumi i tij i validuar në periudhën përkatëse; dhe shuma e energjisë së alokuar për të gjithë anëtarët nuk mund të tejkalojë energjinë e pranueshme të prodhuar nga asetet e BEBR-së. Kjo parandalon krijimin e kredive virtuale pa bazë në të dhënat reale.

Cikli operacional i një BEBR-je

Çdo hap ekziston për të lidhur qeverisjen e komunitetit me kërkesat e rrjetit, tarifimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.




Figura 4. Cikli operacional i një BEBR-je. Burimi: Kornizë konceptuale e GEK-së.

15. Faturimi, tarifat, tepricat dhe balancimi

Fatura e anëtarit duhet të mbetet e kuptueshme. Ajo duhet të tregojë konsumin total të matur, energjinë e alokuar nga BEBR-ja, energjinë e mbetur të furnizuar nga furnizuesi, komponentët e rrjetit, taksat dhe tarifat, çdo korigjim dhe - kur aplikohet - kredinë ose të ardhurën nga teprica. Neni 28 i Draft-Rregullës e ruan rolin e furnizuesit në lëshimin e faturës dhe mbron të drejtën e anëtarit për ndërrim furnizuesi. [S1, neni 28]

Tarifat nuk duhet të trajtohen si ndëshkim për BEBR-të, por as si përjashtim automatik. Nëse energjia përdor rrjetin publik, kostoja e atij përdorimi duhet të reflektohet në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale. Neni 24 i Draft-Rregullës tashmë e shpreh këtë logjikë dhe ndalon ngarkimin e dyfishtë për të njëjtën energji. [S1, neni 24] Çështja që mbetet është se si kjo zbatohet për konfigurime të ndryshme. Për këtë arsye, vendimi tarifor duhet të paraprijë zbatimin e përgjithshëm të ndarjes shumë-pikëshe.

Teprica duhet të ketë rrugë të qartë: kush e zotëron, kush lidh kontratë, kush e shet, kush mban përgjegjësinë për balancim dhe si ndahen të ardhurat. Neni 32 ofron disa mundësi - ruajtje, shitje ose injektim/kompensim - por raporti ndërmjet asetit të BEBR-së dhe marrëveshjes së furnizuesit të anëtarit kërkon sqarim të mëtejshëm. [S1, nenet 31-32]

Pamja minimale e faturës së anëtarit

Elementi	Çfarë i shpjegon anëtarit	Pse nevojitet
Konsumi total i matur	Sa energji ka përdorur objekti në periudhën e faturimit.	Bazë e transparencës dhe e kontrollit nga konsumatori.
Energjia e alokuar nga BEBR	Sa nga energjia e pranueshme i është ndarë nga komuniteti.	Tregon rezultatin e marrëveshjes së ndarjes.
Furnizimi i mbetur	Sasia që vazhdon të faturohet përmes furnizuesit.	Ruajtja e marrëdhënies me furnizuesin.
Tarifat e rrjetit / taksat	Komponentët e zbatueshëm për përdorimin e rrjetit dhe obligimet publike.	Parandalon përshtypjen e gabuar për “energji falas”.
Korrigjimi	Ndryshim që buron nga të dhëna të përditësuara ose vendim i ankesës.	Mbron anëtarin kur të dhënat korrigjohen.
Rruga e ankesës	Kontakti i furnizuesit, BEBR-së dhe mekanizmi për përshkallëzimin e ankesës.	Mundëson zgjidhje të dokumentuar të kontestit.

Komunat, financimi dhe përfshirja sociale

Komuna mund të jetë partner i fuqishëm për BEBR-të, por nuk duhet të bëhet pronar dominues vetëm sepse sjell një kulm ose tokë. Roli i saj mund të jetë ofrues i së drejtës së përdorimit, pjesëmarrës me ngarkesë kryesore e projektit, bashkëfinancues i studimit të fizibilitetit, lehtësues i procedurave dhe partner i përfshirjes sociale. Përdorimi i aseteve publike duhet të kalojë përmes vlerësimit të pronës publike, prokurimit kur përdoren shpenzime publike, përgjegjësisë për mirëmbajtje, sigurimit dhe kthimit të asetit.

Financimi duhet të ketë shtresa. Në fazën e parë duhen grante zhvillimore për fizibilitet, projektim, statut, vlerësim të kulmit dhe studim kyçjeje. Pastaj mund të hyjnë kapitali i anëtarëve, kontributi komunal, grantet publike ose të donatorëve, kredi koncesionale ose garanci. Vetëm pasi projekti të operojë, kursimet, të ardhurat nga teprica dhe shërbimet mund të kontribuojnë në rezervë dhe fondin e përfitimit komunitar.

Për familjet në nevojë, një model i drejtë nuk është të premtohet “kreditim artificial” i energjisë. Modeli më i fortë është të hiqet pengesa e hyrjes përmes aksioneve solidare, pjesëmarrjes me këste, përmirësimeve të eficiencës energjetike, verifikimit të statusit përmes mekanizmave publikë dhe përfitimeve të qarta. Kjo ruan privatësinë dhe zvogëlon rrezikun që BEBR-ja të kthehet në administruese e të dhënave të ndjeshme sociale.

Të dhënat, privatësia dhe siguria kibernetike

Të dhënat e konsumit dhe prodhimit mund të tregojnë modele të jetesës, përdorim të pajisjeve dhe prani në objekt. Për këtë arsye, anëtarët janë **subjekte të të dhënave personale**, jo “pronarë” të pakufizuar të të gjitha të dhënave zyrtare të barazimit. OSSH/OST mund të mbetet burim i të dhënave zyrtare të matjes;

furnizuesi administron të dhënat e faturimit; BEBR-ja administron të dhënat e anëtarësisë dhe qeverisjes; një platformë e miratuar mund të përpunojë alokimin. [S1, nenet 44-50; S9]

Pëlqimi nuk mund të jetë baza e vetme për çdo përpunim. Matja, faturimi, zbatimi i kontratës, obligimet ligjore dhe siguria e sistemit mund të kërkojnë përpunim edhe kur anëtari nuk pranon ndarje shtesë për optimizim ose komunikim. Kjo duhet të shpjegohet qartë në njoftimin e privatësisë.

Niveli	Kush përfshihet	Kërkesat minimale
Niveli 1	BEBR e vogël me ndarje bazë ose pa ndarje shumë-pikëshe.	Qasje e kufizuar, fjalëkalime të forta, kopje rezervë, kontakt i emëruar, regjistër incidentesh.
Niveli 2	BEBR me integrim digjital, perimetër teknik i ndarjes së energjisë dhe shkëmbim të dhënash.	Marrëveshje përpunimi, ndërfaqe të sigurta, regjistra qasjeje, procedurë korrigjimi dhe incidenti.
Niveli 3	OSSH, OST, furnizues, agregator, platformë qendrore.	Kërkesa sektoriale të sigurisë, reziliencë kibernetike (qëndrueshmëri dhe aftësi rikuperimi), raportim formal incidentesh dhe auditim sipas ligjit përkatës.

Skenarët e stres-testimit

RASTET NË PRAKTIKË

Rasti	Çfarë do të ndodhë në praktikë	Faza e përshtatshme
Ndërtesë banimi me kulm të përbashkët	Mund të përdorë fillimisht rrugën e vetë-konsumatorëve të përbashkët, nëse i plotëson kushtet. BEBR-ja bëhet e nevojshme vetëm kur kërkohet qeverisje më e gjerë, fond komunitar ose model i veçantë pronësie.	Operacional sipas rrugës ekzistuese; jo domosdoshmëri sht pilot BEBR.
Shkollë komunale dhe familje pranë	Mund të formohet BEBR me kulmin e shkollës si aset kryesor i projektit, por ndarja jashtë objektit kërkon Perimetri teknik i ndarjes së energjisë, test faturimi dhe trajtim tarifor.	Pilot i kontrolluar.
Fshat me ngarkesë bujqësore	Profil i mundshëm i mirë për energji diellore gjatë ditës, por duhet vlerësuar ngarkesa, transformatori, kategoria tarifore dhe sezonaliteti.	Pilot i kontrolluar me studim teknik.
Objekt publik dhe familje në nevojë	Pjesëmarrja mund të organizohet tani; ndarja shumë-pikëshe vetëm pas validimit. Përfitimi social mund të fillojë përmes aksioneve solidare dhe eficiencës.	Përfshirje tani; ndarje si pilot.
Obiliq - tranzicion i drejtë	Një BEBR e vetme mund të mbajë qeverisje, fond solidariteti dhe plan investimi. Perimetri i parë teknik i ndarjes së energjisë duhet të jetë i kufizuar dhe i validuar.	Pilot demonstrues.

Rasti	Çfarë do të ndodhë në praktikë	Faza e përshtatshme
Komunë me disa asete publike	Mund të përdorë modelin e dy niveleve ose grupim të BEBR-ve. Nuk duhet të krijojë automatikisht të drejtë për alokim të energjisë në kWh ndërmjet zonave të ndryshme.	BEBR në fazën fillestare tani; disa perimetra teknike të ndarjes së energjisë pas validimit.
BEBR me NMVM	NMVM mund të marrë pjesë brenda kufijve ligjorë dhe pa kontroll disproporcional; alokimi nuk duhet të maskojë furnizim komercial.	BEBR në fazën fillestare tani; ndarje pilot.
Anëtarë me disa furnizues	E drejta e furnizuesit ruhet, por ndarja kërkon format të përbashkët të të dhënave dhe test të faturimit.	Pilot pas testit të ndërveprueshmërisë.
Dalja e anëtarit në mes të ciklit	Duhet datë efektive, faturë përfundimtare dhe ndarje vetëm përpara, jo rikalkulim retroaktiv i pakontrolluar.	Masa operative e detyrueshme.
Të dhëna të gabuara të njehsorit	Duhet korrigjim i bazuar në burim zyrtar, faturë korrigjuese dhe pezullim i penaliteteve për pjesën e kontestuar.	Masa operative e detyrueshme.
Kufizimi i prodhimit nga OSSH-ja (curtailment)	Vetëm gjenerimi real i validuar mund të ndahet; regjistri i kufizimit të prodhimit duhet të hyjë në procesin e barazimit.	Kërkohej regjistër i auditueshëm.
Bateri ose ruajtje	Lejohet në parim, por kërkon trajtim të veçantë për burimin e karikimit, humbjet, dyfishimin e përfitimeve dhe matjen.	Pilot i avancuar / fazë e ardhshme.
Karikim EV	Mund të instalohet si infrastrukturë, por fleksibiliteti dhe tregtimi kërkojnë rregulla të ardhshme.	Infrastrukturë tani; funksion tregu më vonë.
Shitja e tepicës	Duhet palë kontraktuese e emëruar dhe rrugë e qartë e balancimit.	Pilot nëse ekziston kontratë e ligjshme.
Propozim ndërkomunal	Bashkëpunim qeverisës mund të ekzistojë; ndarja energjisë ndërmjet zonave nuk rekomandohet fillimisht.	Fazë e ardhshme.
Agregimi/fleksibiliteti	Nuk duhet të premtohet si burim i menjëhershëm i të ardhurave.	Fazë e ardhshme pas rregullave të tregut.

Çfarë do të thotë modeli për sistemin elektroenergjetik

Për OSSH-në, modeli kërkon më shumë se lidhje fizike. Ai kërkon proces të qartë për validimin e perimetrit teknik, cilësinë e të dhënave dhe trajtimin e kufizimeve. Për furnizuesin, modeli kërkon skedar ose ndërfaqe që dallon konsumin total, alokimin e BEBR-së dhe pjesën e mbetur për faturim. Për anëtarin, modeli kërkon faturë që mund të lexohet pa njohuri teknike. Për ZRRE-në, modeli kërkon monitorim të efekteve tarifore dhe të ankesave.

Për konsumatorët jopjesëmarrës, masa mbrojtëse kryesore është që BEBR-të të mos marrin përfitim të fshehur nga rrjeti në kurriz të tyre. Kjo është arsyeja pse çdo trajtim tarifar i diferencuar duhet të bazohet në përdorim real të rrjetit dhe analizë të kostos. Për komunitetin, masa mbrojtëse kryesore është që rregulli të mos kërkojë teknologji ose detyrime disproporcionale para se ato të jenë të nevojshme.

SISTEMI I ZBATIMIT

ZBATIMI

Instrumentet dytësore të nevojshme

Draft-Rregulla duhet të vendosë kornizën dhe kushtet. Nuk duhet të përpiqet të përmbajë normat e detajuara të algoritmit, tarifat numerike, formatet e TI-së, kontratat komunale ose skemat e financimit. Këto duhet të ndahen në instrumente të specializuara që mund të konsultohen dhe përditësohen pa krijuar pasiguri juridike për parimet kryesore.

Instrumenti	Çfarë përmban	Kush e udhëheq	Çfarë ndodh pa të
Specifikimi Teknik për Ndarjen e Energjisë	Intervali i alokimit, koeficientët, humbjet, ruajtja, kufizimi, korrigjimi, hyrja/dalja e anëtarëve, finaliteti i barazimit.	ZRRE; me kontribut OSSH/OST/furnizues.	Pa të, Neni 27 mbetet drejtim pa proces operativ.
Vendimi / metodologjia tarifore	Trajtimi i përdorimit real të rrjetit për konfigurime të ndryshme.	ZRRE.	Pa të, parimi i Nenit 24 nuk mund të zbatohet në mënyrë konsistente.
Procedura e OSSH-së për verifikimin e perimetrit teknik të ndarjes së energjisë	Vlerësimi teknik paraprak, njehsorët, kapaciteti, validimi, aktivizimi dhe refuzimi i arsyetuar.	OSSH, e mbikëqyrur nga ZRRE.	Pa të, perimetri teknik i ndarjes së energjisë mbetet term i paoperacionalizuar.
Protokolli OSSH-furnizues	Burimi i të dhënave, formatet, afatet, faturat korrigjuese, ndërrimi i furnizuesit.	OSSH dhe furnizuesit; ZRRE për mbikëqyrje.	Pa të, anëtari mund të marrë faturë të gabuar ose të vonuar.
Protokolli për trajtimin e tepricës së energjisë dhe përgjegjësinë për balancim	Prona, kontrata, PPB, shitja, ruajtja dhe të ardhurat.	KOSTT/operatori i tregut/pala kontraktuese; ZRRE për përputhshmëri.	Pa të, teprica mund të mos ketë rrugë juridike dhe tregtare.
Protokolli komunal	Përdorimi i kulmit/tokës, prokurimi, qeverisja, mirëmbajtja, raportimi.	Komunat dhe Ministria.	Pa të, projektet publike mund të vonohen ose të krijojnë konflikt interesi.
Zyra e vetme e mbështetjes për BEBR-të (one-stop shop)	Modele statutore, trajnime, vlerësim fillestar i kërkesave, lista kontrolli, ndihmë për financim.	Ministria, me koordinim institucional.	Pa të, komunitetet e vogla përballen me kosto të larta zhvillimi.

Rolet institucionale dhe llogaridhënia

ZRRE duhet të ruajë rolin e saj rregullativ: miraton rregullin, specifikimet, vendimet tarifore, kriteret e pilotit dhe mbikëqyrjen e konsumatorit. Ministria duhet të udhëheqë dimensionin e zbatimit dhe mbështetjes: informacion, dokumente model, koordinim me komuna dhe qasje në financim. OSSH mban përgjegjësi për kyçjen, matjen dhe të dhënat zyrtare; furnizuesit për faturimin; KOSTT dhe mekanizmat e tregut për rolet që lidhen me balancimin dhe tregun; BEBR për qeverisjen, asetet, anëtarësinë dhe marrëveshjet e brendshme.

Fusha	Përgjegjësia kryesore	Konsultimi / bashkëpunimi
Rregulla dhe monitorimi	A/R: ZRRE	C: Ministria, OSSH, OST, furnizuesit, komunitat, BEBR
Specifikimi teknik	A: ZRRE; R: OSSH/OST për kontribut teknik dhe zbatim	C: furnizuesit, BEBR, KOSTT
Tarifat	A/R: ZRRE	C: OSSH, OST, furnizuesit, konsumatorët
Matja dhe validimi	A/R: operatori përkatës i rrjetit	C: ZRRE, furnizuesi, BEBR
Faturimi dhe korrigjimi	R: furnizuesi; A: furnizuesi për faturën	C: OSSH, ZRRE, BEBR
Asetet komunale	A/R: komuna për procesin publik	C: BEBR, Ministria
Përfshirja sociale	A/R: BEBR për planin; komuna për mekanizma publikë	C: Ministria, partnerët financiarë
Pilotet	A: ZRRE; R: BEBR dhe operatorët në rolet e tyre	C: Ministria, komuna, furnizuesit

Udhërrëfytyesi 2026-2031

Etapë e gatishmërisë	Çfarë duhet të plotësohet	Kush konfirmon	Çfarë aktivizohet
G0 - Themeli	Rregulla, regjistër, dokumente model, pikë mbështetëse, koordinim institucional.	ZRRE/Ministria	BEBR në fazën fillestare dhe zhvillim projekti.
G1 - Pilot statik	Njehsorë të kualifikuar, trajtim tarifor pilot, test faturimi, marrëveshje alokimi.	OSSH/furnizuesit/ZRRE	Ndarje statike në pilot.
G2 - Zgjerim statik	Specifikim teknik, korrigjime, ankesa, raporte pilot, procedura standarde.	ZRRE/OSSH/furnizuesit	Zbatim i zgjeruar statik.

Etapë e gatishmërisë	Çfarë duhet të plotësohet	Kush konfirmon	Çfarë aktivizohet
G3 - Avancim	Të dhëna të matjes sipas intervaleve kohore (interval data), sistem për llogaritjen e alokimit, ndërveprueshmëri shumë-furnizues, siguri e forcuar.	Operatorët/ZRRE	Ndarje dinamike dhe hibride.
G4 - Treg dhe fleksibilitet	Rregulla tregu, balancim, agregim, ruajtje dhe produkte fleksibiliteti.	KOSTT/operatori i tregut/ZRRE	BEBR tregtare e avancuar.

Monitorimi, mësimi dhe rishikimi

Raportimi nuk duhet të jetë barrë formale për një komunitet të vogël. Ai duhet të jetë proporcional. Një BEBR në fazën fillestare mund të raportojë anëtarësinë, kapacitetin, gjenerimin dhe statusin e projektit; një BEBR me ndarje statike duhet të raportojë perimetrin teknik të ndarjes së energjisë, alokimit, ankesat dhe korrigjimet; një BEBR aktive në treg duhet të ketë kërkesa shtesë sipas veprimtarisë.

ZRRE duhet të publikojë një raport vjetor të agreguar për BEBR-të: numri i komuniteteve, kapaciteti, gjenerimi, energjia e alokuar, pengesat e kyçjes, ankesat, pjesëmarrja e komunave dhe familjeve në nevojë, efektet e pilotëve dhe rekomandimet për rregullim të mëtejshëm. Kjo lidhet me detyrën ligjore për vlerësimin e barrierave dhe potencialit të BEBR-ve. [S2, neni 35]

POZICIONI FORMAL DHE NDRYSHIMET

Kërkesat formale të GEK-së për ZRRE

Kërkesa	Arsyeja	Rezultati i synuar
Miratoni Draft-Rregullën me arkitekturën e saj bazë	Korniza trajton tashmë temat thelbësore dhe ka bazë në Ligjin Nr. 08/L-258.	Ruan momentumin rregullativ ndërsa adreson boshllëqet e zbatimit.
Sqaroni Nenin 9	Autorizimi për ndërtim nuk duhet të kthehet në kërkesë automatike për BEBR që ende nuk ndërton projekt.	Shmang dyfishim procedural dhe mospërputhje me Rregullën Nr. 03/2022.
Shtoni perimetrin teknik të ndarjes	Afërsia nuk mjafton për të provuar matjen, tarifën dhe faturimin.	Mbron sigurinë dhe realizueshmërinë pa kufizuar qeverisjen lokale.
Aktivizoni ndarjen në faza	Statik në pilot; dinamik/hibrid pas provës së gatishmërisë.	Shmang gabime faturimi dhe pritje të pasakta të anëtarëve.
Miratoni instrumente të ndara	Tarifa, specifikim teknik, protokoll të dhënash/faturimi dhe procedurë OSSH.	Bën të zbatueshme nenet që tashmë ekzistojnë.
Forconi përfshirjen sociale të lidhur me burimet publike	Kur BEBR përdor grant, kulm/tokë publike ose garanci, duhet plan konkret social.	Kthen parimin e Nenit 39 në rezultat të matshëm.
Përdorni proporcionalitet për të dhënat dhe sigurinë kibernetike	Detyrimet duhet të varen nga rreziku dhe funksioni i BEBR-së.	Mbron privatësinë pa krijuar barrë të pamundur për komunitete të vogla.
Zëvendësoni tranzicionin vetëm kalendarik	Kushtet teknike, tarife dhe të faturimit duhet të provohen.	Krijon rrugë të besueshme drejt shkallëzimit.

Matrica nen-për-nen

Matrica e mëposhtme përmbledh vlerësimin e GEK-së. Ajo nuk synon të përsërisë çdo fjalë të Draft-Rregullës. Ajo identifikon dispozitat ku kërkohet mbështetje e qartë, sqarim, ndryshim, instrument i veçantë ose aktivizim i ardhshëm.

Neni / Shtojca	Vlerësimi	Çfarë parasheh	Propozimi i GEK
Nenet 1-2	Mbështetje me sqarim	Qëllimi dhe përkufizimet.	Të ndahen qartë “autorizimi për ndërtim”, regjistrimi dhe aktiviteti i licencuar.

Neni / Shtojca	Vlerësimi	Çfarë parasheh	Propozimi i GEK
Nenet 3-7	Mbështetje me sqarim	Forma juridike, qeverisja, delegimi dhe konfliktet.	Të forcohen vendimet e rezervuara, kontratat me palë të lidhura dhe kontrolli efektiv.
Neni 8	Mbështetje me sqarim	Kufiri me furnizimin dhe tregun.	Të sqarohet se alokimi i brendshëm nuk zëvendëson kërkesat për aktivitet tregtar kur ai kryhet.
Nenet 9-11	Ndryshim	Autorizimi, regjistrimi dhe regjistri.	Katër shtigje; regjistër publik dhe i kufizuar operacional.
Nenet 12-13	Ndryshim	Veprimtaria në disa lokacione dhe afërsia.	Të shtohet perimetri teknik i ndarjes dhe sqarimi i kontrollit lokal.
Nenet 16-23	Mbështetje me sqarim	Kyçja, kërkesat teknike, njehsorët, emergjencat.	Të kërkojnë alternativa teknike, regjistër kufizimi dhe kategori ndryshimesh.
Neni 24	Mbështetje me instrument të veçantë	Parimet tarifore.	Metodologji/ vendim tarifar para zbatimit të gjerë.
Nenet 25-28	Ndryshim + specifikim teknik	Të dhënat, ndarja, modelet dhe faturimi.	Të përcaktohen interвали, korrigjimet, formatet, faturat dhe ndërimi i furnizuesit.
Nenet 30-32	Aktivizim fazor	Agregimi, balancimi dhe tepricat.	Të lidhen me rregullat tregtare, PPB dhe palë kontraktuese të emëruar.
Nenet 33-38	Mbështetje me sqarim	Të drejtat/detyrimet e BEBR, operatorëve dhe furnizuesve.	Detyrimet e alokimit të operatorit të lidhen me specifikim të miratuar; faturat korrigjuese të përkufizohen.
Nenet 39-41	Ndryshim i synuar	Përfshirja sociale, gjinore dhe edukimi.	Plan social i detyrueshëm kur përdoren burime publike.
Nenet 42-43	Mbështetje me sqarim	Monitorimi dhe raportimi.	Raportim proporcional dhe raport publik vjetor i ZRRE-së.
Nenet 44-50	Ndryshim i synuar	Të dhënat, siguria kibernetike dhe platformat.	Të sqarohen rolet e të dhënave, baza ligjore dhe proporcionaliteti i incidenteve.
Nenet 51-52	Mbështetje me sqarim	Inovacioni dhe kontestet.	Pilotet me vendim formal; procedurë minimale e brendshme e ankesave.
Nenet 53-58	Ndryshim i synuar	Harmonizimi, interpretimi, tranzicioni dhe shtojcat.	Plan i harmonizimit, kriteret e gatishmërisë për aktivizim dhe korrigjime redaktuese.
Shtojcat 1-6	Ndryshim	Formularët dhe ndryshimet.	Korrigjime referencash, qasje e sigurt për të dhëna personale, fushë për perimetrin teknik të ndarjes së energjisë dhe modelin hibrid.

Teksti i konsoliduar i ndryshimeve prioritare

Teksti i mëposhtëm është i propozuar për konsultim dhe synon të ruajë strukturën e Draft-Rregullës. Ai duhet të harmonizohet teknikisht nga ZRRE me aktet ekzistuese të autorizimit, kyçjes, tarifave, tregut, matjes dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Neni 9 - Autorizimi për Ndërtim dhe Regjistrimi

“1. BEBR-ja themelohet si subjekt juridik në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe regjistrohet në Regjistrin e BEBR-ve para aktivizimit të veprimtarive që rregullohen me këtë Rregull. 2. Autorizimi për ndërtim kërkohet vetëm për projektet, instalimet ose ndryshimet teknike për të cilat një autorizim i tillë kërkohet sipas legjislacionit dhe procedurave në fuqi. 3. Licencimi, regjistrimi në treg ose përgjegjësia për balancim zbatohen vetëm kur BEBR-ja ushtron aktivitetin përkatës.”

Tekst i propozuar nga GEK.

Neni i ri 13A - Afërsia dhe perimetri teknik i ndarjes

“1. Afërsia e anëtarëve ose aksionarëve me projektin vlerësohet për qëllime të kontrollit efektiv lokal, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe realizimit të përfitimeve për komunitetin. 2. Përmbushja e kriterit të afërsisë nuk krijon automatikisht të drejtë për ndarje të energjisë ndërmjet pikave të ndryshme matëse. 3. Ndarja e energjisë lejohet vetëm brenda perimetrit teknik të validuar sipas kërkesave për kyçje, matje, shkëmbim të të dhënave, faturim, tarifa, humbje dhe siguri të rrjetit. 4. ZRRE miraton specifikim teknik për përcaktimin dhe validimin e perimetrit teknik.”

Tekst i propozuar nga GEK.

Neni 24 - Aktivizimi tarifar

“Para aktivizimit të përgjithshëm të ndarjes së energjisë ndërmjet pikave të ndryshme matëse, ZRRE miraton metodologji ose vendim tarifar që përcakton trajtimin e energjisë së ndarë sipas përdorimit real të rrjetit, nivelit të tensionit, humbjeve, kapacitetit dhe kostove të shmangura ose të shkaktuara.”

Tekst i propozuar nga GEK.

Neni 27 - Ndarja dinamike dhe hibride

“Modeli dinamik ose hibrid aktivizohet vetëm pasi operatori përkatës i rrjetit dhe furnizuesit e përfshirë të kenë verifikuar funksionalitetin e matjes intervalore, validimit të të dhënave, shkëmbimit të tyre, alokimit dhe pasqyrimit në faturim. ZRRE miraton specifikim teknik për intervalin e ndarjes, energjinë e paalokuar, ruajtjen,

humbjet, korrigjimet dhe ndryshimet e pjesëmarrësve.”

Tekst i propozuar nga GEK.

Neni 39 - Përfshirja sociale

“BEBR-ja që përdor pronë komunale, grant publik, garanci publike, financim koncesional publik ose mbështetje të dedikuara miraton Plan për Përfshirje Sociale dhe Ndarje të Përfitimeve. Plan përcakton kriteret e pjesëmarrjes, opsionet e përballueshme të hyrjes, mekanizmat e solidaritetit, masat e eficiencës energjetike dhe procedurën e ankesës.”

Tekst i propozuar nga GEK.

Neni 56 - Tranzicioni

“Hyrja në fuqi e kësaj Rregulle nuk nënkupton aktivizimin automatik të të gjitha modeleve të ndarjes. ZRRE publikon planin e zbatimit, specifikimin teknik, protokollin e shkëmbimit të të dhënave, trajtimin tarifor dhe kriteret për pilotet. Ndarja statike aktivizohet pas testimit të matjes, validimit, faturimit dhe ankesave. Ndarja dinamike/hibrid, agregimi dhe fleksibiliteti aktivizohen vetëm pas plotësimit të kriterëve përkatës të gatishmërisë.”

Tekst i propozuar nga GEK.

Korrigjimet redaktuese, terminologjike dhe të referencave

Elementi	Korrigjimi i kërkuar
Shtojca 1	Të referojë Nenet 9-10, jo Nenin 11, sepse formulari lidhet me autorizimin.
Shtojca 2	Të referojë Nenin 11, jo Nenin 14, sepse lidhet me regjistrin.
Shtojcat 4-5	Të referojnë nenet relevante për ndarje dhe alokim (25-28), jo vetëm nenet për agregim ose balancim.
Shtojca 4	Të përfshijë opsionin hibrid, në përputhje me Nenin 27.
Shtojcat me të dhëna të anëtarëve	Të përcaktohet shprehimisht se listat e pikave matëse, adresave, furnizuesve dhe koeficientëve ruhen në regjistër operacional të kufizuar, jo në pjesën publike.
Terminologjia	Të përdoret në mënyrë konsistente “BEBR”; të korrigjohen referencat e gabuara “BERB”.
Organizatat e komunitetit	Të harmonizohet Neni 2, Neni 5 dhe Shtojca 2 me kategoritë e anëtarësisë të lejuara nga ligji dhe rolin e mundshëm të partnerit mbështetës.

PËRFUNDIM

Rruga e Kosovës drejt BEBR-ve nuk ka nevojë të zgjedhë midis dy ekstremeve: një mekanizëm shumë të ngushtë që nuk jep vlerë sociale ose një premtim të gjerë për kreditim virtual që nuk ka ende bazë të mjaftueshme teknike dhe tarifore. Modeli i dy niveleve i propozuar krijon një rrugë të tretë: qeverisje e fortë lokale, asetet dhe përfitimet komunitare mund të organizohen në shkallë më të gjerë; ndërsa alokimi i energjisë fillon vetëm aty ku matja, tarifa, faturimi dhe siguria e rrjetit e lejojnë.

Kjo qasje nuk e ngadalëson tranzicionin. Ajo e bën atë më të besueshëm. Ajo u jep qytetarëve shpjegim të qartë për faturën; operatorëve rregulla të zbatueshme; komunave rol të ligjshëm; familjeve në nevojë mekanizëm real për hyrje; dhe ZRRE-së një rrugë për të mësuar nga pilotet para se të aktivizojë funksione më të ndërlikuara.



VENDIMI QË KËRKOHET

Miratoni një kornizë BEBR që ruan ambicien e Draft-Rregullës, por e lidh çdo funksion të avancuar me prova të gatishmërisë, instrument të saktë zbatimi dhe mbrojtje të qartë të konsumatorit.

SHTOJCAT

BURIMET

Shtojca 1. Regjistri i burimeve dhe statusi juridik

Kodi	Burimi	Statusi dhe përdorimi
S1	ZRRE. Draft-Rregulla për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë, version për konsultim publik, 2026.	Draft rregullativ - jo i detyrueshëm.
S2	Republika e Kosovës. Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Gazeta Zyrtare Nr. 7/2024, veçanërisht nenet 32-36.	Ligj primar, i detyrueshëm.
S3	ZRRE. Rregulla Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë.	Rregull dytësor, i detyrueshëm.
S4	ZRRE. Rregulla Nr. 03/2023 për Vetë-Konsumatorët me Burime të Ripërtërishme.	Rregull dytësor, i detyrueshëm.
S5	ZRRE. Rregulla Nr. 01/2024 për Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzim të Sistemit të Shpërndarjes dhe Taksave për Kyçe.	Rregull dytësor, i detyrueshëm.
S6	Energy Community Secretariat. Policy Guidelines on Energy Communities, 12 mars 2024.	Udhëzim politik dhe interpretues; jo burim i drejtpërdrejtë i së drejtës së Kosovës.
S7	ECRB. Active Customers, qershor 2026.	Raport krahasues rregullativ; burim faktik/krahasues.
S8	ECRB. Update on the Developments of Regulatory Framework on RES and Flexibility, 2025.	Raport krahasues rregullativ; burim faktik/krahasues.
S9	Republika e Kosovës. Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gazeta Zyrtare Nr. 6/2019.	Ligj primar, i detyrueshëm.
S10	Qeveria e Kosovës. Projektligji për Energjinë Elektrike, 2026.	Draft - përdoret vetëm për përputhshmëri e ardhshme.
S11	ZRRE. Rregullat e Tregut, PO-MO-001, versioni në fuqi i publikuar nga ZRRE.	Rregulla tregu; e zbatueshme për palët që marrin pjesë në treg.

METODOLOGJIA

Shtojca 2. Metodologjia dhe kufizimet e evidencës

Ky raport bazohet në leximin e Draft-Rregullës, Ligjit Nr. 08/L-258, rregullave të publikuara të ZRRE-së dhe dokumenteve të Komunitetit të Energjisë. Analiza juridike dallon ligjin detyrues nga rregullat dytësore, udhëzimet, praktikrat krahasuese dhe propozimet e GEK-së. Kur kapaciteti teknik, tarifor ose digjital i operatorëve nuk është demonstruar publikisht në nivelin e kërkuar për një funksion, raporti nuk e supozon atë si fakt.

Kufizimi kryesor është se disa informacione operative - si arkitektura e plotë e faturimit të secilit furnizues, specifikat e platformave të të dhënave, konfigurimet e çdo transformatori ose gatishmëria e saktë e çdo njehsori - kërkojnë verifikim institucional para aktivizimit. Ky është pikërisht arsyetimi për modelin e pilotit dhe Etapa e gatishmërisë e gatishmërisë.

FJALORI

Shtojca 3. Fjalori i termave

Termi	Përkufizimi praktik
BEBR	Bashkësi e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme: subjekt juridik komunitar me kontroll lokal dhe përfitim më të gjerë se fitimi financiar.
Perimetri teknik i ndarjes së energjisë	Grup i validuar i pikave matëse dhe aseteve për të cilin mund të realizohet ndarja sipas kushteve teknike, të dhënave, tarifave dhe faturimit.
Alokim	Caktim kontabël i energjisë së pranueshme për anëtarët, bazuar në të dhëna zyrtare dhe rregulla të miratuara.
Barazim	Procesi me të cilin të dhënat e matjes dhe alokimit përdoren për faturim, treg dhe balancim.
Tepriçë	Energji e prodhuar që mbetet pas alokimit të pranueshëm dhe trajtimit të miratuar të ruajtjes.
PPB	Palë Përgjegjëse për Balancim; palë që mban përgjegjësitë e përcaktuara nga rregullat e tregut për një grup balance.
Afërsi	Lidhje lokale e anëtarëve me projektin për kontroll efektiv dhe përfitim komunitar; jo sinonim automatik i perimetrit teknik.
Ndarja e energjisë	Alokim i energjisë së prodhuar nga asetet e BEBR-së ndërmjet anëtarëve sipas rregullave të miratuara, të dhënave të matjes dhe pasqyrit në faturim; nuk nënkupton transport fizik të energjisë së emërtuar.
Perimetri teknik i ndarjes së energjisë	Grup i përcaktuar i aseteve të BRE-së dhe pikave matëse, për të cilin operatori përkatës i rrjetit ka verifikuar realizueshmërinë e ndarjes së energjisë për matje, të dhëna, faturim, trajtim tarifor dhe siguri të rrjetit.
Kriter i gatishmërisë për aktivizim	Kusht teknik, tarifor, institucional ose operacional që duhet të përmbushet dhe dokumentohet para aktivizimit të një funksioni të ri të BEBR-së.
Të dhëna intervalore	Të dhëna të matjes të regjistruara në intervale kohore të përcaktuara, të përdorshme për alokim dinamik, barazim dhe faturim.

Termi	Përkufizimi praktik
Kufizimi i prodhimit	Reduktim i prodhimit të energjisë nga operatori i sistemit për arsye të sigurisë ose kufizimeve të rrjetit.
Balancim	Përgjegjësi dhe mekanizma për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet prodhimit dhe konsumit në sistem.
Barazim	Procesi i llogaritjes dhe rakordimit të sasive të matura e të alokuara për qëllime faturimi, llogarish tregtare dhe përgjegjësie për jo-balancë.

MJET OPERACIONAL

Shtojca 4. Lista e kontrollit për verifikimin e perimetrit teknik të ndarjes së energjisë

Kontrolli	Dëshmia minimale
Aset i identifikuar	Aset BRE i zotëruar ose i kontrolluar ligjërisht nga BEBR.
Statusi i projektit	Autorizim, leje dhe kyçe kur kërkohen nga legjislacioni.
Njehsorë të kualifikuar	Matje prodhimi dhe konsumi e përshtatshme për modelin e ndarjes.
Të dhëna dhe validim	Burim zyrtar, afat validimi, trajtim i të dhënave që mungojnë dhe korrigjime.
Analizë e rrjetit	Vlerësim i ngarkesës, tensionit, rrjedha e kundërt e fuqisë (reverse power flow), kufizimit dhe sigurisë.
Tarifim	Trajtim i miratuar për përdorimin e rrjetit dhe komponentët e faturës.
Furnizues dhe faturim	Test i shkëmbimit të të dhënave dhe faturës së anëtarit.
Marrëveshja e alokimit	Koeficientë, datë efektive, ndryshime, dalje dhe ankesa.
Teprica	Palë kontraktuese dhe rrugë e qartë e balancimit.
Mbrojtja e konsumatorit	Fletë informuese, njoftim privatësie dhe procedurë ankese.

MJET OPERACIONAL

Shtojca 5. Modeli i Planit për Përfshirje Sociale dhe Ndarje të Përfitimeve

Plani duhet të përdoret nga BEBR-të që përdorin asete, fonde ose garanci publike. Ai nuk krijon një regjim të ri të mirëqenies sociale; ai shpjegon se si projekti ul barrierat e hyrjes dhe si përfitimet komunitare përdoren në mënyrë të dokumentuar.

Komponenti	Përmbajtja minimale
Qëllimi	Familjet ose grupet që synohen; lidhja me aset publik ose mbështetje publike.
Kriteret	Kriteret objektive, jodiskriminuese dhe mënyra e verifikimit të ligjshëm.

Komponenti	Përmbajtja minimale
Hyrja	Aksione të sponsorizuara, pagesa me këste, grant zhvillimor, përjashtim nga barrierat e panevojshme.
Përfitimi	Masa e eficiencës energjetike, mbështetje e fondit solidar, trajnim ose pjesë e përcaktuar e përfitimit komunitar.
Privatësia	Mbledhje minimale e të dhënave; asnjë ruajtje e panevojshme e të dhënave sociale.
Raportimi	Raport vjetor i agreguar; ankesa dhe rishikim periodik.

ZBATIM

Shtojca 6. Koncepti i Pilotit Demonstrues në Obiliq

Qëllimi. Të testohet zinxhiri i plotë - qeverisja, asetet, perimetri teknik i ndarjes së energjisë, të dhënat, faturimi, teprica, përfshirja sociale dhe monitorimi - para zgjerimit të funksioneve të ndarjes.

Komponenti	Dizajni i rekomanduar
Subjekti	Një BEBR juridike e Tranzicionit të Drejtë në Obiliq.
Aseti i parë	Kulm publik, komunitar ose aset tjetër me të drejtë të qartë përdorimi; kapaciteti përcaktohet pas studimit teknik.
Perimetri i parë teknik i ndarjes së energjisë	Pjesëmarrës pranë asetit, me njehsorë dhe faturim të kualifikuar.
Ndarja	Model statik, koeficientë të regjistruar dhe pa efekt retroaktiv.
Teprica	Marrëveshje me palë të emëruar dhe rrugë e qartë balancimi.
Përfshirja	Aksione solidare, masa EE, konsultim lokal dhe plan i përfitimit komunitar.
Vlerësimi	Matje, fatura, ankesa, kufizime, efekt social dhe plan zgjerimi vetëm pas rezultateve.

POZICIONI FORMAL


Shtojca 7. Matrica e plotë e ndryshimeve prioritare

Matrica e plotë duhet të përdoret së bashku me Kapitujt 7-28. Ajo ofron format të shpejtë për ZRRE, por nuk e zëvendëson arsyetimin në trupin e raportit.

Nenet	Vlerësimi	Ndryshimi thelbësor	Instrumenti
1-2	Mbështetje me sqarim	Të harmonizohen përkufizimet dhe kufiri mes autorizimit/regjistrimit/licencimit.	Rregulla.
3-7	Mbështetje me sqarim	Të shtohen masa për kontroll efektiv, vendime të rezervuara dhe palë të lidhura.	Rregulla + statut model.

Nenet	Vlerësimi	Ndryshimi thelbësor	Instrumenti
8	Mbështetje me sqarim	Të ruhet mos-trajtimi automatik si furnizues, por të lidhet me aktivitetet e tregut kur kryhen.	Rregulla + rregulla licencimi/tregu.
9-10	Ndryshim	Të ndahen formimi juridik, regjistri dhe autorizimi për projektin.	Rregulla.
11	Ndryshim	Regjistër publik kundrejt regjistrit operacional të kufizuar.	Rregulla + protokoll të dhënash.
12-13	Ndryshim	Afërsi për kontroll; perimetër teknik për ndarje.	Rregulla + specifikim teknik.
14-15	Ndryshim i synuar	Kategori të ndryshme për ndryshime teknike, operationale dhe administrative.	Rregulla + procedurë OSSH.
16-20	Mbështetje me sqarim	Alternativa të arsyetuara për kyçje dhe evidencë për kufizime.	Rregulla + procedurë OSSH.
21-23	Ndryshim i synuar	Kualifikim i njehsorëve sipas modelit; kufizimet të integrohen në barazim.	Rregulla + specifikim teknik.
24	Mbështetje me instrument të veçantë	Mosngarkim i dyfishtë; metodologji para shkallëzimit.	Vendim/metodologji tarife.
25-28	Ndryshim i synuar	Burim zyrtar, sistem i verifikuar për llogaritjen e alokimit, faturë model, korrigjime dhe ndryshim furnizuesi.	Specifikim teknik + protokoll faturimi.
29	Mbështetje me sqarim	Të ndahen incidentet teknike, të barazimit, të tregut dhe të të dhënave.	Protokolle sektoriale.
30-32	Aktivizim fazor	Agregimi/teprica të lidhen me kontrata, PPB dhe rregullat e tregut.	Rregulla tregu + protokoll teprice.
33-38	Mbështetje me sqarim	Të drejtat e tregut vetëm kur kushtet ekzistojnë; faturat korrigjuese dhe mosdiskriminimi.	Rregulla + protokoll faturimi.
39-41	Ndryshim	Plan social kur ka burim publik; privatësi dhe mekanizëm ankese.	Rregulla + plan model.
42-43	Mbështetje me sqarim	Raportim proporcional dhe raport publik i ZRRE-së.	Rregulla.
44-50	Ndryshim i synuar	Baza ligjore e të dhënave, rolet, shkallëzimi kibernetik dhe rrugët e incidenteve.	Rregulla + protokoll të dhënash.
51	Mbështetje me sqarim	Pilotet me vendim formal, kufi kohor, mbrojtje dhe vlerësim.	Rregulla + vendim pilot.
52	Ndryshim i synuar	Procedurë e brendshme ankesash dhe përshkallëzim i ankesës.	Rregulla + statut.

Nenet	Vlerësimi	Ndryshimi thelbësor	Instrumenti
53-56	Ndryshim	Plan harmonizimi, kriteret e gatishmërisë për aktivizim dhe rishikim pas ndryshimeve ligjore.	Rregulla + plan zbatimi.
Shtojcat	Ndryshim	Korrigjime reference, hyrje/dalje, model hibrid dhe trajtim i sigurt i të dhënave.	Rregulla / shtojca.



www.greenenergykosova.org



info@greenenergykosova.org



Prishtinë, Republika e Kosovës

ANALIZË E DRAFT-RREGULLËS për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë (version për diskutim publik)

Paqartësi, boshllëqe dhe kontradikta të mundshme

1. Kufiri numerik i anëtarëve minimal — mungesë justifikimi dhe fleksibiliteti

Neni 5, pika 2, kërkon së paku dhjetë (10) anëtarë/aksionarë, pa përjashtim. Kjo mund të përjashtojë bashkësi të vogla rurale, për shembull 5–6 familje në një fshat të izoluar, të cilat përndryshe do të mund të përmbushnin frymën dhe qëllimin e ligjit. RED II dhe RED III nuk përcaktojnë një prag numerik minimal;

Në frymën e nenit 39, pikat 2 dhe 6, si dhe të nenit 40, që synojnë promovimin e një tranzicioni energjetik të drejtë, rekomandohet të shqyrtohet mundësia e një **masë afirmative** për përjashtim nga ky kufizim për konsumatorët e cenueshëm, veçanërisht për komunitetet rurale me pak familje. Si mundësi tjetër, mund të shqyrtohet ulja e pragut minimal të anëtarësisë për BEBR-të me kapacitet të vogël, nën një prag të caktuar, për shembull nën 50 kW.

2. Mbi pjesëmarrjen e BEBR-ve në ankande: mungesë e qartësisë ligjore brenda rregullores

Sipas Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme, neni 34, pika 1.3, BEBR-të mund të marrin pjesë në të gjitha **tregjet relevante të energjisë**: “...të kenë qasje në të gjitha tregjet relevante të energjisë, drejtpërdrejt ose përmes grumbullimit në mënyrë jodiskriminuese në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike.”

Deri në një masë, ngjashëm parashihet edhe në draft-rregull. Neni 32, pika 1.2, përcakton se BEBR-të mund ta shesin energjinë e tepërt në treg: “... të shitet në tregun e energjisë elektrike drejtpërdrejt nga BEBR, përmes një agregatori ose një pjesëmarrësi tjetër të autorizuar në tregun e energjisë elektrike.”

Megjithatë, nuk është e qartë nëse BEBR-të mund të marrin pjesë edhe në ankandet e energjisë.

Kërkohet nga ZRRE-ja një sqarim eksplicit nëse BEBR-të mund të:

- a. marrin pjesë në të gjitha “tregjet relevant” (shif ligjin) dhe
- b. aplikojnë/ofertojnë drejtpërdrejt në ankande, qoftë në ankandet (të bursës apo të skemave mbështetëse), apo nëse këtë mund ta bëjnë vetëm përmes një pjesëmarrësi tjetër të licencuar.

Megjithatë, nuk është e qartë nëse BEBR-të mund të marrin pjesë edhe në ankandet e energjisë. Rrjedhimisht, **kërkohet** nga ZRRE një sqarim eksplicit nëse BEBR mund të

aplikojë/ofertojë drejtpërdrejt në ankande (të bursës apo të skemave mbështetëse), apo vetëm përmes një pjesëmarrësi tjetër të licencuar."

2. Kriteri i afërsisë (Neni 13) — potencial konflikti me Nenin 12

Neni 12, pika 4, thotë shprehimisht se organizimi multi-lokacional *"nuk kufizohet nga kufijtë administrativë komunalë"*, ndërsa neni 13, pika 1, e lidh kriterin e afërsisë pikërisht me *"komunën"* ku ndodhet projekti ose me *"komunat kufitare"*. Kjo krijon një tension logjik: si mund të funksionojë një BEBR multi-lokacionale përtej kufijve komunalë, siç parashihet në nenin 12, nëse dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të lidhur territorialisht me komunën specifike të projektit, sipas nenit 13?

Vetë neni 13, pika 3, e pranon këtë tension, duke përcaktuar se afërsia *"nuk përcaktohet ekskluzivisht"* nga distanca gjeografike, por pa e zgjidhur plotësisht paqartësinë praktike për projektet me shumë lokacione në komuna të ndryshme, të cilat jo domosdoshmërisht janë kufitare me njëra-tjetrën.

3. Afati prej 6 orësh për raportim incidentesh kritike kibernetike (Neni 47, pika 4)

Ky afat është ambicioz dhe i barabartë me standardet më strikte të BE-së (NIS2 kërkon njoftim paraprak brenda 24 orësh, jo 6). Për BEBR mikro/të vogla pa kapacitet të dedikuar IT-je (siç thekson vetë Neni 46, pika 8), një afat prej 6 orësh mund të jetë praktikisht i pazbatueshëm pa mbështetje shtesë teknike nga ZRRE ose operatorët. Ekziston kontradiktë e brendshme mes parimit të proporcionalitetit (i përsëritur disa herë, p.sh. Neni 46, pika 8, Neni 49, pika 6) dhe këtij afati rigid universal.

Rekomandime Konkrete për Konsultimin Publik

Neni	Çështja	Propozimi konkret
Neni 5, pika 2	Minimum 10 anëtarë pa përjashtim	Rekomandohet një masë afirmative për përjashtim për komunitete rurale me pak familje, ose ulni pragun për BEBR me kapacitet nën një prag të caktuar (p.sh. <50kW)
Neni 32, pika 1.2, (Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të	Mungesë e qartësisë ligjore brenda rregullores mbi pjesëmarrjen e BEBR-ve në ankande	Sqaroni në mënyrë eksplicite nëse BEBR-të mund të: a. marrin pjesë në të gjitha "tregjet relevante" (shif ligjin) dhe b. aplikojnë/ofertojnë drejtpërdrejt në ankande, qoftë në ankandet (të bursës apo të skemave mbështetëse), apo nëse këtë mund ta bëjnë

Neni	Çështja	Propozimi konkret
Ripërtërishme, neni 34, pika 1.3)		vetëm përmes një pjesëmarrësi tjetër të licencuar.
Nenet 12 & 13;	Tension logjik mes strukturës multi-lokacionale dhe kriterit komunal të afërsisë	Sqaroni shprehimisht si zbatohet kriteri i afërsisë kur BEBR ka objekte në disa komuna jo-kufitare mes tyre; konsideroni kriter bazuar në zonën e operatorit të shpërndarjes në vend të kufijve komunalë
Neni 27, pika 2	Mungon formula për modelin dinamik	Shtoni një shtojcë teknike (ose referoni një Kod Matje/Manual ZRRE) me algoritmin standard të ndarjes proporcionale për rastet e tepricës/mungesës
Neni 47, pika 4	Afat 6-orësh universal për incidente kritike	Diferenconi afatin sipas madhësisë së BEBR ose përafrojeni me afatet e NIS2 (24 orë njoftim paraprak, 72 orë raport i plotë)
Neni 37 & 26	Mungon mekanizëm kompensimi i menjëhershëm për konsumatorin kur gabimi vjen nga operatori	Shtoni afat maksimal korrigjimi (p.sh. brenda ciklit të ardhshëm të faturimit) dhe përgjegjësi qartë të operatorit ndaj konsumatorit final
Neni 55	Kompetencë e pakufizuar interpretuese e Bordit	Kërkoni publikim të detyrueshëm të çdo 'informate shpjeguese' në faqen e ZRRE-së brenda X ditësh nga nxjerrja
Neni 47	Emërtimi 'Agjencia për Informim dhe Privatësi'	Verifikoni dhe përditësoni me emërtimin zyrtar aktual të autoritetit kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale
Neni 56, pika 1	Afat 6-mujor për gatishmëri operatorësh	Kërkoni një vlerësim paraprak publik të gatishmërisë aktuale infrastrukture (smart metering) të OSSh/OST për të konfirmuar realizueshmërinë e afatit
Neni 24, pika 4	Parimi anti-dyfishim tarifor pa formulë	Specifikoni metodologjinë e saktë të zbritjes/kompensimit në tarifat OSSh/OST për energjinë e ndarë brenda BEBR
Neni 14, pika 1 (Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 17, pika 8)	Sipas ligjit, shoqëritë tregtare janë të obliguara të paraqesin në ARBK çdo ndryshim të të dhënave të regjistruara brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Ndërkohë, draft-rregulla për BEBR, neni	Meqë BEBR-të regjistrohen, ndër të tjera, edhe si shoqëri tregtare, për harmonizim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare rekomandohet që ky afat të shkurtohet në pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Neni	Çështja	Propozimi konkret
	14, pika 1, parasheh një afat prej tridhjetë (30) ditësh.	

7 Arte

Të nderuar,

Uroj të jeni mirë me shëndet e punë. Duke qene pjese e projektit të **EECSOK**, menaxhuar nga CDF , dhe provusr per te sjellur praktika nga rrjete te ndryshme evropiane, po ndajme me ju disa nga rekomandimet qe i ofron organizata 7 Arte

- Njohja e komuniteteve kulturore si Bashkësi të Energjisë

Të mundësohet që poashtu organizatat kulturore, qendrat kreative, muzetë dhe institucionet e trashëgimisë të krijojnë ose t'i bashkohen Bashkësive të Energjisë.

- Projekte pilot në zona post-industriale

Rregullorja të inkurajojë pilot-projekte në ish-zonat industriale, si Trepça apo lagje urbane siç është Tuneli i Parë në Mitrovicë, duke i kthyer ato në laboratorë të tranzicionit të gjelbër.

- Mbështetje për Positive Energy Districts

Të përfshihet mundësia që Bashkësitë e Energjisë të zhvillohen në nivel lagjeje ose distrikti, jo vetëm në nivel të një objekti.

Kjo lidhet drejtpërdrejt me vizionin tonë si 7Arte ku synojmë të testojmë një zonë postindustriale me moton "From Battery Factory to Battery District.", ku edhe kemi marrë hapësira me qera për të testuar një pilot projekt të tillë.

- Përfshirja e komunave dhe OJQ-ve

Të lehtësohet partneriteti ndërmjet komunave, universiteteve, OJQ-ve dhe bizneseve në krijimin e Bashkësive të Energjisë.

- Dimensioni social

Një pjesë e përfitimeve financiare të dedikohet për projekte komunitare:

edukim;

hapësira publike;

Eco-art e kulturë;

luftim të varfërisë energjetike.

- Monitorim transparent

Çdo komunitet të ketë një "Energy Dashboard" publik që tregon:

prodhimin;

konsumin;

reduktimin e CO₂;

kursimet financiare.

- Mbështetje për ndërtesat me vlerë kulturore

Të krijohen mekanizma të veçantë për instalimin e teknologjive të gjelbra në ndërtesa historike pa cenuar vlerat e trashëgimisë të mbrojtura me ligj.

- Program kombëtar për Living Labs

Bashkësitë e Energjisë të lidhen me Living Labs ku qytetarët testojnë teknologji të reja, modele biznesi dhe forma të reja të pjesëmarrjes.

- Edukimi dhe inovacioni

Të kërkohet që Bashkësitë e Energjisë të realizojnë aktivitete edukative për shkolla, universitete dhe komunitetin.

- Mbështetje për ekonominë kreative

Të inkurajohen investimet në energji të pastër për hapësira kreative, maker spaces, studio të artistëve dhe inkubatorë të industrive kreative.

Komuna e Drenasit

Pershendetje!

Nese me lejohet , ne cilesin e ekspertit te enrgjise, desha te jap nje koment lidhuer me Draft Rregullen per BEBR-ve.

Ne nenin 5 , paragrafi 2. Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) ka një anëtarësi prej së paku dhjetë (10) anëtarëve ose aksionarëve dhe 4. **Pjesëmarrja në çdo Bashkësi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme është vullnetare dhe e hapur. Çdo person apo subjekt i listuar në paragrafin 1 të këtij neni ka të drejtë t’i bashkohet Bashkësisë për Energji të Ripërtërishme ose të largohet prej saj. Ndaj tyre nuk mund tu aplikohen procedura diskriminuese që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në një Bashkësi për Energji të Ripërtërishme ose largimin prej saj.**

Pytja per sqarim:

A duhet parapar ne kete rregull nje paragraf, ku spjeron se “ qfar ndodhë, nese nje antetar lagohet dhe nuk behet plotesimi me nje anëtar tjeter, a do te funksjono BEBR-se “ apo duhet te largohet nga registri I BEBR., pasi rregulla po thekson qe BEBR-ve duhet te jes sepaku 10 anetar.



Rregulla për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë



Përmbajtja

KREU 1.....	8
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	8
Neni 1	8
Qëllimi dhe Fushëveprimi	8
Neni 2	8
Përkufizimet	8
KREU 2	10
STATUSI JURIDIK DHE QEVERISJA	10
Neni 3	10
Forma Juridike dhe Qëllimi	10
Neni 4	11
Qeverisja dhe Vendimmarrja e BEBR-së	11
Neni 5	11
Anëtarët ose aksionarët e BEBR.....	11
Neni 6	12
Autonomia Organizative dhe Delegimi i Funksioneve	12
Neni 7	12
Konflikti i Interesit dhe Integriteti i Qeverisjes.....	12
Neni 8	12
Përputhshmëria me Tregun e Energjisë Elektrike dhe Sigurinë e Rrjetit	12
KREU 3	13
AUTORIZIMI PËR NDËRTIM DHE REGJISTRIMI I BEBR-së	13
Neni 9	13
Autorizimi për Ndërtim dhe Regjistrimi	13
Neni 10	13
Kriteret dhe Dokumentacioni për Aplikim për Autorizimin për Ndërtim të BEBR-ve	13
Neni 11	14
Regjistri i BEBR-ve	14
Neni 12	15
BEBR me Strukturë Multi-lokacionale	15
Neni 13	15
Kriteri i Afërsisë	15
Neni 14	16
Ndryshimet në Statusin dhe Anëtarësinë e BEBR-së	16



Neni 15.....	16
Vlefshmëria, Modifikimi dhe Përfundimi i Autorizimit për Ndërtim.....	16
KREU 4.....	17
KYÇJA NË RRJET DHE KËRKESAT TEKNIKE	17
Neni 16.....	17
Parimet e Kyçjes në Rrjet.....	17
Neni 17.....	17
Kërkesat Teknike për Kyçe	17
Neni 18.....	18
Aplikimi për Kyçe në Rrjet	18
Neni 19.....	18
Taksat e Kyçjes.....	18
Neni 20.....	19
Standardet Teknike dhe Siguria.....	19
Neni 21.....	19
Matja dhe Sistemet Matëse	19
Neni 22.....	20
Ndryshimet Teknike.....	20
KREU 5.....	20
MASAT E SIGURISË DHE EMERGJENCAT E RRJETIT	20
Neni 23.....	20
Procedurat për Situata Emergjente.....	20
KREU 6.....	21
TARIFAT, MATJA, NDARJA DHE FATURIMI I ENERGJISË	21
Neni 24.....	21
Tarifat dhe Taksat	21
Neni 25.....	21
Shkëmbimi dhe Qasja në të Dhëna	21
Neni 26.....	22
E Drejta për Ndarje të Energjisë	22
Neni 27.....	23
Modelet e Ndarjes së Energjisë	23
Neni 28.....	23
Faturimi	23



Neni 29.....	24
Raportimi i Incidenteve Operative	24
Neni 30.....	24
Integrimi me Agregatorët dhe Skemat e Fleksibilitetit	24
KREU 7.....	25
BALANCIMI DHE MENAXHIMI I TEPRICAVE.....	25
Neni 31.....	25
Përgjegjësia për Balancim	25
Neni 32.....	25
Menaxhimi i Tepricave	25
KREU 8.....	25
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE	25
Neni 33.....	25
Të Drejtat e BEBR.....	25
Neni 34.....	27
Detyrimet e BEBR	27
Neni 35.....	27
Të Drejtat e Operatorëve.....	27
Neni 36.....	28
Detyrimet e Operatorëve	28
Neni 37.....	29
Të Drejtat e Furnizuesit përkatës	29
Neni 38.....	30
Detyrimet e Furnizuesit përkatës.....	30
KREU 9.....	30
MBROJTJA SOCIALE, GJINORE DHE MJEDISORE.....	30
Neni 39.....	30
Konsumatorët e Cenueshëm (në nevojë)	30
Neni 40.....	31
Përgjegjësitë Sociale dhe Gjinore të BEBR	31
Neni 41.....	31
Edukimi, Ndërgjegjësimi dhe Pjesëmarrja Gjinore	31
KREU 10.....	32
MONITORIMI DHE RAPORTIMI	32



Neni 42.....	32
Procedurat e Monitorimit	32
Neni 43.....	32
Raportimi	32
KREU 11.....	33
MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE SIGURIA KIBERNETIKE	33
Neni 44.....	33
Klasifikimi dhe Menaxhimi i të Dhënave	33
Neni 45.....	34
Mbrotja dhe Përpunimi i të Dhënave Personale	34
Neni 46.....	34
Siguria Kibernetike	34
Neni 47.....	36
Menaxhimi dhe Raportimi i Incidenteve Kibernetike	36
KREU 12.....	37
INTEGRIMI I SISTEMEVE DIGJITALE	37
Neni 48.....	37
Shkëmbimi i të Dhënave dhe Rrjedha e Informacionit	37
Neni 49.....	38
Standardet Teknike dhe Certifikimi	38
Neni 50.....	38
Qeverisja e të Dhënave dhe Përgjegjësitë.....	38
KREU 13.....	39
MBËSHTETJA E INOVACIONIT	39
Neni 51.....	39
Mbështetja për Teknologjitë Inovative	39
KREU 14.....	40
ANKESAT DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE.....	40
Neni 52.....	40
Ankesat dhe Zgjidhja e Kontesteve	40
KREU 15.....	41
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	41
Neni 53.....	41
Marrëdhënia e Rregullës me Aktet e Tjera Rregullative	41
Neni 54.....	41



Ndryshimet/Plotësimet.....	41
Neni 55.....	41
Interpretimi	41
Neni 56.....	41
Dispozitat Kalimtare	41
Neni 57.....	41
Hyrja në Fuqi	41
Neni 58.....	42
Shtojcat	42
SHTOJCA 1	43
FORMULARI PËR APLIKIM PËR AUTORIZIM PËR NDËRTIM TË BASHKËSISË SË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR).....	43
SHTOJCA 2	46
FORMULARI PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E BASHKËSIVE TË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR).....	46
SHTOJCA 3	49
FORMULARI PËR APLIKIM PËR KYÇJE NË RRJET TË BASHKËSISË SË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR).....	49
SHTOJCA 4	52
LISTA E PIKAVE MATËSE DHE ANËTARËVE PJESËMARRËS NË NDARJEN E ENERGJISË	52
SHTOJCA 5	54
DEKLARIMI I FAKTORËVE TË NDARJES SË ENERGJISË	54
SHTOJCA 6	56
NJOFTIM PËR NDRYSHIME NË BASHKËSINË E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR) .	56



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë dhe në pajtim me Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenin 25, Neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 13 dhe 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081, Nenin 2 të Ligjit Nr. 08/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-081 të Energjisë dhe Nenit 33 paragrafi 4, Nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtrishme të energjisë Nr.08/L-258 , në seancën e mbajtur më XXXXXX, miratoi:

Rregulla për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Kosovë



KREU 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Kjo Rregull përcakton kushtet dhe procedurat për themelimin, autorizimin dhe funksionimin e BEBR-ve, me synim promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme, integrimin e tyre në tregun e energjisë si dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, ndërmarrjeve dhe autoriteteve lokale në prodhimin, vetë-konsumin, ruajtjen dhe ndarjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme, me qëllim krijimin e përfitimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale për anëtarët ose aksionarët dhe komunitetin lokal.
2. Kjo Rregull përcakton organizimin, funksionimin, të drejtat dhe obligimet e BEBR-ve, procedurat për themelim, pjesëmarrje dhe operim, si dhe raportet ndërmjet anëtarëve, operatorëve të rrjetit, furnizuesve dhe institucioneve përgjegjëse në sektorin e energjisë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e mëposhtme janë përdorur në këtë Rregull kanë kuptimet si më poshtë:
 - 1.1. “Aplikues” - person juridik ose grup themelues që aplikon për autorizim ose regjistrim si Bashkësi e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme sipas kësaj Rregulle.
 - 1.2. “Objekt i prodhimit të BEBR-së” - instalim për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme në pronësi, bashkëpronësi ose përdorim të BEBR-së, i lidhur në rrjetin e energjisë elektrike.
 - 1.3. “ZRRE” - Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, autoriteti kompetent rregullator në sektorin e energjisë.
 - 1.4. “Autorizim” - akt administrativ i lëshuar nga ZRRE që i jep të drejtë subjektit të ndërtojë ose operojë instalime energjetike në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - 1.5. “Bashkësi e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR)” - person juridik autonom:
 - 1.5.1. i bazuar në pjesëmarrje të hapur dhe vullnetare;
 - 1.5.2. i kontrolluar efektivisht nga anëtarë ose aksionarë që ndodhen në afërsi të projekteve të energjisë nga burimet e ripërtërishme në pronësi dhe të zhvilluara nga BEBR-ja;
 - 1.5.3. anëtarët ose aksionarët e të cilit janë persona fizikë, autoritete lokale, organizata të komunitetit ose ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme; dhe
 - 1.5.4. që ka për qëllim kryesor gjenerimin e përfitimeve mjedisore, ekonomike ose sociale për anëtarët ose komunitetin lokal dhe jo maksimizimin e fitimit financiar.



- 1.6. “Anëtar i BEBR-së” - person fizik ose juridik që ushtron të drejtë vote dhe merr pjesë në kontrollin efektiv dhe procesin vendimmarrës të BEBR-së.
- 1.7. “Vetë-konsum individual” - konsumi i energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme nga konsumatori në të njëjtën pikë matjeje.
- 1.8. “Vetë-konsum kolektiv” - konsum i përbashkët i energjisë elektrike të prodhuar nga një instalim i energjisë së ripërtërishme dhe i ndarë ndërmjet më shumë konsumatorëve.
- 1.9. “Ndarje e energjisë” - shpërndarja e energjisë elektrike të prodhuar nga një BEBR ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të saj, sipas rregullave dhe modelit të ndarjes të përcaktuar nga BEBR, në përputhje me këtë Rregull.
- 1.10. “Burime të Ripërtërishme të Energjisë” - burime jo-fosile të energjisë, përfshirë energjinë diellore, të erës, hidroenergjinë, energjinë gjeotermale, energjinë ambientale, biomasën, biogazin dhe gazrat nga mbetjet.
- 1.11. “Ruajtje e energjisë” - në sistemin elektroenergjetik nënkupton shtyrjen e përdorimit përfundimtar të energjisë elektrike për një moment më të vonshëm se ajo kur është prodhuar, ose shndërrimin e energjisë elektrike në një formë energjie që mund të ruhet, ruajtjen e kësaj energjie, si dhe ri-shndërrimin e mëvonshëm të kësaj energjie në energji elektrike ose përdorimin e saj si një bartës tjetër energjie.
- 1.12. “Sistem inteligjent matës” - sistem elektronik matjeje që regjistron dhe transmeton të dhëna për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike për qëllime monitorimi dhe menaxhimi.
- 1.13. “Energjia tepricë” - nënkupton sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga instalimet gjeneruese të BEBR-së, që tejkalon konsumin e energjisë nga anëtarët e saj në të njëjtën periudhë kohore dhe që mund të ruhet, të ndahet ndërmjet anëtarëve të BEBR-së, të shitet ose të injektohet në rrjetin elektrik.
- 1.14. “Agregimi” - nënkupton një funksion të kryer nga një person fizik ose juridik, që kombinon ngarkesat e shumë konsumatorëve ose energjinë elektrike të prodhuar prej tyre për qëllime shitjeje, blerjeje ose ankandi në çdo treg të energjisë elektrike.
- 1.15. “Agregator i pavarur” - nënkupton një pjesëmarrës në treg që ushtron aktivitetin e agregimit dhe që nuk është i ndërlidhur me furnizuesin e energjisë së konsumatorit.
- 1.16. “Operator i BEBR-së” - subjekt i mandatuar nga BEBR për menaxhimin operacional, teknik ose administrativ të aktiviteteve të saj pa cenuar autonominë dhe kontrollin efektiv nga anëtarët apo aksionarët.
- 1.17. “NMVM” - ndërmarrje mikro, e vogël ose e mesme sipas legjislacionit përkatës në fuqi.



1.18. “Shërbime fleksibiliteti” - shërbime që mundësojnë përshtatjen e prodhimit, konsumit ose ruajtjes së energjisë elektrike në përgjigje të nevojave të rrjetit, kushteve të tregut ose kërkesave të operatorit të sistemit, duke kontribuar në balancimin, optimizimin dhe sigurinë e funksionimit të sistemit elektroenergjetik.

1.19. “Infrastrukturë për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike” - pajisje, sisteme dhe instalime të destinuara për furnizimin me energji elektrike të automjeteve elektrike ose hibride me mbushje (karikim) të jashtme, përfshirë pikat e mbushjes (karikimit), sistemet e menaxhimit dhe pajisjet ndihmëse të lidhura me to.

KREU 2

STATUSI JURIDIK DHE QEVERISJA

Neni 3

Forma Juridike dhe Qëllimi

1. Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) themelohet si subjekt juridik në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe statutin e tyre të themelimit.
2. Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) kanë për qëllim plotësimin e nevojave energjetike të anëtarëve ose aksionarëve të tyre, përmes prodhimit, vetë-konsumit individual ose kolektiv, ruajtjes, ndarjes dhe shitjes së energjisë nga burimet e ripërtërishme, përmirësimit të efikasitetit të energjisë, kursimit të energjisë dhe ofrimit të shërbimeve energjetike në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) mund të zhvillojë, financojë, investojë, ndërtojë, zotërojë dhe operojë projekte të energjisë nga burime të ripërtërishme të energjisë dhe efikasitetit të energjisë.
4. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) përbën një subjekt juridik autonom, i cili vepron në emër të vet dhe ushtron të drejta dhe është subjekt i detyrimeve, i pavarur nga anëtarët dhe aksionarët e vet.
5. Bashkësia për Energji nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) kontrollohet në mënyrë efektive nga aksionarët ose anëtarët e vendosur në afërsi të projekteve të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme që janë pronë e atij subjekti juridik dhe zhvillohen prej tij.
6. BEBR mund të prodhojë, konsumojë, ruajë, ndajë dhe shesë energji nga burimet e ripërtërishme, si dhe të marrë pjesë në të gjitha tregjet e energjisë elektrike, përfshirë tregjet e fleksibilitetit dhe shërbimeve ndihmëse, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.



7. BEBR mund të ofrojë shërbime për përmirësimin e efijencës së energjisë për anëtarët ose komunitetin lokal, duke përfshirë masa për optimizimin e konsumit të energjisë dhe përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimet energjetike dhe efijencën e energjisë (ESCO komunitare).

Neni 4

Qeverisja dhe Vendimmarrja e BEBR-së

1. BEBR duhet të ketë strukturë qeverisëse të qartë, demokratike dhe transparente në pajtim me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtrishme dhe statutin e tyre të themelimit
2. Vendimmarrja në BEBR bazohet në parimin demokratik 'një anëtar - një votë', pavarësisht nga kontributi financiar ose kapaciteti energjetik, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht për çështje teknike dhe kur ligji parashikon ndryshe.
3. Asnjë anëtar ose subjekt juridik nuk mund të ushtrojë kontroll dominues mbi BEBR-në, sipas parimit të kontrollit efektiv të përcaktuar në këtë Rregull.
4. Ndërmarrjet e mëdha dhe subjektet fitimprurëse nuk mund të ushtrojnë kontroll efektiv mbi BEBR-në.
5. Anëtarët ose aksionarët kanë të drejtë të bashkohen ose të largohen nga BEBR-ja në përputhje me aktet e saj themeluese, pa humbur të drejtat e tyre si konsumatorë fundorë dhe pa iu nënshtruar kufizimeve ose praktikave diskriminuese.
6. BEBR siguron transparencë, përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje efektive të anëtarëve ose aksionarëve në proceset vendimmarrëse, duke promovuar përfshirjen e komunitetit lokal, komunave, NMVM-ve dhe konsumatorëve të cenueshëm (në nevojë).

Neni 5

Anëtarët ose aksionarët e BEBR

1. Anëtarë ose aksionarë të një Bashkësie të Energji nga Burimet e Ripërtërishme mund të jenë persona fizikë, NMVM, komunat dhe konsumatorët, duke përfshirë familjet me të hyra të ulëta ose të cenueshme.
2. Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) ka një anëtarësi prej së paku dhjetë (10) anëtarëve ose aksionarëve 
3. NMVM-të mund të marrin pjesë në Bashkësinë e Energjisë së Ripërtërishme, me kusht që pjesëmarrja e tyre nuk është aktiviteti i tyre primar komercial ose profesional dhe se pjesëmarrja e tyre nuk kalon dhjetë për qind (10%) të pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve dhe aksionarëve të asaj Bashkësie për Energji të Ripërtërishme.



4. Pjesëmarrja në çdo Bashkësi për Energji nga Burimet e Ripërtërishme është vullnetare dhe e hapur. Çdo person apo subjekt i listuar në paragrafin 1 të këtij neni ka të drejtë t'i bashkohet Bashkësisë për Energji të Ripërtërishme ose të largohet prej saj. Ndaj tyre nuk mund tu aplikohen procedura diskriminuese që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në një Bashkësi për Energji të Ripërtërishme ose largimin prej saj.
5. Anëtarët ose aksionarët e BEBR-së ruajnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tyre si konsumatorë fundorë, përfshirë të drejtën për zgjedhjen dhe ndërrimin e lirë të furnizuesit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Autonomia Organizative dhe Delegimi i Funksioneve

1. BEBR mund të delegojë funksione operative, administrative, teknike ose menaxheriale tek palët e treta, me kusht që përgjegjësia ligjore dhe rregullative të mbetet te BEBR dhe që delegimi të mos cenojë kontrollin efektiv dhe vendimmarrjen e pavarur të anëtarëve ose aksionarëve të saj.
2. Në rastet kur delegohen funksione operative ose operimi i aseteve energjetike, këto funksione kryhen nga subjekte juridike të regjistruara ose të autorizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Konflikti i Interesit dhe Integriteti i Qeverisjes

1. Anëtarët e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të BEBR-së janë të detyruar të shmangin dhe deklarojnë çdo konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
2. BEBR përcakton në aktet e saj të brendshme procedurat për identifikimin, deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit.
3. Mekanizmat për identifikimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit bazohen në parimet e transparencës, paanshmërisë, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, me qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së.

Neni 8

Përputhshmëria me Tregun e Energjisë Elektrike dhe Sigurinë e Rrjetit

1. Qeverisja dhe operimi i BEBR-së nuk duhet të cenojë konkurrencën efektive në tregun e energjisë elektrike dhe sigurinë e rrjetit elektroenergjetik.
2. BEBR-të operojnë në pajtim me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe kërkesat për sigurinë e rrjetit, dhe mund të marrin pjesë në aktivitetet e tregut të energjisë elektrike, përfshirë ndarjen e energjisë, shërbimet e fleksibilitetit, ruajtjen e energjisë, agregimin dhe aktivitete të tjera të lejuara sipas legjislacionit në fuqi.



3. Aktivitetet e BEBR-së nuk konsiderohen furnizim me energji elektrike ndaj palëve të treta dhe nuk i nënshtrohen licencimit si furnizues, për aq kohë sa kufizohen në prodhimin, konsumimin, ruajtjen, ndarjen dhe menaxhimin e energjisë elektrike ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të saj, në përputhje me këtë Rregull.

KREU 3

AUTORIZIMI PËR NDËRTIM DHE REGJISTRIMI I BEBR-së

Neni 9

Autorizimi për Ndërtim dhe Regjistrimi

1. Në mënyrë që BEBR-të të ushtrojnë veprimtarinë e tyre ato janë të obliguara që të autorizohen nga ZRRE dhe të regjistrohen në Regjistrin e Bashkësive të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, në pajtim me këtë Rregull dhe dispozitat tjera të zbatueshme të Procedurës së Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë¹
2. Autorizimi për Ndërtim dhe Regjistrimi i BEBR-së janë procedura të veçanta administrative dhe nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën.
3. Autorizimi dhe regjistrimi i BEBR-së nuk përbëjnë licencim për ushtrimin e aktiviteteve të prodhimit, furnizimit ose aktiviteteve të tjera të licencuara.
4. Ndarja e energjisë elektrike ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së nuk konsiderohet furnizim me energji elektrike dhe nuk i nënshtrohet licencimit si aktivitet furnizimi.
5. Aplikimi për autorizim realizohet sipas formularit të paraqitur në Shtojcën 1 të kësaj Rregulle dhe në përputhje me procedurat e autorizimit në fuqi.
6. Aplikimi për regjistrimin e BEBR-së realizohet sipas formularit të paraqitur në Shtojcën 2 të kësaj Rregulle.

Neni 10

Kriteret dhe Dokumentacioni për Aplikim për Autorizimin për Ndërtim të BEBR-ve

1. BEBR, përveç kërkesave të përcaktuara në Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, për t'u autorizuar duhet të përmbushin edhe këto kriteret minimale:
 - 1.1. të jetë e themeluar dhe regjistruar në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. të garantojë kontroll efektiv nga anëtarët ose aksionarët;
 - 1.3. të ketë si qëllim parësor gjenerimin e përfitimeve mjedisore, ekonomike ose sociale për anëtarët ose komunitetin lokal dhe jo maksimizimin e fitimit financiar.

¹ Rregulla Nr. 03/2022 Për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese, Sistemeve të Reja të Transmisionit dhe Distribucionit të Gazit, Përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte për Energji Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte të Transmisionit të Gazit Natyror



2. BEBR-të, përveç kërkesave të përcaktuara në Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, paraqesin pranë ZRRE-së aplikimin për autorizim për ndërtim, i cili përmban së paku edhe:
 - 2.1. statutin;
 - 2.2. dëshminë e regjistrimit si subjekt juridik;
 - 2.3. përshkrimin e strukturës së qeverisjes;
 - 2.4. listën e anëtarëve ose aksionarëve,
 - 2.5. dëshminë e të drejtës pronësore dhe të drejtës së shfrytëzimit për objektet apo sipërfaqet, ku planifikohet instalimi;
 - 2.6. përshkrimin teknik të instalimeve të BRE-ve, dhe
 - 2.7. modelin e ndarjes së energjisë.
3. ZRRE shqyrton secilën kërkesë për autorizim për ndërtim ose regjistrim brenda një afati maksimal prej tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i dokumentacionit të kompletuar.

Neni 11

Regjistri i BEBR-ve

1. Çdo Bashkësi e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) regjistrohet në Regjistrin e BEBR-ve të administruar nga ZRRE para fillimit të aktivitetit të saj operativ që rregullohen me këtë Rregull.
2. Regjistri përfshin së paku të dhëna mbi:
 - 2.1. emrin dhe formën juridike të BEBR-së;
 - 2.2. adresën dhe zonën e veprimit;
 - 2.3. anëtarët ose aksionarët dhe strukturën e qeverisjes;
 - 2.4. teknologjitë dhe kapacitetet e instaluara nga burimet e ripërtërishme të energjisë;
 - 2.5. asetet e tjera energjetike në pronësi, bashkëpronësi ose përdorim të BEBR-së, përfshirë instalimet gjeneruese të energjisë së ripërtërishme, sistemet e ruajtjes së energjisë, infrastrukturën për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike dhe asetet e tjera energjetike në pronësi ose përdorim të BEBR-së;
 - 2.6. lokacionin e instalimeve energjetike, përfshirë parcelat kadastrale, kur janë të zbatueshme;
 - 2.7. modelin e ndarjes së energjisë;
 - 2.8. statusin e autorizimit, të regjistrimit dhe operimit të BEBR-së.
3. Regjistri është publik, me përjashtim të të dhënave të mbrojtura sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e informacionit tregtar.
4. ZRRE njoftohet për çdo ndryshim në të dhënat e regjistruara sipas këtij neni në përputhje me këtë Rregull.



Neni 12

BEBR me Strukturë Multi-lokacionale

1. Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) mund të zotërojë, zhvillojë, ndërtojë ose operojë një ose më shumë njësi gjeneruese të energjisë nga burimet e ripërtërishme, sisteme të ruajtjes së energjisë, infrastrukturë për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike dhe objekte të tjera të nevojshme për prodhimin, ruajtjen, menaxhimin, ndarjen dhe përdorimin e energjisë elektrike.
2. Njësitë gjeneruese, sistemet e ruajtjes së energjisë, pikat matëse dhe anëtarët ose aksionarët e BEBR-së mund të vendosen në një ose më shumë lokacione dhe mund të jenë të kyçur në nivele të ndryshme të tensionit të rrjetit elektrik, për aq kohë sa matja, ndarja, verifikimi dhe faturimi i energjisë mund të realizohen në mënyrë të sigurt, të saktë dhe të auditueshme përmes sistemeve të operatorit të rrjetit.
3. Një BEBR mund të përfshijë një ose më shumë pika kyçeje në rrjet dhe një ose më shumë objekte gjeneruese ose të ruajtjes së energjisë, të vendosura në një ose më shumë komuna, në përputhje me kriteret e afërsisë të përcaktuara me këtë Rregull.
4. Organizimi multi-lokacional nuk kufizohet nga kufijtë administrativë komunalë, për aq kohë sa plotësohen kriteret e afërsisë, sigurohet pjesëmarrja efektive e anëtarëve ose aksionarëve dhe përmbushen kërkesat teknike të operatorit të rrjetit.
5. Operatori i rrjetit nuk mund të refuzojë një konfigurim multi-lokacional vetëm për shkak të numrit të lokacioneve, nivelit të tensionit ose vendndodhjes administrative të njërive pjesëmarrëse.
6. Një konfigurim multi-lokacional mund të refuzohet vetëm në rast se operatori i rrjetit demonstroi, me arsyetim teknik të dokumentuar, objektiv dhe proporcional, se konfigurimi cenon sigurinë, stabilitetin ose funksionimin e sigurt të sistemit elektroenergjetik ose pamundëson matjen, ndarjen dhe verifikimin e energjisë sipas kërkesave të kësaj Rregulle.
7. Operatori i rrjetit siguron që kërkesat dhe procedurat për konfigurimet multi-lokacionale të jenë transparente, proporcionale, objektive, teknologjikisht neutrale dhe jodiskriminuese.

Neni 13

Kriteri i Afërsisë

1. Afërsia konsiderohet e përmbushur kur së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së kanë vendbanim, seli, pikë konsumi të energjisë elektrike, aset energjetik pjesëmarrës në BEBR, ose pronësi apo të drejtë shfrytëzimi mbi pasuri të paluajtshme në komunën ku ndodhet projekti i energjisë së ripërtërishme ose në një nga komunat kufitare me të, në momentin e aplikimit.



2. Për qëllime të verifikimit të kriterit të afërsisë, BEBR-ja paraqet pranë ZRRE-së dhe operatorit përkatës të rrjetit dokumentacionin përkatës që dëshmon përmbushjen e kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni.
3. Kriteri i afërsisë nuk përcaktohet ekskluzivisht mbi bazën e distancës gjeografike, niveli i tensionit të kyçjes, pika e kyçjes në rrjet ose konfigurimi teknik i sistemit elektroenergjetik, për aq kohë sa përmbushen kushtet e paragrafit 1 të këtij neni.
4. BEBR-ja është e obliguar që gjatë gjithë periudhës së operimit të saj të ruajë përmbushjen e kriterëve të afërsisë të përcaktuara me këtë Rregull. Çdo ndryshim që mund të ndikojë në përmbushjen e këtyre kriterëve i njoftohet ZRRE-së pa vonesë. ZRRE vlerëson nëse BEBR-ja vazhdon t'i përmbushë kriteret e afërsisë në përputhje me këtë Rregull dhe, sipas rastit, kërkon ndërmarrjen e masave për rivendosjen e përputhshmërisë.
5. Operatorët e rrjetit sigurojnë që zbatimi i kriterit të afërsisë të mos krijojë kufizime ose barriera të pajustificuara për themelimin, operimin ose zgjerimin e BEBR-ve.
6. Operatori i rrjetit ose ZRRE mund të kërkojnë verifikim shtesë në çdo kohë se a është duke u përmbushur kriteri i afërsisë, kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të dokumentuara mbi saktësinë e të dhënave të paraqitura nga BEBR.
7. Refuzimi i një kërkesë për regjistrim, kyçje ose operim të një BEBR-je nuk mund të bazohet vetëm në kriterin e afërsisë, përveç rasteve kur konstatohet se kërkesat e këtij neni nuk janë përmbushur. Çdo refuzim duhet të jetë i arsyetuar, proporcional dhe i dokumentuar.
8. Interpretimi dhe zbatimi i kriterit të afërsisë bazohet në parimet e proporcionalitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe neutralitetit.

Neni 14

Ndryshimet në Statusin dhe Anëtarësinë e BEBR-së

1. BEBR brenda 30 ditëve është e obliguar të njoftojë ZRRE-në dhe operatorin përkatës të rrjetit për çdo ndryshim që lidhet me statusin juridik, strukturën organizative ose operimin e saj, duke përfshirë rritjen ose zvogëlimin e kapacitetit të instaluar dhe shtimin ose largimin e anëtarëve ose aksionarëve të BEBR.

Neni 15

Vlefshmëria, Modifikimi dhe Përfundimi i Autorizimit për Ndërtim

1. Dispozitat e Procedurës së Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, që ndërlidhen me vlefshmërinë, modifikimin dhe përfundimin e autorizimit për ndërtim, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për BEBR-të.



KREU 4

KYÇJA NË RRJET DHE KËRKESAT TEKNIKE

Neni 16

Parimet e Kyçjes në Rrjet

1. BEBR-të kanë të drejtë të kërkojnë dhe të realizojnë kyçjen në rrjetin e shpërndarjes ose të transmetimit në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale, duke përfituar trajtim të drejtë dhe të barabartë me përdoruesit e tjerë të rrjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Kodet e Rrjetit.
2. Kërkesat teknike dhe administrative për kyçe duhet të jenë proporcionale dhe bazuara në kritere objektive me madhësinë, kapacitetin dhe ndikimin real të instalimit në sistemin elektroenergjetik.
3. Operatori i rrjetit nuk mund të refuzojë kyçjen për shkak të natyrës komunitare të BEBR-së, modelit të ndarjes së energjisë ose strukturës së anëtarësisë, për aq kohë sa përmbushen kërkesat teknike dhe të sigurisë së rrjetit.
4. Integrimi i BEBR-ve realizohet në përputhje me rregullat e tregut, kodet e rrjetit dhe parimet e mosdiskriminimit, duke promovuar integrimin e burimeve të ripërtërishme, sistemeve të ruajtjes së energjisë, shërbimeve të fleksibilitetit dhe pjesëmarrjes aktive të konsumatorëve, kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e realizueshme.
5. Çdo refuzim i kërkesës për kyçe duhet të jetë i arsyetuar, proporcional dhe i mbështetur në analiza teknike të dokumentuara, të cilat i komunikohen aplikuesit në përputhje me procedurat në fuqi.

Neni 17

Kërkesat Teknike për Kyçe

1. Instalimet gjeneruese të BEBR duhet të pajisen me sisteme mbrojtëse, kontrolli dhe shkyçjeje në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe kërkesat teknike të operatorit të rrjetit.
2. Operimi në regjim ishullor lejohet vetëm në përputhje me kërkesat teknike dhe me pëlqim paraprak të operatorit të rrjetit.
3. Matja e energjisë realizohet përmes pajisjeve matëse të miratuara nga operatori i rrjetit, për regjistrimin e energjisë së injektuar dhe të tërhequr nga rrjeti, në përputhje me kodin e matjes në fuqi.
4. Instalimet duhet të përmbushin standardet e cilësisë së energjisë dhe kërkesat teknike të përcaktuara në Kodet e Rrjetit dhe standardet teknike të miratuara nga ZRRE.
5. Operatori i rrjetit mund të kërkojë kufizim ose ndërprerje të përkohshme të prodhimit vetëm kur kjo është e nevojshme për garantimin e sigurisë, stabilitetit ose integritetit të sistemit elektroenergjetik dhe në mënyrë proporcionale, transparente dhe jodiskriminuese.



6. Operatori i rrjetit ka të drejtë qasjeje teknike në pajisjet e kyçjes, matjes dhe mbrojtjes për qëllime operative, sigurie, mirëmbajtjeje dhe verifikimi të përmbushjes së kërkesave teknike.

Neni 18

Aplikimi për Kyçje në Rrjet

1. BEBR dorëzon kërkesën për kyçje pranë operatorit përkatës të rrjetit, në varësi të kapacitetit të instaluar dhe nivelit të tensionit dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe kodet e rrjetit.
2. Kyçja e instalimeve gjeneruese të BEBR realizohet në rrjetin e shpërndarjes ose të transmetimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kodet e Rrjetit dhe kushtet teknike të përcaktuara nga operator i përkatës i rrjetit:
 - 2.1. në rrjetin e shpërndarjes (OSSh) për kapacitete të instaluar deri në 10 MW, sipas Kodit të Shpërndarjes dhe dispozitave të kësaj Rregulle.
 - 2.2. në rrjetin e transmetimit (KOSTT) për kapacitete të instaluar mbi 10 MW, sipas Kodit të Transmetimit dhe dispozitave të kësaj Rregulle.
3. Për BEBR me kapacitet të instaluar deri në 10MW, aplikimi për kyçje realizohet sipas Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes ose aktit përkatës që e zëvendëson atë.
4. Për BEBR me kapacitet të instaluar mbi 10MW, aplikimi për kyçje realizohet sipas Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit.
5. Çdo refuzim i kyçjes duhet të jetë i arsyetuar teknikisht, i dokumentuar dhe në përputhje dhe i mbështetur me dispozitat përkatëse të Kodeve të Rrjetit.
6. Operatorët e rrjetit zbatojnë procedurat e kyçjes në mënyrë proporcionale, transparente, objektive dhe jodiskriminuese.

Neni 19

Taksat e Kyçjes

1. Taksat e Kyçjes përcaktohen në përputhje me metodologjitë dhe aktet përkatëse të miratuara nga ZRRE.
2. Taksat e Kyçjes duhet të jenë transparente, objektive, jodiskriminuese dhe të bazuara në kosto reale dhe të arsyeshme.
3. Taksat e Kyçjes duhet të jenë të bazuara në parimin e reflektimit të kostos dhe të shmangin çdo formë të subvencionimit të kryqëzuar ndërmjet përdoruesve të rrjetit.
4. Operatori i rrjetit i siguron aplikuesit informacion të qartë dhe të detajuar për komponentët e taksave të kyçjes, në përputhje me metodologjitë në fuqi.



Neni 20

Standardet Teknike dhe Siguria

1. Instalimet, pajisjet dhe asetet energjetike të BEBR-së, përfshirë sistemet e gjenerimit, ruajtjes së energjisë, menaxhimit të kërkesës dhe infrastrukturën për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike, duhet të projektohen, ndërtohen, instalohen, operohen dhe mirëmbahen në përputhje me legjislacionin në fuqi, kodet teknike të aplikueshme, rregullat e operatorit të rrjetit dhe standardet teknike përkatëse ndërkombëtare.
2. Pajisjet dhe instalimet e BEBR-së duhet të plotësojnë kërkesat teknike për siguri, mbrojtje, matje, monitorim, komunikim, kontroll, cilësi të energjisë dhe stabilitet të sistemit elektroenergjetik, në mënyrë që të mos rrezikohet funksionimi i sigurt dhe i qëndrueshëm i sistemit elektroenergjetik.
3. Para vënies në operim, instalimet dhe pajisjet e BEBR-së i nënshtrohen procedurave të testimit, verifikimit dhe komisionimit, në përputhje me kërkesat teknike të Kodeve të Rrjetit dhe legjislacionin në fuqi. Operimi i instalimeve lejohet vetëm pas përfundimit me sukses të procedurave të testimit, verifikimit dhe komisionimit, sipas kërkesave të operatorit të rrjetit.
4. BEBR është përgjegjëse për zbatimin e masave të nevojshme për siguri operative, mbrojtje të njerëzve, personelit, pajisjeve dhe mjedisit, si dhe për menaxhimin e situatave emergjente, në përputhje me procedurat dhe kërkesat e operatorit të rrjetit dhe autoriteteve kompetente.
5. Operatorët e rrjetit mund të kërkojnë verifikime teknike, testime shtesë ose masa korrigjuese vetëm kur kjo është objektivisht e nevojshme, e arsyetuar dhe proporcionale për sigurinë, stabilitetin ose besueshmërinë e sistemit elektroenergjetik.

Neni 21

Matja dhe Sistemet Matëse

1. BEBR dhe anëtarët ose aksionarët e saj pajisen me sisteme matëse të certifikuara dhe të lexueshme në distancë, në përputhje me Kodin e Matjes, Kodet e Rrjetit dhe legjislacionin në fuqi.
2. Sistemet matëse duhet të mundësojnë matjen e saktë dhe të verifikueshme të:
 - 2.1. energjisë elektrike të prodhuar;
 - 2.2. energjisë elektrike të konsumuar;
 - 2.3. energjisë elektrike të ruajtur, kur është e zbatueshme;
 - 2.4. energjisë elektrike të ndarë ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së.
3. Pajisjet matëse dhe sistemet shoqëruese duhet të përfshijnë:
 - 3.1. njehsorë inteligjentë;
 - 3.2. sisteme të leximit në distancë;
 - 3.3. pajisje për regjistrimin e parametrave teknikë të sistemit elektroenergjetik;
 - 3.4. pajisje të nevojshme komunikimi dhe integrimi me sistemet e operatorit të rrjetit.



4. Matja e energjisë elektrike realizohet në përputhje me kërkesat e operatorit përkatës të rrjetit dhe shërben si bazë për ndarjen e energjisë, faturimin, balancimin dhe proceset e tjera të tregut.
5. Operatorët e rrjetit janë përgjegjës për administrimin, validimin dhe verifikimin e të dhënave zyrtare të matjes, në përputhje me legjislacionin dhe kornizën rregullative në fuqi.
6. Çdo ndryshim në konfigurimin e sistemeve matëse, pikave të matjes ose parametrave që ndikojnë në matjen e energjisë duhet të njoftohet dhe, kur kërkohet sipas procedurave të operatorit të rrjetit, të miratohet sipas procedurave të operatorit përkatës të rrjetit.
7. Të dhënat zyrtare të matjes të siguruara nga operatori i rrjetit përbëjnë bazën për ndarjen e energjisë, faturimin, balancimin dhe proceset e tjera të tregut.

Neni 22

Ndryshimet Teknike

1. BEBR njofton operatorin përkatës të rrjetit për çdo ndryshim teknik që ndikon në kapacitetin e instaluar, konfigurimin e sistemit, pikën e kyçjes, sistemet e ruajtjes së energjisë, infrastrukturën për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike ose parametrat e tjerë teknikë relevantë për operimin e sigurt të rrjetit, brenda afatit të përcaktuar nga operatori përkatës i rrjetit.
2. Ndryshimet që mund të ndikojnë në kapacitetin, sigurinë, stabilitetin ose funksionimin e sistemit elektroenergjetik i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit paraprak nga operatori përkatës i rrjetit, në përputhje me Kodet e Rrjetit.
3. Ndryshimet në përbërjen e anëtarëve ose aksionarëve, pikat matëse pjesëmarrëse ose faktorët e ndarjes së energjisë regjistrohen dhe zbatohen në përputhje me këtë Rregull dhe procedurat e operatorit përkatës të rrjetit.

KREU 5

MASAT E SIGURISË DHE EMERGJENCAT E RRJETIT

Neni 23

Procedurat për Situata Emergjente

1. Operatori i rrjetit mund të kufizojë ose ndërpresë përkohësisht kyçjen ose operimin e instalimeve të BEBR-së vetëm kur ekziston rrezik i dokumentuar për sigurinë e njerëzve, sigurinë e personelit, sigurinë dhe stabilitetin ose besueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, në përputhje me Kodet e Rrjetit.
2. Kufizimi ose ndërprerja zbatohet vetëm në masën dhe kohëzgjatjen e nevojshme për eliminimin e rrezikut. Operatori i rrjetit njofton BEBR-në për masën e ndërmarrë dhe rikthen



operimin normal pa vonesë të panevojshme sapo të eliminohen shkaqet që kanë justifikuar kufizimin ose ndërprerjen.

3. Çdo masë kufizuese ose ndërprerëse duhet të jetë proporcionale, objektive, e arsyetuar teknikisht, transparente, jodiskriminuese dhe e dokumentuar.
4. BEBR ka të drejtë të marrë njoftim me shkrim për arsyet e masës së ndërmarrë dhe të paraqesë sqarime ose kërkesë për rishqyrtim në përputhje me procedurat e operatorit të rrjetit dhe aktet përkatëse të ZRRE-së.

KREU 6

TARIFAT, MATJA, NDARJA DHE FATURIMI I ENERGJISË

Neni 24

Tarifat dhe Taksat

1. BEBR-ja dhe anëtarët e saj ose aksionarët e saj, në varësi të nivelit të tensionit në pikën e kyçjes dhe modelit të konsumit, paguajnë tarifën përkatëse të zbatueshme sipas metodologjive të miratuara nga ZRRE.
2. Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit (OST/OSSH) aplikohen në përputhje me metodologjitë tarifore të miratuara nga ZRRE dhe mbi bazën e përdorimit real të rrjetit, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale.
3. Komponentët tariforë dhe rregullatorë aplikohen sipas metodologjive të miratuara nga ZRRE dhe pasqyrojnë shërbimet e rrjetit dhe përdorimin real të rrjetit.
4. Aplikimi i tarifave për përdorimin e rrjetit ndaj energjisë së ndarë brenda BEBR-së bazohet në përdorimin real të rrjetit dhe nuk duhet, në asnjë rast, të rezultojë në ngarkim të dyfishtë për të njëjtën sasi energjie elektrike, në përputhje me metodologjitë tarifore të miratuara nga ZRRE.

Neni 25

Shkëmbimi dhe Qasja në të Dhëna

1. Shkëmbimi i të dhënave të matjes, prodhimit, konsumit dhe ndarjes së energjisë realizohet përmes sistemeve informative të operatorëve të rrjetit ose platformave të tjera të autorizuar për shkëmbimin e të dhënave.
2. Operatorët e rrjetit përbëjnë burimin zyrtar të të dhënave të matjes dhe ndarjes së energjisë për qëllime të:
 - 2.1. faturimit;
 - 2.2. ndarjes së energjisë;
 - 2.3. balancimit;
 - 2.4. proceseve të tregut;
 - 2.5. raportimit rregullator.



3. BEBR, anëtarët ose aksionarët e saj, furnizuesit, agregatorët, Palët Përgjegjëse për Balancim (PPB) dhe palët tjera të autorizuar kanë të drejtë qasjeje në të dhënat e matjes, në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre, në mënyrë të sigurt, transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregullat përkatëse të tregut.
4. Të dhënat e matjes dhe ndarjes së energjisë të siguruar nga operatorët e rrjetit përdoren si burim zyrtar për faturim, balancim dhe proceset e tregut.
5. BEBR, agregatorët dhe palët e tjera të autorizuar mund të përdorin të dhënat për analiza, optimizim operacional, menaxhim të fleksibilitetit dhe raportim, pa ndryshuar ose zëvendësuar të dhënat zyrtare të operatorit të rrjetit.

Neni 26

E Drejta për Ndarje të Energjisë

1. BEBR kanë të drejtë të ndajnë energjinë e prodhuar nga burimet e ripërtërishme ndërmjet anëtarëve ose aksionaëve të tyre, në përputhje me këtë Rregull.
2. Ndarja e energjisë ndërmjet anëtarëve ose aksionareve realizohet nga operatori përkatës i rrjetit në përputhje me modelin e ndarjes të përcaktuar nga BEBR dhe të regjistruar në sistemet e operatorit të rrjetit.
3. Për periudhën e faturimit, operatori i rrjetit i vë në dispozicion BEBR-së, së paku, të dhënat bazë për:
 - 3.1. pikën e matjes së gjenerimit (gjenerimi i matur dhe energjia tepricë); dhe
 - 3.2. pikat e matjes së konsumit për anëtarët (konsumi i matur dhe pjesa e ndarë).
4. Të dhënat për energjinë e ndarë, konsumuar dhe tepricat i komunikohen furnizuesit të kontraktuar të konsumatorit/anëtarit nga operatori i rrjetit, për reflektim në faturimin individual.
5. Operatori përkatës i rrjetit të shpërndarjes ose transmetimit përbën burimin zyrtar të të dhënave për:
 - 5.1. matjen e energjisë së prodhuar dhe konsumuar;
 - 5.2. ndarjen e energjisë ndërmjet anëtarëve të BEBR-së;
 - 5.3. transmetimin e të dhënave për qëllime faturimi, balancimi dhe proceseve të tregut.
6. BEBR, operatorët e BEBR-së ose agregatorët mund të realizojnë optimizim operacional, analiza ose raportim të të dhënave, pa zëvendësuar ose modifikuar të dhënat zyrtare të operatorit të rrjetit.
7. Shkëmbimi i të dhënave realizohet përmes platformave digjitale të operatorëve të rrjetit ose data hub-eve të miratuara nga ZRRE, në mënyrë neutrale, transparente dhe jodiskriminuese.



Neni 27

Modelet e Ndarjes së Energjisë

1. Modeli statik i ndarjes: çdo anëtar i ndahet një pjesë e paracaktuar e energjisë së gjeneruar, sipas faktorëve të pjesëmarrjes të miratuar nga organet kompetente të BEBR-së dhe të regjistruar pranë operatorit të rrjetit. Operatori i rrjetit kryen ndarjen e energjisë në përputhje me këta faktorë dhe bazuar në të dhënat zyrtare të matjes.
2. Modeli dinamik i ndarjes: ndarja e energjisë bazohet në konsumin real të pjesëmarrësve (në intervale 15 minutëshe ose sipas ciklit të ndarjes), me synim rritjen e vetëmjaftueshmërisë; energjia e pandarë mund të injektohet në rrjet ose trajtohet sipas Nenit 32.
3. Modeli hibrid i ndarjes: ndarja e energjisë realizohet duke kombinuar një komponent statik dhe një komponent dinamik, ku:
 - 3.1. një pjesë e energjisë ndahet sipas faktorëve të paracaktuar (statik) për të garantuar stabilitet dhe parashikueshmëri për anëtarët; dhe
 - 3.2. pjesa e mbetur ndahet sipas konsumit real (dinamik) për të optimizuar vetë-konsumin kolektiv dhe për të minimizuar tepricat.
4. Faktorët e ndarjes dhe çdo ndryshim i tyre bëhen efektivë vetëm pas regjistrimit dhe validimit në sistemin e operatorit të rrjetit, dhe nuk mund të aplikohen në mënyrë retroaktive.
5. Modeli i ndarjes dhe parametrat e tij mund të ndryshohen vetëm me efekt nga periudha e ardhshme e faturimit, pas regjistrimit në sistemin e operatorit të rrjetit.
6. BEBR-ja zgjedh modelin e ndarjes së energjisë në aktet e saj të brendshme dhe e regjistron atë pranë operatorit të rrjetit.

Neni 28

Faturimi

1. Faturimi për anëtarët e BEBR bëhet në përputhje me të dhënat zyrtare të matjes dhe ndarjes të siguruara nga operatorit i rrjetit.
2. Furnizuesi i energjisë elektrike me të cilin anëtarit ose aksionari ka kontratë furnizimi është përgjegjës për lëshimin e faturës individuale dhe reflektimin e të dhënave të ndarjes së energjisë, në bazë të të dhënave të ofruara nga operatorit i rrjetit.
3. Faturimi duhet të jetë transparent, i saktë, i verifikueshëm dhe jodiskriminues dhe i bazuar në kosto reale.
4. Pjesëmarrja në BEBR nuk cenon të drejtën e konsumatorit për ndërrimin e furnizuesit dhe nuk mund të kufizohet me dispozita të brendshme të BEBR-së.
5. Asnjë marrëveshje e brendshme e BEBR-së nuk mund të vendosë kushte që kufizojnë, vonojnë ose e bëjnë ekonomikisht të paarsyeshëm ndërrimin e furnizuesit nga një anëtar; çdo klauzolë e tillë konsiderohet e pavlefshme.



Neni 29

Raportimi i Incidenteve Operative

1. BEBR njofton operatorin përkatës të rrjetit për çdo ngjarje ose incident që mund të ndikojë në sigurinë, funksionimin ose stabilitetin e instalimeve të saj dhe të sistemit elektroenergjetik.
2. Operatori i rrjetit dhe BEBR bashkëpunojnë për identifikimin e shkakut të incidentit dhe rikthimin sa më të shpejtë të operimit normal të instalimeve.
3. Raportimi i incidentit përfshin së paku kohën e ngjarjes, përshkrimin e shkakut të njohur ose të dyshuar, masat e ndërmarra dhe statusin e rikthimit në operim.

Neni 30

Integrimi me Agregatorët dhe Skemat e Fleksibilitetit

1. BEBR mund të marrë pjesë në aktivitetet e agregimit, fleksibilitetit, përgjigjes ndaj kërkesës dhe tregjet përkatëse të energjisë drejtpërdrejt ose përmes agregatorëve të licencuar, në përputhje me legjislacionin, rregullat e tregut dhe kushtet e pjesëmarrjes në tregjet përkatëse.
2. Në rastet kur BEBR merr pjesë në aktivitetet e agregimit, agregatori i licencuar mund të kryejë, sipas marrëveshjes kontraktuale me BEBR-në, ndër të tjera, funksionet operative në vijim:
 - 2.1. menaxhimin operacional të fleksibilitetit dhe kapaciteteve të disponueshme të BEBR-së;
 - 2.2. optimizimin e prodhimit, konsumit dhe ruajtjes së energjisë për qëllime tregu ose shërbime të sistemit;
 - 2.3. koordinimin teknik dhe shkëmbimin e të dhënave operative me operatorët e rrjetit, furnizuesit dhe palët përgjegjëse për balancim (PPB);
 - 2.4. nominimet, aktivizimet dhe proceset e tjera tregtare që lidhen me pjesëmarrjen në tregjet e energjisë dhe shërbimet e fleksibilitetit.
3. Agregatori i siguron BEBR-së informata, raporte dhe evidenca të mjaftueshme lidhur me aktivitetet e agregimit, përfitimet ekonomike dhe performancën e shërbimeve të fleksibilitetit, në përputhje me kërkesat rregullative.
4. BEBR mund të marrë pjesë në tregjet e energjisë përmes agregatorëve të pavarur, në përputhje me rregullat e tregut, pa kërkuar pëlqimin e furnizuesit ekzistues dhe pa u kufizuar nga marrëdhëniet kontraktuale me furnizuesin, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.
5. Marrëdhënia ndërmjet BEBR-së dhe agregatorit rregullohet me marrëveshje kontraktuale që përcaktojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve, përfshirë ndarjen e përgjegjësiwe operative dhe financiare që rrjedhin nga aktivitetet e agregimit dhe pjesëmarrja në tregjet përkatëse të energjisë.
6. Pjesëmarrja e BEBR-ve në tregjet e fleksibilitetit, balancimit dhe shërbimeve të sistemit duhet të jetë e hapur, transparente, proporcionale, objektive edhe jodiskriminuese.



KREU 7

BALANCIMI DHE MENAXHIMI I TEPRICAVE

Neni 31

Përgjegjësia për Balancim

1. BEBR mban përgjegjësi për balancim vetëm në rastet kur vepron si pjesëmarrës në treg ose kur është subjekt i detyrimeve për balancim.
2. Ndarja e energjisë ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së për qëllime vetë-konsumi individual ose kolektiv nuk konsiderohet furnizim me energji elektrike ndaj palëve të treta dhe nuk krijon detyrim të veçantë për përgjegjësi për balancim.

Neni 32

Menaxhimi i Tepricave

1. Energjia tepricë mund të trajtohet në njërin nga mënyrat vijuese:
 - 1.1. të ruhet në sisteme të ruajtjes së energjisë;
 - 1.2. të shitet në tregun e energjisë elektrike drejtpërdrejt nga BEBR, përmes një agregatori ose një pjesëmarrësi tjetër të autorizuar në tregun e energjisë elektrike;
 - 1.3. të injektohet në rrjet dhe kompensohet financiarisht nga furnizuesi përkatës i anëtarit ose aksionarit të BEBR sipas marrëveshjes ndërmjet furnizuesit përkatës dhe anëtarit ose aksionarit të BEBR dhe kushteve të tregut.
2. Mënyra e trajtimit dhe shpërndarjes së përfitimeve nga energjia tepricë përcaktohet nga BEBR në aktet e saj të brendshme dhe, kur është e zbatueshme, në marrëveshjet kontraktuale me furnizuesit, agregatorët, Palët Përgjegjëse për Balancim (PPB) ose pjesëmarrësit e tjerë të tregut.
3. BEBR mund të vendosë vullnetarisht mekanizma solidariteti energjetik ose mbështetje për konsumatorët e cenueshëm (në nevojë), në përputhje me legjislacionin social dhe energjetik në fuqi.

KREU 8

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

Neni 33

Të Drejtat e BEBR

1. BEBR-të kanë të drejtën të:
 - 1.1. Kyçen në rrjet në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale;
 - 1.2. Prodhonjë, konsumojnë, ruajnë, ndajnë dhe shesin energji elektrike nga burimet e ripërtërishtme në tregun e energjisë elektrike dhe përmes Marrëveshjeve për Blerje të



Energjisë së Ripërtërishme, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e tregut në fuqi;

- 1.3. Ndajnë mes anëtarëve ose aksionarëve të BEBR energjinë që prodhohet nga njësitë e prodhimit në pronësi të asaj BEBR, bazuar në modelin e ndarjes së energjisë.
- 1.4. Marrin pjesë në tregjet e energjisë elektrike, në shërbimet e fleksibilitetit dhe shërbimet ndihmëse, drejtpërdrejt ose përmes agregatorëve, dhe në përputhje me rregullat e tregut;
- 1.5. Marrin informacion të qartë dhe të plotë për procedurat teknike, tarifat dhe afatet;
- 1.6. Përdorin mekanizmat e koordinimit në rast emergjencash sipas afateve të përcaktuara.
- 1.7. Operojnë, disponojnë dhe menaxhojnë objektet e gjenerimit, si dhe mund të angazhojnë palë të treta për operimin, mirëmbajtjen ose menaxhimin teknik të tyre, pa cenuar autonominë dhe kontrollin efektiv të BEBR-së.
- 1.8. Organizojnë dhe zbatojnë ndarjen e energjisë ndërmjet anëtarëve pa pengesa teknike, administrative ose tarifore të pajustificuara, në përputhje me këtë Rregull dhe rregullat e tregut.
- 1.9. Zhvillojnë, zotërojnë dhe operojnë sisteme të ruajtjes së energjisë, infrastrukturë për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike dhe asete të tjera energjetike.
- 1.10. Kenë qasje në të dhënat e matjes, konsumit, prodhimit dhe ndarjes së energjisë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.
2. Ndarja e energjisë elektrike ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së, e realizuar në përputhje me këtë Rregull, nuk konsiderohet furnizim me energji elektrike.
3. Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) mund të përfitojnë nga Skemat Mbështetëse në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. Ushtrimi i së drejtës për shitje dhe pjesëmarrje në treg nga Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtërishme realizohet në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë dhe nuk cenon karakterin jofitimprurës dhe qëllimin themelor të BEBR.
5. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk duhet të rezultojë në shtrembërim të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike dhe zbatohet në përputhje me parimet e tregut të brendshëm të energjisë.
6. Dispozitat e këtij neni nuk përjashtojnë BEBR nga detyrimet dhe pagesat që aplikohen për pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike, përfshirë tarifat e rrjetit, detyrimet e balancimit dhe detyrimet tjera të përcaktuara në legjislacionin dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike në fuqi.



Neni 34

Detyrimet e BEBR

1. BEBR është e detyruar të:

- 1.1. respektojë legjislacionin në fuqi, Kodet e Rrjetit, Kodin e Matjes, Rregullat e Tregut dhe kërkesat teknike të zbatueshme;
- 1.2. sigurojë që instalimet dhe pajisjet e saj të përmbushin kërkesat teknike, të sigurisë, matjes dhe komunikimit të përcaktuara nga legjislacioni dhe operatorët e rrjetit;
- 1.3. bashkëpunojë me operatorët e rrjetit, Palën Përgjegjëse për Balancim (PPB), agregatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të autorizuar të tregut për qëllime matjeje, raportimi, balancimi dhe operimi të sigurt të sistemit elektroenergjetik, kur është e aplikueshme;
- 1.4. lidhë dhe respektojë marrëveshjet përkatëse të kyçjes në rrjet, në përputhje me modelin organizativ dhe konfigurimin teknik të BEBR-së;
- 1.5. lidhë marrëveshjet për aderim në Rregullat e Tregut dhe për Palën Përgjegjëse për Balancim, kur merr pjesë drejtpërdrejt në tregun e energjisë elektrike;
- 1.6. njoftojë operatorin përkatës të rrjetit dhe kur është e nevojshme edhe ZRRE-në, për çdo ndryshim teknik, zgjerim të kapaciteteve, ndryshim të pikave matëse ose ndryshim tjetër që mund të ndikojë në operimin e sistemit elektroenergjetik dhe të sigurojë miratimin përkatës;
- 1.7. respektojë procedurat operative, masat e sigurisë dhe procedurat për emergjencë dhe ndërprerje të rrjetit;
- 1.8. sigurojë saktësinë e informacionit dhe të dhënave të paraqitura pranë ZRRE-së, operatorëve të rrjetit dhe institucioneve të tjera kompetente;
- 1.9. përfshihet në raportimin periodik, verifikimet dhe auditimet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.10. respektojë modelin e deklaruar të ndarjes së energjisë dhe të sigurojë përditësimin e të dhënave për anëtarët, aksionarët dhe faktorët e ndarjes në përputhje me procedurat e operatorit të rrjetit;
- 1.11. respektojë të drejtat e anëtarëve ose aksionarëve, përfshirë transparencën, qasjen në informacion, të drejtën për largim nga BEBR-ja dhe të drejtën për ndërrimin e furnizuesit të energjisë elektrike.

Neni 35

Të Drejtat e Operatorëve

1. Operatorët e rrjetit kanë të drejtën të:

- 1.1. Të informohen për krijimin e një BEBR, si dhe për përmbajtjen e mëposhtme dhe çdo ndryshim në këtë përmbajtje:



- 1.1.1. Përshkrimi i funksionimit të stabilimenteve të gjenerimit (dhe stabilimenteve për ruajtje të energjisë, nëse është e zbatueshme), duke përfshirë numrat e pikave të matjes;
- 1.1.2. Instalimet e konsumit të përdoruesve pjesëmarrës të rrjetit, duke specifikuar numrat e pikave të matjes;
- 1.1.3. Të dhënat për modelin e ndarjes së energjisë, faktorët e ndarjes dhe ndryshimet e tyre;
- 1.1.4. Shtimin apo largimin e anëtarëve ose aksionarëve të BEBR;
- 1.1.5. Përfundimi ose shpërbërja e BEBR dhe dekomisionimin e objekteve të gjenerimit.
- 1.2. Kërkesa për informacion duhet të jetë proporcionale dhe e kufizuar vetëm në të dhënat e nevojshme për operimin e sigurt, stabilitetin dhe administrimin e rrjetit elektroenergjetik.
- 1.3. Monitorojnë rrjetin për siguri, stabilitet dhe cilësi të furnizimit;
- 1.4. Miratojnë ose refuzojnë kërkesat për kyçje në rast mungese të kapaciteteve ose rrezikut të dokumentuar teknik të sigurisë së operimit të rrjetit. Refuzimi duhet të jetë i arsyetuar teknikisht, proporcional dhe i dokumentuar, në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe legjislacionin në fuqi.
- 1.5. Shkryçin përkohësisht instalimet ose asetet energjetike të BEBR-së vetëm për arsye sigurie të dokumentuara teknikisht dhe në përputhje me Kodet e Rrjetit.
- 1.6. Vendosin kushtet teknike për matje dhe pajisje mbrojtëse.
- 1.7. Operatorët e rrjetit kanë të drejtë të kryejnë inspektime, verifikime dhe testime teknike në përputhje me legjislacionin dhe Kodet e Rrjetit.
- 1.8. Përcaktojnë dhe publikojnë procedurat dhe afatet operative për reagim gjatë emergjencave.

Neni 36

Detyrimet e Operatorëve

1. Operatorët janë të detyruar të:
 - 1.1. Sigurojnë trajtim transparent, jodiskriminues dhe proporcional ndaj BEBR-ve në procedurat e kyçjes, matjes, ndarjes së energjisë dhe qasjes në treg.
 - 1.2. Sigurojnë shkëmbimin e të dhënave me BEBR-të, furnizuesit, PPB-të, agregatorët dhe palët e tjera të autorizuara për qëllime faturimi, balancimi dhe kompensimi.
 - 1.3. Informojnë BEBR për kufizimet e kapacitetit dhe menaxhimin e kongestionit;
 - 1.4. Sigurojnë procedura të qarta emergjencash dhe ndërprerjesh, me afate për reagim të palëve.
 - 1.5. Operatorët e rrjetit janë përgjegjës për matjen e energjisë së furnizuar dhe të injektuar në përputhje me kornizën e matjes dhe rregullat e tregut.



- 1.6. Operatorët e rrjetit duhet t'ua vënë në dispozicion leximet e matësve si furnizuesve edhe BEBR sa më shpejt të jetë e mundur, dhe brenda afateve të përcaktuara në kornizën e matjes dhe rregullat e tregut. Të dhënat duhet të vihen në dispozicion nëpërmjet sistemeve elektronike, platformave digjitale ose portaleve të dedikuara për përdoruesit dhe falas me masa të përshtatshme sigurie.
- 1.7. Qasja në të dhëna sigurohet në mënyrë jodiskriminuese për të gjitha palët e autorizuar.
- 1.8. Operatorët e rrjetit realizojnë ndarjen e energjisë në përputhje me modelin e ndarjes së energjisë të deklaruar nga BEBR dhe të regjistruar në sistemet e operatorit, bazuar në të dhënat zyrtare të matjes.
- 1.9. Operatorët lidhin marrëveshje të kyçjes me BEBR dhe/ose përdoruesit individualë sipas modelit rregullator në fuqi.
- 1.10. Operatorët e rrjetit sigurojnë që kërkesat teknike, administrative dhe procedurale të zbatueshme për BEBR-të të mos krijojnë barriera ose kufizime të pajustificuara për themelimin, operimin ose zgjerimin e tyre.

Neni 37

Të Drejtat e Furnizuesit përkatës

1. Furnizuesi ka të drejtë të:
 - 1.1. Lëshojë fatura dhe zbatojë mekanizmat e kompensimit sipas marrëveshjeve kontraktuale dhe legjislacionit në fuqi;
 - 1.2. Merr nga operatori i rrjetit dhe palët e autorizuar të tregut të dhënat e nevojshme për faturim, kompensim dhe proceset e tregut;
 - 1.3. Kërkojë verifikimin dhe korrigjimin e të dhënave të matjes ose ndarjes në rast të dyshimeve të arsyeshme për pasaktësi;
 - 1.4. pezullojë përkohësisht zbatimin e kompensimit vetëm kur mungojnë të dhënat zyrtare të matjes ose ekzistojnë mospërputhje të pazgjidhura të konfirmuara nga operatori i rrjetit;
 - 1.5. mbështetet në të dhënat zyrtare të operatorit të rrjetit për qëllime faturimi dhe kompensimi.
 - 1.6. Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për pasaktësi në faturim ose kompensim, si dhe për efektet financiare që rrjedhin nga ndarja e energjisë brenda BEBR-së, kur këto burojnë nga të dhëna të pasakta, të paplota ose të vonuara të ofruara nga operatori i rrjetit ose nga të dhënat zyrtare të ndarjes së energjisë të përcaktuara nga operatori i rrjetit.
 - 1.7. Në rast të korrigjimit të mëvonshëm të të dhënave zyrtare të matjes ose ndarjes së energjisë nga operatori i rrjetit, furnizuesi ka të drejtë të bëjë kryejë korrigjimet përkatëse në faturim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e tregut.



1.8. Në rast të ndërrimit të furnizuesit nga një anëtar i BEBR, kompensimi për periudhën përkatëse kryhet deri në datën efektive të ndërrimit, bazuar në të dhënat zyrtare të matjes.

Neni 38

Detyrimet e Furnizuesit përkatës

1. Furnizuesi është i detyruar të furnizojë anëtarët ose aksionarët e BEBR-së me të cilët ka lidhur kontratë furnizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit dhe kërkesat e kësaj Rregulle.
2. Furnizuesi lëshon faturat për anëtarët ose aksionarët e BEBR-së në bazë të të dhënave zyrtare të matjes dhe ndarjes së energjisë të siguruara nga operatori i rrjetit.
3. Faturimi dhe kompensimi duhet të jenë të sakta, transparente, të verifikueshme dhe jodiskriminuese.
4. Furnizuesi nuk mund të diskriminojë konsumatorët për shkak të pjesëmarrjes së tyre në një BEBR ose për shkak të ushtrimit të të drejtave të tyre sipas kësaj Rregulle.
5. Furnizuesi bashkëpunon me BEBR-të, operatorët e rrjetit, agregatorët, Palët Përgjegjëse për Balancim (PPB) dhe pjesëmarrësit e tjerë të autorizuar të tregut për shkëmbimin e të dhënave dhe realizimin korrekt të proceseve të faturimit, kompensimit dhe tregut.
6. Furnizuesi mban evidencë të saktë të faturimit dhe kompensimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Zbatimi i mekanizmave të kompensimit realizohet në përputhje me legjislacionin, marrëveshjet kontraktuale dhe metodologjitë e miratuara nga ZRRE

KREU 9

MBROJTJA SOCIALE, GJINORE DHE MJEDISORE

Neni 39

Konsumatorët e Cenueshëm (në nevojë)

1. Konsumatorët e cenueshëm (në nevojë) kanë të drejtë të marrin pjesë në Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) si anëtarë me të drejta të plota, përfshirë të drejtën e votës, në përputhje me statutin dhe rregullat e brendshme të BEBR.
2. Pjesëmarrja e konsumatorëve të cenueshëm (në nevojë) në BEBR duhet të jetë e garantuar në mënyrë jodiskriminuese dhe nuk mund të kufizohet për arsye financiare ose administrative që nuk janë objektivist të justifikuara.
3. Konsumatorët e cenueshëm (në nevojë) mund të përfitojnë masa mbështetëse ose lehtësuese kur këto parashihen nga BEBR, programet publike ose skemat mbështetëse në fuqi.



4. BEBR-të mund të zbatojnë masa mbështetëse për konsumatorët e cenueshëm (në nevojë), përfshirë:
 - 4.1. kushte të lehtësuara anëtarësimi;
 - 4.2. mekanizma të solidaritetit energjetik dhe mbështetjes sociale të miratuara nga BEBR, ose skema të ndarjes së përfitimeve për konsumatorët.
5. Konsumatorët e cenueshëm (në nevojë) identifikohen dhe përcaktohen në bazë të kriterëve të përcaktuara në kuadër të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm (në nevojë) të Energjisë Elektrike.
6. BEBR-të inkurajohen të kontribuojnë në reduktimin e varfërisë energjetike përmes mekanizmave të solidaritetit, rritjes së qasjes në energji të përbalueshme dhe shpërndarjes së drejtë të përfitimeve në nivel lokal dhe promovimit të tranzicionit energjetik të drejtë.

Neni 40

Përgjegjësitë Sociale dhe Gjinore të BEBR

1. BEBR promovon:
 - 1.1. pjesëmarrjen aktive të komuniteteve lokale dhe qasje të barabartë për të gjithë anëtarët ose aksionarët, pa diskriminim;
 - 1.2. bashkëpunimin me komunat, institucionet publike dhe organizatat relevante për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfitimeve lokale;
 - 1.3. pjesëmarrjen aktive të grave, të rinjve dhe grupeve të tjera të nënperfaqësuar në proceset vendimmarrëse dhe në përfitimet që rrjedhin nga aktivitetet e BEBR-së;
 - 1.4. reduktimin e varfërisë energjetike dhe promovimin e tranzicionit të drejtë energjetik në nivel lokal;
2. Zbatimi i këtyre parimeve realizohet në mënyrë proporcionale me madhësinë dhe kapacitetin organizativ dhe aktivitetet e BEBR.

Neni 41

Edukimi, Ndërgjegjësimi dhe Pjesëmarrja Gjinore

1. BEBR-të, operatorët e rrjetit, furnizuesit dhe institucionet kompetente promovojnë informimin e qartë, të saktë dhe të qasshëm për konsumatorët lidhur me të drejtat, detyrimet dhe përfitimet që lidhen me pjesëmarrjen në Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.
2. Këto subjekte mund të promovojnë eficiencën e energjisë, burimet e ripërtërishme të energjisë dhe praktikat e qëndrueshme, si dhe të organizojnë aktivitete informuese dhe ndërgjegjëse, që nxisin pjesëmarrjen aktive të komuniteteve në prodhimin, konsumimin, ruajtjen, ndarjen dhe përdorimin efikas të energjisë dhe fleksibilitetin e kërkesës.
3. Informacioni duhet të jetë i kuptueshëm, i qasshëm dhe i disponueshëm, kur është e mundur, në formate digjitale dhe jo-digjitale.



4. Aktivitetet informuese dhe edukative duhet të mbështesin pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në vetë-konsum, ndarjen e energjisë, fleksibilitetin dhe përdorimin inteligjent të energjisë.
5. Aktivitetet informuese dhe edukative promovojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave, si dhe përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar në aktivitetet dhe strukturat vendimmarrëse të BEBR-ve.

KREU 10

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Neni 42

Procedurat e Monitorimit

1. ZRRE monitoron funksionimin dhe zhvillimin e BEBR-ve në mënyrë proporcionale me madhësinë, kapacitetin dhe aktivitetet e tyre.
2. Monitorimi mund të përfshijë, ndër të tjera:
 - 2.1. prodhimin, konsumimin, ruajtjen, ndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike;
 - 2.2. pjesëmarrjen e konsumatorëve në nevojë, grave dhe grupeve të tjera të nënpërfaqësuar;
 - 2.3. kontributin e BEBR-ve në zhvillimin lokal, tranzicionin energjetik dhe reduktimin e varfërisë energjetike;
 - 2.4. pjesëmarrjen në tregjet e energjisë, fleksibilitetit, agregimit dhe shërbimeve të sistemit;
 - 2.5. respektimin e kërkesave rregullative dhe teknike të zbatueshme.
3. Raportimi dhe monitorimi realizohen në mënyrë proporcionale, duke shmangur barrët administrative të panevojshme për BEBR-të.
4. ZRRE mund të kërkojë informata ose raporte shtesë kur kjo është objektivist e nevojshme për ushtrimin e kompetencave të saj rregullative.

Neni 43

Raportimi

1. BEBR përgatit dhe dorëzon në ZRRE raport vjetor për aktivitetet e saj.
2. Raporti vjetor përfshin së paku:
 - 2.1. kapacitetet e instaluar dhe asetet energjetike në operim;
 - 2.2. energjinë e prodhuar, konsumuar, ruajtur, ndarë dhe, kur është e zbatueshme, të shitur;
 - 2.3. energjinë tepricë dhe mënyrën e trajtimit të saj;
 - 2.4. numrin e anëtarëve ose aksionarëve dhe ndryshimet kryesore në strukturën e tyre;
 - 2.5. informacion mbi pjesëmarrjen në aktivitetet e agregimit, fleksibilitetit ose tregut të energjisë, kur është e zbatueshme;



- 2.6. informacion financiar në masën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi;
- 2.7. ndryshimet kryesore në modelin e ndarjes së energjisë, kur kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese.
3. Raportimi bazohet, kur është e zbatueshme, në të dhënat zyrtare të matjes dhe ndarjes së energjisë të siguruara nga operatorët e rrjetit.
4. Raporti vjetor dorëzohet në ZRRE jo më vonë se data 31 mars për vitin paraprak.
5. ZRRE mund të kërkojë raporte ose informata shtesë vetëm kur kjo është e nevojshme dhe proporcionale për ushtrimin e kompetencave të saj rregullative.
6. ZRRE mund të publikojë të dhëna statistikore të agreguara për BEBR-të, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin tregtar.
7. ZRRE mund të përdorë të dhënat e disponueshme nga operatorët e rrjetit, furnizuesit ose platformat e të dhënave për të shmangur kërkimin e informacionit që tashmë ekziston në sistemet zyrtare.

KREU 11

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE SIGURIA KIBERNETIKE

Neni 44

Klasifikimi dhe Menaxhimi i të Dhënave

1. Të gjitha të dhënat personale të anëtarëve të BEBR trajtohen në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Informatat konfidenciale klasifikohen dhe trajtohen në pajtim me Rregullën e ZRRE për Informatat Konfidenciale.
3. Çdo subjekt i përfshirë është i detyruar të kufizojë qasjen vetëm për personat e autorizuar, sigurojë gjurmueshmëri (traceability/audit trail) të përdorimit të të dhënave, zbatojë politika të qarta për ruajtje, arkivim dhe fshirje të të dhënave personale dhe mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.
4. Anëtarët e BEBR mbeten subjekte të të dhënave të tyre të konsumit dhe prodhimit dhe kanë të drejtë të autorizojnë ose të tërheqin autorizimin për ndarjen e këtyre të dhënave me palë të treta, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Anëtarët e BEBR kanë të drejtë të transferojnë të dhënat e tyre të energjisë tek palë të treta të autorizuar, në format të standardizuar dhe të lexueshëm elektronikisht, pa pengesa të pajustificuara.
6. BEBR, operatorët e rrjetit dhe subjektet e autorizuar që përpunojnë të dhëna në kuadër të kësaj Rregulle, obligohen të zbatojnë klasifikimin e të dhënave sipas nivelit të ndjeshmërisë dhe rrezikut, në përputhje me standardet ISO/IEC 27001 dhe legjislacionin për mbrojtjen e



të dhënave personale, duke siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave.

7. Mbledhja, përpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave kufizohen në minimumin e nevojshëm për realizimin e matjes, ndarjes së energjisë, faturimit, balancimit dhe proceseve të tregut, në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave.

Neni 45

Mbrojtja dhe Përpunimi i të Dhënave Personale

1. Anëtarët e BEBR duhet të informohen në mënyrë të qartë, transparente dhe paraprake lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre personale. Ky informim duhet të përfshijë llojin e të dhënave që mblidhen, qëllimin specifik të përdorimit të tyre, identitetin e palëve që kanë qasje në këto të dhëna, si dhe afatin kohor të ruajtjes së tyre.
2. Përpunimi i të dhënave personale bazohet në pëlqimin e subjektit të të dhënave ose në baza tjera ligjore të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Roli i secilës palë në përpunimin e të dhënave (kontrollues/përpunues) dhe bazat ligjore për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet operatorëve, furnizuesve, PPB/agregatorëve dhe BEBR-ve përcaktohen qartë në marrëveshjet operative dhe aktet përkatëse, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Anëtarët e BEBR-së dhe subjektet e të dhënave gëzojnë të drejtën për qasje, korrigjim, bartje (transferim), kufizim të përpunimit, kundërshtim të përpunimit dhe fshirje të të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të harmonizuar me GDPR.

Neni 46

Siguria Kibernetike

1. BEBR, operatorët e rrjetit, furnizuesit, palët përgjegjëse për balancim (PPB), agregatorët dhe ofruesit e platformave digjitale zbatojnë masa minimale të sigurisë kibernetike për mbrojtjen e sistemeve energjetike, të dhënave të matjes dhe proceseve të tregut, në përputhje me standardet ndërkombëtare relevante, përfshirë serinë IEC 62351 për sigurinë e komunikimeve dhe shkëmbimit të të dhënave në sistemet elektroenergjetike.
2. Kur është e zbatueshme, kërkesat e sigurisë kibernetike harmonizohen me Acquis të Bashkimit Evropian për sigurinë e rrjeteve dhe informacionit në sektorin e energjisë, përfshirë Acquis dhe aktet sektoriale relevante të BE-së për sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike.
3. Masat e sigurisë kibernetike zbatohen mbi bazën e vlerësimit të rrezikut, duke respektuar parimet e proporcionalitetit dhe shkallëzimit sipas:
 - 3.1. madhësisë dhe kompleksitetit të BEBR-së;



- 3.2. nivelit të integritetit me sistemet e operatorëve të rrjetit; dhe
- 3.3. ndikimit potencial në sigurinë dhe funksionimin e rrjetit elektroenergjetik.
4. ZRRE, në koordinim me operatorët e rrjetit dhe autoritetet kompetente për sigurinë kibernetike, mund të përcaktojë kërkesa sektoriale minimale të sigurisë kibernetike për:
 - 4.1. platformat e matjes dhe ndarjes së energjisë;
 - 4.2. ndërfaqet e shkëmbimit të të dhënave dhe data hub-et;
 - 4.3. sistemet e matjes inteligjente dhe integrimet digjitale me palët e tregut.
5. Kontrollat bazë përfshijnë, së paku:
 - 5.1. menaxhimin e identitetit dhe kontrollin e qasjes;
 - 5.2. autentikim të fortë të përdoruesve kur është e aplikueshme;
 - 5.3. enkriptim të të dhënave gjatë transmetimit dhe ruajtjes;
 - 5.4. regjistrim dhe monitorim të aktiviteteve kritike;
 - 5.5. menaxhim të dobësive dhe përditësimeve të sigurisë;
 - 5.6. kopje rezervë dhe mekanizma rikthimi të shërbimeve;
 - 5.7. segmentim proporcional të rrjeteve dhe mbrojtje të ndërfaqeve digjitale.
6. BEBR dhe palët e përfshira sigurojnë që furnizuesit e pajisjeve digjitale dhe softuerëve të përmbushin kërkesat minimale të sigurisë kibernetike dhe të zbatojnë praktika të sigurta të zinxhirit të furnizimit.
7. Sistemet e matjes inteligjente dhe platformat e ndarjes së energjisë duhet të përfshijnë mekanizma autentikimi, autorizimi, enkriptimi dhe gjurmueshmërie të veprimeve, në përputhje me kërkesat e operatorëve të rrjetit dhe ZRRE-së.
8. Zbatimi i kontrolleve bazë realizohet në mënyrë proporcionale dhe të bazuar në rrezik, duke siguruar që kërkesat e sigurisë kibernetike të mos krijojnë barrë të paarsyeshme administrative ose financiare për BEBR-të mikro dhe të vogla, pa cenuar sigurinë e rrjetit dhe proceseve të tregut.
9. Incidentet kibernetike që ndikojnë në matjen, ndarjen e energjisë ose ndërfaqet me operatorët e rrjetit raportohen pa vonesë tek operatori përkatës i rrjetit dhe ZRRE, në përputhje me procedurat sektoriale të sigurisë kibernetike.
10. Masat e sigurisë kibernetike duhet të harmonizohen me parimet e Direktivës (EU) 2022/2555 NIS2 (Network and Information Security/Siguria e Rrjeteve dhe Sistemeve të Informacionit) dhe udhëzimet relevante të ENISA (European Union Agency for Cybersecurity/Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike) për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe sistemeve energjetike.
11. Subjektet që operojnë sisteme kritike të të dhënave ose platforma digjitale të BEBR-ve duhet të implementojnë mekanizma proporcionalë për monitorim, detektim dhe reagim ndaj incidenteve kibernetike, përfshirë sistemet e logimit, monitorimit dhe detektimit të anomalive, sipas nivelit të rrezikut dhe kompleksitetit të sistemeve.



Neni 47

Menaxhimi dhe Raportimi i Incidenteve Kibernetike

1. BEBR dhe palët tjera janë të obliguara të raportojnë çdo incident që ndikon ose mund të ndikojë në funksionimin e BEBR-së, në sigurinë e rrjetit apo në privatësinë e të dhënave të Agjencia për Informim dhe Privatësi, operatori përkatës i rrjetit dhe ZRRE.
2. BEBR-të dhe operatorët e rrjetit janë të obliguar të disponojnë plane të dokumentuara për reagimin ndaj incidenteve kibernetike, për rikthimin e shërbimeve dhe për kryerjen e testimeve periodike të sigurisë. Këto plane duhet të sigurojnë një qasje proaktive ndaj rrezikut, duke përfshirë procedura të qarta të përgjegjësisë, mekanizma të komunikimit dhe masa parandaluese që rrisin qëndrueshmërinë dhe aftësinë ripërtëritëse të infrastrukturës energjetike ndaj kërcënimeve kibernetike.
3. BEBR kryejnë testime periodike të sigurisë kibernetike dhe ushtrime simulimi të incidenteve sipas kërkesave të operatorëve të rrjetit dhe autoriteteve kompetente.
4. Në rast të incidenteve kritike kibernetike që ndikojnë në operimin e rrjetit, integritetin e të dhënave ose sigurinë e sistemeve digjitale, subjekti përgjegjës obligohet të kryejë raportim preliminar brenda 6 orëve nga identifikimi i incidentit. Incidentet klasifikohen sipas nivelit të ndikimit (kritik, i rëndësishëm, i moderuar) dhe raportohen në përputhje me afatet dhe procedurat sektoriale të përcaktuara nga autoritetet kompetente.
5. Në rast të cenimit të të dhënave personale ose shkeljes së sigurisë së të dhënave, incidenti raportohet edhe pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Incidentet klasifikohen sipas nivelit të ndikimit në konfidencialitet, integritet, disponueshmëri dhe sigurinë operative të sistemeve.
7. Subjektet e përfshira sigurojnë ruajtjen e evidencave dhe gjurmëve elektronike (logs) të nevojshme për hetimin, analizimin dhe dokumentimin e incidenteve kibernetike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



KREU 12 INTEGRIMI I SISTEMEVE DIGJITALE

Neni 48

Shkëmbimi i të Dhënave dhe Rrjedha e Informacionit

1. Operatorët e rrjetit, individualisht ose përmes një platforme qendrore të të dhënave (Data Hub), kur kjo është e zbatueshme, sigurojnë mekanizmat e nevojshëm për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet BEBR-ve, furnizuesve, agregatorëve, palëve përgjegjëse për balancim (PPB) dhe pjesëmarrësve të tjerë të autorizuar të tregut, në mënyrë që të mundësohet funksionimi efikas, transparent dhe i sigurt i sistemit elektroenergjetik.
2. Platforma ose mekanizmat e shkëmbimit të të dhënave mundësojnë, së paku:
 - 2.1. shkëmbimin e të dhënave të nevojshme për matje, ndarje të energjisë, faturim, kompensim, balancim dhe procese të tregut;
 - 2.2. menaxhimin e ndryshimeve në përbërjen e anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së, përfshirë shtimin, largimin, transferimin ose ndryshime të tjera relevante që ndikojnë në matjen dhe ndarjen e energjisë;
 - 2.3. shkëmbimin e informacionit teknik dhe operativ të nevojshëm për funksionimin e BEBR-ve dhe integrimin e tyre në tregun e energjisë elektrike.
3. Proceset e komunikimit që lidhen me prodhimin, konsumimin, ruajtjen, ndarjen dhe tregtimin e energjisë nga BEBR realizohen përmes sistemeve të operatorëve të rrjetit, platformave qendrore të të dhënave ose mekanizmave të tjerë të miratuar nga operatorët e rrjetit dhe ZRRE.
4. Transmetimi dhe shkëmbimi i të dhënave kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe formatet e komunikimit të miratuara nga operatorët e rrjetit.
5. Të gjitha palët e përfshira obligohen të respektojnë kërkesat teknike, organizative dhe të sigurisë për shkëmbimin e të dhënave, me qëllim garantimin e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe interoperabilitetit të informacionit.
6. Platforma ose mekanizmat e shkëmbimit të të dhënave operojnë në mënyrë neutrale, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese, duke siguruar qasje të barabartë për të gjitha palët e autorizuar.
7. Anëtarët ose aksionarët e BEBR-së kanë të drejtë të autorizojnë palë të treta për qasje në të dhënat e tyre energjetike, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregullat për qeverisjen e të dhënave.
8. Të dhënat e shkëmbyera përmes platformës ose mekanizmave të tjerë të autorizuar mund të përdoren nga BEBR, anëtarët e saj dhe palët e autorizuar për analiza të prodhimit, konsumit, ruajtjes dhe ndarjes së energjisë, optimizimin e vetë-konsumit, përmirësimin e efikasitetit të



energjisë, menaxhimin e kërkesës, fleksibilitetin e sistemit, karikimin inteligjent të automjeteve elektrike dhe planifikimin e masave për tranzicionin energjetik.

9. Shkëmbimi i të dhënave sipas këtij neni realizohet duke respektuar parimet e minimizimit të të dhënave, mbrojtjes së të dhënave personale, sigurisë kibernetike dhe neutralitetit teknologjik.

Neni 49

Standardet Teknike dhe Certifikimi

1. Të gjitha sistemet, pajisjet dhe platformat digjitale që përdoren nga BEBR-të, operatorët e rrjetit, furnizuesit, agregatorët dhe palët e tjera të autorizuar duhet të jenë në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë të zbatueshme, përfshirë standardet relevante IEC, IEEE, ISO/IEC ose standarde të tjera ndërkombëtare të zbatueshme.
2. Sistemet dhe pajisjet digjitale që përdoren për matje, ndarje të energjisë, shkëmbim të të dhënave, fleksibilitet, agregim, ruajtje të energjisë dhe procese të tregut duhet të jenë të certifikuar ose të verifikuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe standardeve teknike përkatëse.
3. Sistemet digjitale duhet të sigurojnë interoperabilitet, shkëmbim të sigurt të të dhënave dhe integrim me sistemet e operatorëve të rrjetit, furnizuesve, agregatorëve, platformave të të dhënave dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut.
4. Kërkesat teknike dhe të certifikimit zbatohen në mënyrë proporcionale, objektive, neutrale nga aspekti teknologjik dhe të bazuar në rrezik, duke marrë parasysh madhësinë, kompleksitetin dhe ndikimin e sistemit ose pajisjes në funksionimin e rrjetit dhe proceseve të tregut.
5. Sistemet dhe pajisjet digjitale duhet të mbështesin funksionalitete që mundësojnë matje të avancuar, shkëmbim të automatizuar të të dhënave, monitorim, menaxhim të energjisë, fleksibilitet, ruajtje të energjisë dhe integrim të burimeve të shpërndara të energjisë, kur kjo është teknikisht e zbatueshme.
6. Zbatimi i këtij neni nuk duhet të krijojë barriera të pajustificuara teknike, administrative ose financiare për BEBR-të, veçanërisht për BEBR-të mikro dhe të vogla, për aq kohë sa garantohen siguria, interoperabiliteti dhe funksionimi i sigurt i sistemit elektroenergjetik.

Neni 50

Qeverisja e të Dhënave dhe Përgjegjësitë

1. BEBR menaxhon të dhënat operative dhe administrative që lidhen me aktivitetet e saj, ndërsa operatori përkatës i rrjetit mbetet burimi zyrtar i të dhënave të matjes, ndarjes së energjisë, barazimit/shlyerjes përfundimtar për qëllime faturimi, raportimi dhe proceseve të tregut.



2. Operatorët e rrjetit, furnizuesit, palët përgjegjëse për balancim (PPB), agregatorët, BEBR-të dhe palët e tjera të autorizuar janë përgjegjëse për integritetin, sigurinë dhe funksionimin korrekt të sistemeve të tyre, si dhe për shkëmbimin e saktë dhe në kohë të të dhënave.
3. Çdo palë mban përgjegjësi për saktësinë, përditësimin, cilësinë dhe integritetin e të dhënave që gjeneron, përpunon ose transmeton, si dhe për pasojat që rrjedhin nga mosrespektimi i këtyre detyrimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Shkëmbimi, përpunimi, ruajtja dhe transferimi i të dhënave realizohen në përputhje me dispozitat e Kreut për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Sigurinë Kibernetike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Të gjitha palët obligohen të zbatojnë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe gjurmueshmërinë e të dhënave.
6. BEBR dhe anëtarët ose aksionarët e saj kanë të drejtë të transferojnë ose të autorizojnë transferimin e të dhënave të tyre energjetike tek palët e treta të autorizuar, në format të standardizuar, të lexueshëm elektronikisht dhe të ndërveprueshëm, pa pengesa të pajustificuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Qasja në të dhënat energjetike realizohet mbi bazën e autorizimit të subjektit të të dhënave ose bazave të tjera ligjore të përcaktuara me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Qeverisja e të dhënave sipas këtij neni bazohet në parimet e saktësisë, proporcionalitetit, minimizimit të të dhënave, transparencës, neutralitetit teknologjik dhe interoperabilitetit.

KREU 13

MBËSHTETJA E INOVACIONIT

Neni 51

Mbështetja për Teknologjitë Inovative

1. Institucionet kompetente, përfshirë ZRRE-në, operatorët e rrjetit, BEBR-të dhe palët e tjera relevante promovojnë dhe mbështesin zhvillimin dhe zbatimin e projekteve, teknologjive dhe modeleve inovative, integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e energjisë elektrike.
2. Mbështetja mund të realizohet përmes masave rregullative, financiare, teknike, institucionale ose formave të tjera të përshtatshme dhe mund të përfshijë projekte që kontribuojnë në:
 - 2.1. fleksibilitetin e sistemit elektroenergjetik;
 - 2.2. integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë;
 - 2.3. menaxhimin e kërkesës dhe përgjigjen ndaj kërkesës (Demand Response);



- 2.4. ruajtjen e energjisë;
 - 2.5. agregimin dhe shërbimet e fleksibilitetit;
 - 2.6. digjitalizimin dhe automatizimin e rrjetit;
 - 2.7. sistemet inteligjente të matjes dhe menaxhimit të energjisë;
 - 2.8. mbushjen (karikimin) inteligjente të automjeteve elektrike dhe integrimin e tyre në sistemin elektroenergjetik;
 - 2.9. inteligjencën artificiale, analizën e të dhënave dhe teknologjitë e tjera inovative që mbështesin funksionimin efikas të sistemit elektroenergjetik.
- 3. Mbështetja për projektet, iniciativat dhe teknologjitë inovative nuk duhet të cenojë sigurinë dhe stabilitetin e sistemit elektroenergjetik, konkurrencën e ndershme, mbrojtjen e konsumatorëve, integritetin e tregut të energjisë elektrike dhe sigurinë kibernetike.
 - 4. Mbështetja për inovacion zbatohet në mënyrë proporcionale, transparente, jodiskriminuese dhe teknologjikisht neutrale.
 - 5. BEBR-të, konsumatorët aktivë, agregatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut mund të propozojnë iniciativa inovative që lidhen me energjinë e shpërndarë, fleksibilitetin, ruajtjen e energjisë, digjitalizimin dhe dekarbonizimin e sektorit të energjisë.

ZRRE, në përputhje me kompetencat e saj dhe legjislacionin në fuqi, mund të mbështesë projekte pilot, mjedise testuese rregullative (regulatory sandboxes) ose iniciativa të tjera inovative që kontribuojnë në zhvillimin e BEBR-ve dhe modernizimin e sektorit të energjisë.

KREU 14

ANKESAT DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 52

Ankesat dhe Zgjidhja e Kontesteve

- 1. Te gjitha ankesat dhe kontestet ndërmjet anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së, që burojnë nga organizimi i brendshëm, statuti, marrëveshjet ndërmjet anëtarëve ose shpërndarja e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet tyre zgjidhen në përputhje me aktet e brendshme të BEBR-së dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- 2. Te gjitha ankesat dhe kontestet ndërmjet BEBR-së dhe operatorëve të rrjetit, të licencuarve në sektorin e energjisë ose pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike zgjidhen në pajtim me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.



KREU 15

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Marrëdhënia e Rregullës me Aktet e Tjera Rregullative

1. Dispozitat e kësaj Rregulle zbatohen në harmoni me aktet tjera nënligjore të nxjerra nga ZRRE.
2. Për çështjet e tregut të energjisë elektrike, balancimit, ndërrimit të furnizuesit dhe pjesëmarrjes së konsumatorëve aktivë, zbatohen përkatësisht aktet nënligjore të tregut dhe rregullat për konsumatorët, nëse kjo Rregull nuk parashikon shprehimisht ndryshe.

Neni 54

Ndryshimet/Plotësimet

1. ZRRE-ja mund të ndryshojë ose plotësojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për modifikimin ose ndryshimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.
3. Ndryshimet dhe plotësimet i nënshtrohen konsultimit publik në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 55

Interpretimi

1. Në rast të ndonjë pasigurie në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerr informata shpjeguese.

Neni 56

Dispozitat Kalimtare

1. Obligohen operatorët e rrjetit që brenda periudhës prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj Rregulle të kryejnë të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike dhe administrative për të mundësuar zbatimin dhe operimin e BEBR-ve.
2. Obligohen operatorët e rrjetit që çdo dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle të raportojnë për progresin e përgatitjeve të nevojshme teknike dhe administrative për të mundësuar operimin e BEBR.
3. Dispozitat që lidhen me pjesëmarrjen e BERB-ve në skemat e fleksibilitetit dhe agregimit zbatohen pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore që rregullojnë këto aktivitete.

Neni 57

Hyrja në Fuqi

1. Kjo Rregull hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Neni 58

Shtojcat

1. Shtojcat 1 deri në 6 janë pjesë integrale e kësaj Rregulle dhe kanë fuqi të njëjtë juridike si dispozitat e saj.



SHTOJCA 1

FORMULARI PËR APLIKIM PËR AUTORIZIM PËR NDËRTIM TË BASHKËSISË SË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR)

(Në përputhje me Nenin 11 të Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme - BEBR)

SHËNIM:

- Ky formular përdoret për paraqitjen e dokumentacionit shtesë specifik për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR), në përputhje me këtë Rregull.
- Aplikuesi është i obliguar të përmbushë dhe të paraqesë edhe dokumentacionin e kërkuar sipas Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese, Sistemeve të Reja të Transmisionit dhe Distribucionit të Gazit, Përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte për Energji Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte të Transmisionit të Gazit Natyror, si dhe çdo kërkesë tjetër të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi.

1. TË DHËNAT E APLIKUESIT

Përshkrimi	Të dhënat
Emri i BEBR-së	
Forma juridike	
Numri i regjistrimit në ARBK	
Përfaqësuesi ligjor	
Adresa	
E-mail	
Telefoni	

2. TË DHËNAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Përshkrimi	Të dhënat
Teknologjia e projektit (PV, Erë, Hidro, Biomasa, Biogaz, etj.)	
Kapaciteti i instaluar (kW/MW)	
Komuna e projektit	
Operatori përkatës i rrjetit (OSSh/OST)	



3. INFORMACION SPECIFIK PËR BEBR

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i anëtarëve ose aksionarëve	
Numri i NMVM-ve	
Modeli i ndarjes së energjisë (Statik/Dinamik/Hibrid)	
Përmbushja e kriterit të afërsisë sipas Nenit 13 të kësaj Rregulle Komuna	☐ Po ☐ Jo

4. DOKUMENTACIONI I BASHKËNGJITUR

- ☐ Statuti i BEBR-së
- ☐ Certifikata e regjistrimit të subjektit juridik
- ☐ Lista e anëtarëve ose aksionarëve
- ☐ Përshkrimi i strukturës së qeverisjes së BEBR-së
- ☐ Deklarata për përmbushjen e kriterit të afërsisë
- ☐ Modeli i ndarjes së energjisë
- ☐ Dokumentacioni i kërkuar sipas Rregullës Nr. 03/2022
- ☐ Dokumente të tjera relevante

- Aplikuesi deklaron se dokumentacioni i paraqitur sipas kësaj Shtojce është në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulle dhe plotëson dokumentacionin e kërkuar sipas Rregullës Nr. 03/2022.

5. DEKLARATA E APLIKUESIT

Unë, i nënshkruari më poshtë, deklaroj se të dhënat dhe dokumentet e paraqitura në këtë aplikim janë të sakta, të plota dhe të vërteta.

Gjithashtu deklaroj se Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) do të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme dhe kushtet e autorizimit të lëshuara nga ZRRE.

Emri dhe Mbiemri: _____

Pozita: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA ZRRE

Numri i protokollit: _____

Data e pranimit: _____

Pranuar nga: _____



Vërejtje: _____

Vendimi:

- ☐ Aplikimi është pranuar për shqyrtim
- ☐ Kërkohet plotësim i dokumentacionit
- ☐ Aplikimi refuzohet

Data: _____

Nënshkrimi: _____



SHTOJCA 2

FORMULARI PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E BASHKËSIVE TË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR)

(Në përputhje me Nenin 14 të Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme - BEBR)

SHËNIM

Ky formular përdoret për regjistrimin e Bashkësisë së Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) në Regjistrin e BEBR-ve të administruar nga ZRRE.

1. TË DHËNAT E BEBR-së

Përshkrimi	Të dhënat
Emri i BEBR-së	
Forma juridike	
Numri i regjistrimit në ARBK	
Numri fiskal	
Adresa	
Komuna	
E-mail	
Telefoni	

2. PËRFAQËSUESI LIGJOR

Përshkrimi	Të dhënat
Emri dhe Mbiemri	
Pozita	
Telefoni	
E-mail	

3. ANËTARËT OSE AKSIONARËT

Përshkrimi	Numri
Numri total i anëtarëve ose aksionarëve	
Persona fizikë	
NMVM	
Autoritete lokale	
Organizata komunitare/OJQ	



4. INFORMACION MBI AKTIVITETET E BEBR-së

- ☐ Prodhim i energjisë elektrike
- ☐ Vetë-konsum individual
- ☐ Vetë-konsum kolektiv
- ☐ Ndarje e energjisë
- ☐ Ruajtje e energjisë
- ☐ Shitje e energjisë elektrike
- ☐ Shërbime fleksibiliteti
- ☐ Agregim
- ☐ Infrastrukturë për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike
- ☐ Tjetër: _____

5. TË DHËNAT MBI INSTALIMET E BRE

Përshkrimi	Të dhënat
Teknologjia	
Kapaciteti i instaluar (kW/MW)	
Komuna e instalimit	
Operatori përkatës i rrjetit (OSSh/OST)	
Numri i instalimeve	

6. MODELI I NDARJES SË ENERGJISË

- ☐ Statik
- ☐ Dinamik
- ☐ Hibrid

7. DOKUMENTACIONI I BASHKËNGJITUR

- ☐ Certifikata e regjistrimit në ARBK
- ☐ Statuti i BEBR-së
- ☐ Lista e anëtarëve ose aksionarëve
- ☐ Të dhënat mbi instalimet e BRE
- ☐ Modeli i ndarjes së energjisë
- ☐ Dokumente tjera relevante

8. DEKLARATA E APLIKUESIT



Unë, i nënshkruari më poshtë, deklaroj se të dhënat dhe dokumentet e paraqitura në këtë formular janë të sakta, të plota dhe të vërteta.

Po ashtu deklaroj se BEBR-ja përmbush kushtet e përcaktuara në Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë dhe në Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.

Përshkrimi	Të dhënat
Emri dhe Mbiemri	
Pozita	
Data	
Nënshkrimi	

PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA ZRRE

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i regjistrimit në Regjistrin e BEBR-ve	
Data e regjistrimit	
Statusi	☐ Aktiv ☐ Pezulluar ☐ Çregjistruar
Vërejtje	

Emri i zyrtarit	
Data	
Nënshkrimi	



SHTOJCA 3

FORMULARI PËR APLIKIM PËR KYÇJE NË RRJET TË BASHKËSISË SË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR)

(Në përputhje me Nenin 18 të Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme - BEBR)

SHËNIM

Ky formular përdoret nga Bashkësia e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme (BEBR) për paraqitjen e kërkesës për kyçje në rrjet pranë operatorit përkatës të rrjetit (OSSh ose OST). Aplikuesi është i obliguar të përmbushë edhe kërkesat teknike, procedurale dhe dokumentare të operatorit përkatës të rrjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kodet e Rrjetit dhe procedurat e kyçjes.

1. TË DHËNAT E BEBR-së

Përshkrimi	Të dhënat
Emri i BEBR-së	
Forma juridike	
Numri i regjistrimit në ARBK	
Numri i regjistrimit në Regjistrin e BEBR-ve	
Adresa	
Komuna	
Përfaqësuesi ligjor	
E-mail	
Telefoni	

2. TË DHËNAT E PROJEKTIT

Përshkrimi	Të dhënat
Teknologjia (PV, Erë, Hidro, Biomasa, Biogaz, etj.)	
Kapaciteti i instaluar (kW/MW)	
Kapaciteti i inverterëve (kW/MW)	
Kapaciteti i ruajtjes së energjisë (MWh), nëse aplikohet	
Lokacioni i instalimit	
Komuna	
Parcela(at) kadastrale	



3. INFORMACION MBI KYÇJEN

Përshkrimi	Të dhënat
Operatori përkatës i rrjetit	☐ OSSh(KEDS) ☐ OST(KOSTT)
Pika e propozuar e kyçjes	
Niveli i tensionit	
Kapaciteti i kërkuar për kyçje	

4. INFORMACION MBI BEBR

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i anëtarëve ose aksionarëve	
Modeli i ndarjes së energjisë	☐ Statik ☐ Dinamik ☐ Hibrid
Parashihet ruajtje e energjisë (BESS)	☐ Po ☐ Jo
Parashihet infrastrukturë për mbushjen e automjeteve elektrike	☐ Po ☐ Jo

5. DOKUMENTACIONI I BASHKËNGJITUR

- ☐ Dokumentacioni teknik sipas kërkesave të operatorit të rrjetit
- ☐ Dëshmia e të drejtës pronësore ose të drejtës së shfrytëzimit
- ☐ Skemat elektrike dhe dokumentacioni teknik
- ☐ Autorizimi për Ndërtim nga ZRRE (kur është i zbatueshëm)
- ☐ Certifikata e regjistrimit të BEBR-së
- ☐ Dokumente tjera sipas kërkesave të operatorit të rrjetit

6. DEKLARATA E APLIKUESIT

Unë, i nënshkruari më poshtë, deklaroj se të dhënat dhe dokumentet e paraqitura në këtë kërkesë janë të sakta, të plota dhe të vërteta.

Përshkrimi	Të dhënat
Emri dhe Mbiemri	
Pozita	
Data	
Nënshkrimi	



PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA OPERATORI I RRJETIT

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i kërkesës	
Data e pranimit	
Operatori	☐ OSSh ☐ OST
Statusi	☐ Në shqyrtim ☐ Miratuar ☐ Refuzuar
Vërejtje	

Emri i zyrtarit	
Data	
Nënshkrimi	



SHTOJCA 4

LISTA E PIKAVE MATËSE DHE ANËTARËVE PJESËMARRËS NË NDARJEN E ENERGJISË

(Në përputhje me Nenet 30 dhe 31 të Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme - BEBR)

SHËNIM

Kjo shtojcë përdoret për regjistrimin dhe përditësimin e listës së anëtarëve ose aksionarëve të BEBR-së që marrin pjesë në ndarjen e energjisë, si dhe të pikave të tyre matëse.

Kjo shtojcë i dorëzohet operatorit përkatës të rrjetit dhe përditësohet sa herë që ndodh shtim, largim ose ndryshim i anëtarëve pjesëmarrës në ndarjen e energjisë.

TË DHËNAT E BEBR-së

Përshkrimi	Të dhënat
Emri i BEBR-së	
Numri i regjistrimit në ARBK	
Numri i regjistrimit në Regjistrin e BEBR-ve	
Operatori përkatës i rrjetit	☐ OSSh ☐ OST
Modeli i ndarjes së energjisë	☐ Statik ☐ Dinamik
Data e hyrjes në fuqi të kësaj liste	
Data e dorëzimit	

LISTA E ANËTARËVE PJESËMARRËS NË NDARJEN E ENERGJISË

Nr.	Emri i Anëtarit/Aksionarit	Kategoria (PF/NMVM/Komunë/OJQ)	Numri i Pikës Matëse	Adresa e Pikës së Konsumit	Furnizuesi Aktual	Faktori i Ndarjes (%)	Aktiv në Ndarje (Po/Jo)
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							



PIKA MATËSE E GJENERIMIT

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i Pikës Matëse të Gjenerimit	
Teknologjia	
Kapaciteti i Instaluar	
Lokacioni	

DEKLARATA E BEBR-së

BEBR deklaron se të gjithë anëtarët ose aksionarët e listuar në këtë shtojcë janë pjesëmarrës në ndarjen e energjisë dhe se të dhënat e paraqitura janë të sakta dhe të përditësuara.

Përshkrimi	Të dhënat
Emri dhe Mbiemri	
Pozita	
Data	
Nënshkrimi	

PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA OPERATORI I RRJETIT

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i referencës	
Data e pranimit	
Statusi	☐ Pranuar ☐ Kërkohet plotësim ☐ Refuzuar
Vërejtje	

Emri i zyrtarit	
Data	
Nënshkrimi	



SHTOJCA 5

DEKLARIMI I FAKTORËVE TË NDARJES SË ENERGJISË

(Në përputhje me Nenet 30 dhe 31 të Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme - BEBR)

1. TË DHËNAT E BEBR-së

Përshkrimi	Të dhënat
Emri i BEBR-së	
Numri i regjistrimit në ARBK	
Numri i regjistrimit në Regjistrin e BEBR-ve	
Operatori përkatës i rrjetit	☐ OSSh ☐ OST
Data e dorëzimit	

2. MODELI I NDARJES SË ENERGJISË

- ☐ Model Statik
☐ Model Dinamik
☐ Model Hibrid

3. FAKTORËT E NDARJES SË ENERGJISË

(Plotësohet për Modelin Statik ose komponentin statik të Modelit Hibrid)

Nr.	Emri i Anëtarit/Aksionarit	Numri i Pikës Matëse	Faktori i Ndarjes (%)
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
Totali			100 %



4. PARAMETRAT E MODELIT HIBRID

(Plotësohet vetëm nëse zgjidhet Modeli Hibrid)

Përshkrimi	Vlera (%)
Komponenti Statik	
Komponenti Dinamik	
TOTALI	100%

5. DATA E HYRJES NË FUQI

Data nga e cila kërkohet të zbatohet modeli i ndarjes:

____ / ____ / ____

Shënim: Faktorët e ndarjes dhe çdo ndryshim i tyre bëhen efektivë vetëm pas regjistrimit në sistemin e operatorit të rrjetit dhe nuk zbatohen në mënyrë retroaktive.

6. DEKLARATA E BEBR-së

BEBR deklaron se modeli i ndarjes së energjisë dhe faktorët e paraqitur në këtë shtojcë janë miratuar në përputhje me aktet e saj të brendshme dhe janë në pajtim me Rregullën për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.

BEBR merr përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të paraqitura dhe për njoftimin e operatorit të rrjetit për çdo ndryshim të mëvonshëm.

Përshkrimi	Të dhënat
Emri dhe Mbiemri	
Pozita	
Data	
Nënshkrimi	

PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA OPERATORI I RRJETIT

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i referencës	
Data e pranimit	
Data e hyrjes në fuqi	
Statusi	☐ Pranuar ☐ Kërkohet plotësim ☐ Refuzuar
Vërejtje	

Emri i zyrtarit	
Data	
Nënshkrimi	



SHTOJCA 6

NJOFTIM PËR NDRYSHIME NË BASHKËSINË E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME (BEBR)

(Në përputhje me Nenet 14, 22 dhe 26 të Rregullës për Bashkësitë e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme - BEBR)

SHËNIM

Kjo shtojcë përdoret për njoftimin e ZRRE-së dhe, kur është e zbatueshme, operatorit përkatës të rrjetit për çdo ndryshim që ndikon në regjistrimin, operimin, matjen, ndarjen e energjisë ose statusin e BEBR-së.

1. TË DHËNAT E BEBR-së

Përshkrimi	Të dhënat
Emri i BEBR-së	
Numri i regjistrimit në ARBK	
Numri i regjistrimit në Regjistrin e BEBR-ve	
Përfaqësuesi ligjor	
E-mail	
Telefoni	

2. LLOJI I NDRYSHIMIT

- ☐ Ndryshim i anëtarëve ose aksionarëve
- ☐ Ndryshim i strukturës së qeverisjes
- ☐ Ndryshim i përfaqësuesit ligjor
- ☐ Ndryshim i modelit të ndarjes së energjisë
- ☐ Ndryshim i faktorëve të ndarjes së energjisë
- ☐ Ndryshim i kapacitetit të instaluar
- ☐ Ndryshim i teknologjisë së projektit
- ☐ Ndryshim i pikës së kyçjes
- ☐ Ndryshim i pikave matëse
- ☐ Ndryshim i asetëve të ruajtjes së energjisë (BESS)
- ☐ Ndryshim i infrastrukturës për mbushjen (karikimin) e automjeteve elektrike
- ☐ Shpërbërja e BEBR-së
- ☐ Tjetër: _____



3. PËRSHKRIMI I NDRYSHIMIT

Përshkruani shkurt ndryshimin e propozuar ose të realizuar:

4. DATA E NDRYSHIMIT

Përshkrimi	Të dhënat
Data e hyrjes në fuqi të ndryshimit	
Data e njoftimit	

5. DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS

- ☐ Vendimi i organit kompetent të BEBR-së
- ☐ Lista e përfitësuar e anëtarëve ose aksionarëve
- ☐ Struktura e përfitësuar e qeverisjes
- ☐ Faktorët e rinj të ndarjes së energjisë
- ☐ Dokumentacioni teknik për ndryshimet në instalime
- ☐ Dokumentacioni për ndryshimet në pikat matëse
- ☐ Dokumente të tjera relevante

6. DEKLARATA E BEBR-së

Unë, i nënshkruari më poshtë, deklaroj se informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur në këtë njoftim është i saktë, i plotë dhe i vërtetë.

Përshkrimi	Të dhënat
Emri dhe Mbiemri	
Pozita	
Data	
Nënshkrimi	



PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA ZRRE/OPERATORI I RRJETIT

Përshkrimi	Të dhënat
Numri i referencës	
Data e pranimi	
Institucioni	☐ ZRRE ☐ OSSh ☐ OST
Statusi	☐ Pranuar ☐ Kërkohej plotësim ☐ Refuzuar
Vërejtje	

Emri i zyrtarit	
Data	
Nënshkrimi	